

VENDIM
Nr. ____, datë _____.2026

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË SHFRYTËZIMIT TË
HAPËSIRËS PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 107 datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen autoritetet e planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit, të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Ministria e Mjedisit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Brendshme, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLAT E SHFRYTËZIMIT TË HAPËSIRËS PUBLIKE NË SHKALLË VENDI/ KOMBËTARE

KAPITUJT

KREU I: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU II: STRUKTURAT ZBATUESE DHE MONITORUESE

KREU III: SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NGA KATEGORIA E AKTIVITETEVE GASTRONOMIKE (BAR, RESTORANTE, HOTELERI DHE SHËRBIME TË NGJASHME) DHE REKREATIVE

KREU IV: SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR EKSPOZIMIN E NJË KATEGORIE TË KUFIZUAR MALLRASH JASHTË NJËSISË SË TREGTIMIT

KREU V: ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE AMBULANTE NË HAPËSIRAT PUBLIKE, TREGJE DHE JASHTË TYRE

KREU VI: SHFRYTËZIMI I DISA HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR VENDOSJEN E KIOSKAVE

KREU VII: SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR VENDOSJEN E STRUKTURAVE REKLAMUESE (CITY LIGHT DHE TABELAT REKLAMUESE LED)

KREU VIII: SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE - FASADA PERVENDOSJEN E TABELAVE REKLAMUESE

KREU IX: SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR ZHVILLIMIN E PANAIREVE

KREU X: SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR AKTIVITETE PROMOVUESE, ARTISTIKE, KULTURORE, AKTIVITETEVE POLITIKE E TË TJERA

KREU XI: SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE – PLAZHE

KREU XII: SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE (TROTUARE) GJATË NDERTIMIT

KREU XIII: DISPOZITA TË FUNDIT

Struktura e çdo Kreut: Shfrytëzimi

Neni 1: **Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit/ strukturës ose hapësirës** (sipas rastit)

Neni 2: **Aktivitetet e lejuara** (ky nen shtohet kur ka nevojë sipas rastit)

Neni 3: **Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat**

Neni 4: **Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat**

Neni 5: **Procedura e aplikimit për leje**

Neni 6: **Afati i lejes**

Neni 7: **Ndalimet**

Neni 8: **Mirëmbajtja**

Neni 9: **Kthimi i hapësirës publike**

Neni 10: Detyrimet financiare

Neni 11: Masat ndëshkuese

KREU I.....	8
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	8
Neni 2.....	8
Fusha e zbatimit.....	8
Neni 3.....	8
Parimet për shfrytëzimin e hapësirës publike.....	8
Neni 4.....	9
Përkufizime.....	9
Neni 5.....	11
Kushtet e përgjithshme të shfrytëzimit të hapësirave publike.....	11
Neni 6.....	11
Raporti me legjislacionin sektorial.....	11
KREU II.....	12
STRUKTURAT ZBATUESE DHE MONITORUESE.....	12
Neni 7.....	12
Përgjegjësitë e Bashkisë.....	12
Neni 8.....	13
Roli i Kryetarit të Bashkisë.....	13
Neni 9.....	13
Përgjegjësitë e Këshillit Bashkiak.....	13
Neni 10.....	13
Përgjegjësitë e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit (IVMT).....	13
Neni 11.....	14
Përgjegjësitë e Strukturave të Bashkisë.....	14
Neni 12.....	14
Institucionet qendrore dhe sektoriale.....	14
Neni 13.....	15
Autoritetet e Ndërtimit.....	15
Neni 14.....	15
Strukturat e sigurisë dhe emergjencave.....	15
KREU III.....	16
SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NGA KATEGORIA E AKTIVITETEVE GASTRONOMIKE (BAR, RESTORANTE, HOTELERI DHE SHËRBIME TË NGJASHME) DHE REKREATIVE.....	16
Neni 15.....	16
Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit.....	16
Në këtë kre përcaktohen kushtet për përdorimin e hapësirave publike nga subjektet gastronomike (bare, restorante, kafene, fast-food, hoteleri dhe aktivitete të tjera të ngjashme) dhe rekreative. Përdorimi i hapësirave publike për këto aktivitete duhet të garantojë akses të lirë dhe pa barriera fizike për qytetarët, ruajtjen e karakterit urban, estetik dhe funksional të qytetit, si dhe përputhjen me legjislacionin në fuqi për mjedisin, turizmin, shëndetin publik dhe planifikimin e territorit.....	16
Neni 16.....	16
Aktivitetet e lejuara në hapësirën publike.....	16
Neni 17.....	17
Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat.....	17
Neni 18.....	17
Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat.....	17
Neni 19.....	19
Dokumentacioni dhe procedura e aplikimit për leje.....	19
Neni 20.....	20
Afati i lejes.....	20
Neni 22.....	20
Ndalimet.....	20
Neni 23.....	21
Mirëmbajtja.....	21

Neni 24.....	21
Kthimi i hapësirës publike	21
Neni 25.....	21
Detyrimet financiare.....	21
Neni 26.....	22
Masat ndëshkuese.....	22
<i>KREU IV</i>	<i>22</i>
<i>SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR EKSPOZIMIN E NJË</i>	
<i>KATEGORIE TË KUFIZUAR MALLRASH JASHTË NJËSISË SË TREGTIMIT.....</i>	<i>22</i>
Neni 27.....	22
Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit.....	22
Neni 28.....	23
Aktivitetet e lejuara në hapësirën publike	23
Neni 29.....	23
Pajisjet e lejuara dhe kriteret teknike.....	23
Neni 30.....	24
Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat.....	24
Neni 32.....	25
Afati dhe rinovimi i lejes	25
Neni 33.....	25
Ndalimet	25
Neni 34.....	25
Mirëmbajtja.....	25
Neni 35.....	26
Kthimi i hapësirës publike	26
Neni 36.....	26
Detyrimet financiare.....	26
Neni 37.....	26
Masat ndëshkuese.....	26
<i>SHFRYTËZIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE – TREGJE DHE AKTIVITETE</i>	
<i>AMBULATORE.....</i>	<i>27</i>
Neni 38.....	27
Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit.....	27
Neni 39.....	27
Aktivitetet e lejuara në hapësirën publike	27
Neni 40.....	27
Neni 41.....	28
Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat.....	28
Neni 42.....	29
Dokumentacioni dhe procedura e aplikimit për leje.....	29
1. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë në seksionin përkatës të portalit e-Albania kërkesën për të ushtruar tregtinë ambulante në tregjet e lëvizshëm apo fikse, e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin vijues:.....	29
2. Subjekti dorëzon në seksionin përkatës të portalit e-Albania:.....	29
a. Kërkesë për aplikim të plotësuar sipas formularit tip;.....	Error! Bookmark not defined.
b. Skicën/Planimetri e vendosjes së pajisjes ose stendës, si dhe të sipërfaqes së kërkuar për ushtrimin e aktivitetit;.....	Error! Bookmark not defined.
c. Dokumentin e identifikimit të subjektit (NIPT) dhe vërtetimin e regjistrimit tatimor, ose letërnjoftim elektronik për individët	29
i. Individët mund të aplikojnë me letërnjoftim elektronik vetëm për aktivitete të përkohshme, artizanale, kulturore ose rekreative pa natyrë tregtare;.....	Error! Bookmark not defined.
ii. Për aktivitetet ekonomike me natyrë të vazhdueshme, është e detyrueshme paraqitja e NIPT-it dhe dokumentacionit fiskal përkatës;.....	Error! Bookmark not defined.
d. Vërtetim tatimor dhe vërtetim shëndetësor, përkatësisht për produktet ushqimore;.....	29
e. Për tregtarët e produkteve ushqimore, vërtetim higjieno-sanitar dhe libreza shëndetësore për punonjësit;.....	29
f. Fotografitë e pajisjes së propozuar për ushtrimin e aktivitetit	29
3. Struktura përgjegjëse kryen vlerësimin paraprak brenda 7 (shtatë) ditëve për plotësinë e dokumentacionit dhe njofton subjektin për çdo mungesë. Struktura përgjegjëse duhet të sigurojë vlerësim të paanshëm të aplikimeve, duke shmangur çdo konflikt interesi.....	29
Neni 43.....	29
Afati i lejes	29
Neni 44.....	29
Neni 46.....	30
Kthimi i hapësirës publike	30

Neni 47.....	31
Neni 48.....	31
Masat ndëshkuese.....	31
KREU VI.....	32
SHFRYTËZIMI I DISA HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR VENDOSJEN E KIOSKAVE	32
Neni 49.....	32
Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit.....	32
Neni 50.....	32
Aktivitetet e lejuara në hapësirën publike.....	32
Neni 51.....	32
Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat.....	32
Neni 52.....	33
Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat.....	33
Neni 53.....	33
Procedura e aplikimit për leje.....	33
<i>z. Individët mund të aplikojnë me letërnjoftim elektronik vetëm për aktivitete të përkohshme, artizanale, kulturore ose rekreative pa natyrë tregtare;.....</i>	Error! Bookmark not defined.
Neni 54.....	34
Afati i lejes.....	34
Neni 55.....	34
Ndalimet.....	34
Neni 56.....	35
Mirëmbajtja.....	35
Neni 57.....	35
Kthimi i hapësirës publike.....	35
Neni 58.....	35
Detyrimet financiare.....	35
Neni 59.....	36
Masat ndëshkuese.....	36
KREU VII.....	36
SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR VENDOSJEN E STRUKTURAVE REKLAMUESE (STRUKTURA TË TIPIT CITY LIGHT DHE TABELAT REKLAMUESE LED)	36
Neni 60.....	36
Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit.....	36
Neni 61.....	37
Aktivitetet e lejuara në hapësirën publike.....	37
Neni 62.....	37
Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat.....	37
Neni 63.....	38
Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat.....	38
Neni 64.....	38
Dokumentacioni dhe procedura e aplikimit për leje.....	38
Neni 65.....	39
Afatet e lejes për shfrytëzimin e hapësirës publike.....	39
Neni 66.....	39
Neni 67.....	40
Mirëmbajtja e strukturave reklamuese.....	40
Neni 68.....	41
Kthimi i hapësirës publike.....	41
Neni 69.....	41
Tarifa e shfrytëzimit të hapësirës publike për struktura reklamuese.....	41
Neni 70.....	42
Masat ndëshkuese.....	42
SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE – FASADA PËR VENDOSJEN E TABELAVE REKLAMUESE.....	43
Neni 71.....	43
Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit.....	43
Neni 72.....	43
Aktivitetet e lejuara.....	43
Neni 73.....	44
Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat.....	44

Neni 74.....	44
Masa dhe distancat	44
Neni 75.....	44
Dokumentacioni dhe procedura e aplikimit për leje	44
Neni 76.....	45
Afati i lejes	45
Neni 77.....	45
Ndalimet	45
Neni 78.....	46
Mirëmbajtja	46
Neni 79.....	46
Kthimi i hapësirës publike	46
Neni 80.....	46
Detyrimet financiare	46
Neni 81.....	47
Masat ndëshkuese	47
<i>KREU IX</i>	48
<i>SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR ZHVILLIMIN E PANAIREVE....</i>	48
Neni 82Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit.....	48
Neni 83.....	48
Neni 84.....	48
Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat	48
Neni 85.....	49
Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat	49
Neni 865.....	49
Procedura e aplikimit për leje	49
Neni 87.....	50
Afati i lejes	50
Neni 88.....	50
Neni 90.....	51
Masat ndëshkuese	52
<i>KREU X</i>	53
<i>SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR AKTIVITETE PROMOVUESE, ARTISTIKE, KULTURORE, AKTIVITETE POLITIKE E TË TJERA</i>	53
Neni 93.....	53
Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit	53
Neni 95Pajisjet dhe elementët e lejuar.....	54
Neni 96.....	54
Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat	54
Neni 97.....	55
Neni 98 Afati i lejes	56
Neni99.....	56
Ndalimet	56
Neni 100.....	57
Mirëmbajtja e hapësirës publike	57
Neni 101.....	57
Kthimi i hapësirës publike	57
Pas përfundimit të aktivitetit, organizatori është i detyruar të kryejë pastrimin bazik të hapësirës (largimin e mbetjeve të dukshme dhe ushqimore) brenda 2 (dy) orëve nga mbyllja e aktivitetit. Pastrimi përfundimtar dhe rikthimi i hapësirës publike në gjendjen fillestare duhet të kryhet jo më vonë se ora 06:00 e ditës pasuese.Në rast mospërbushjeje të këtyre detyrimeve, Bashkia ndërhyr për pastrimin dhe rikthimin e hapësirës, duke zbritur kostot përkatëse nga garancia financiare e depozituar nga organizatori ose, kur kjo nuk mjafton, duke ia faturuar drejtpërdrejt organizatorit sipas procedurave ligjore në fuqi.Neni 102.....	57
Detyrimet financiare	57
Neni 103.....	58
Masat ndëshkuese	58
<i>KREU XI</i>	58
<i>SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE – PLAZHE</i>	58
Neni 104.....	58
Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit	58
Neni 105.....	59
Tipologjitë e plazheve dhe kushtet e shfrytëzimit	59
Neni 106.....	59

Neni 107.....	60
Neni 108.....	61
Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat	61
Neni 109.....	61
Procedura e aplikimit për leje	61
Neni 110.....	62
Neni 111.....	62
Neni 112.....	63
Neni 113.....	63
Kthimi i hapësirës publike	63
Neni 114.....	64
Detyrimet financiare	64
Neni 115.....	64
Masat ndëshkuese dhe inspektimet	64
<i>KREU XII</i>	65
SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE (TROTUARE) GJATË NDËRTIMIT	65
Neni 116.....	65
Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit	65
Neni 117.....	65
Aktivitetet e lejuara	65
6. Mirëmbajtja e përditshme e hapësirës së shfrytëzuar, duke sistemuar dhe pastruar materialet për të shmangur rreziqe për qytetarët	66
Neni 118.....	66
Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat	66
Neni 119.....	66
Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat	66
Neni 120.....	66
Procedura e aplikimit për leje	66
Neni 121.....	67
Afati i lejes	67
Neni 121.....	67
Ndalimet	67
Neni 123.....	67
Mirëmbajtja	67
Neni 124.....	67
Kthimi i hapësirës publike	67
Neni 125.....	68
Detyrimet financiare	68
Neni 126.....	68
Masat ndëshkuese	68
<i>KREU XIII</i>	68
<i>DISPOZITA TË FUNDIT</i>	68
Neni 127.....	68
Hyrja në fuqi	68
Neni 128.....	69
Zbatimi	69
Neni 129.....	69
Interpretimi	69
Neni 130.....	69
Ndryshimet dhe plotësimet	69

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e rregullave, kushteve, kritereve dhe procedurave të detajuara që rregullojnë mënyrën e shfrytëzimit të hapësiravepublike në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Rregullorja zbatohet për të gjitha subjektet publike dhe private që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në hapësira publike, pavarësisht formës së tyre të organizimit juridik apo natyrës së veprimtarisë së ushtruar.
3. Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i një përdorimi të rregullt funksional dhe të qëndrueshëm të hapësirës publike, në përputhje me interesin publik, sigurinë, estetikën urbane dhe mbrojtjen e mjedisit.
4. Kjo rregullore gjithashtu, synon të sigurojë parime të qarta për përgjegjësitë e institucioneve publike dhe përdoruesve të hapësirës publike, si dhe të garantojë transparencën, barazinë e trajtimit dhe paanësinë në procesin e shqyrtimit dhe dhënies së lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike, si dhe forcimin e rolit mbikëqyrës të institucioneve kompetente.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha hapësirat publike në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat janë në administrim të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve publike qendrore ose vendore, si dhe çdo autoriteti tjetër publik kompetent sipas legjislacionit në fuqi.
2. Përjashtohen nga zbatimi i kësaj rregulloreje ato hapësira publike apo aktivitete që rregullohen me akte të veçanta ligjore ose nënligjore, përveç rasteve kur këto akte parashikojnë shprehimisht zbatimin e saj.

Neni 3

Parimet për shfrytëzimin e hapësirës publike

1. Shfrytëzimi i hapësirave publike udhëhiqet nga këto parime:
 - a) **Parimi i prevalimit të interesit publik ndaj atij privat:** Gjatë procesit të shqyrtimit dhe dhënies së lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publikeinteresi publik ka përparësi ndaj çdo interesi privat;
 - b) **Parimi i aksesit të lirë dhe të barabartë;** Garantimi i të drejtës së të gjithë qytetarëve dhe komunitetit për të pasur akses të lirë dhe të barabartë në hapësirat publike;
 - c) **Parimi i mbrojtjes së mjedisit dhe identitetit urban;** shfrytëzimi i hapësirave publike duhet të kryhet duke ruajtur ekuilibrin mjedisor, imazhin urban të unifikuar dhe pa cënuar elementët e trashëgimisë kulturore;

- d) **Parimi i mirëmbajtjes dhe rikthimit**; Subjektet shfrytëzuese kanë detyrim të kujdesen për mirëmbajtjen e tyre gjatë periudhës së përdorimit dhe të garantojë rikthimin në gjendjen fillestare pas përfundimit të afatit të lejes;
- e) **Parimi i transparencës dhe trajtimit të barabartë**; Të garantohet transparencë dhe trajtim i barabarë dhe pa-anshmëri në procedurat e dhënies së lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike duke garantuar barazi trajtimi për të gjitha subjektet aplikante;
- f) **Parimi i përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi**; Parashikimet e kësaj rregullore zbatohen në përputhje me legjislacionin sektorial, përfshirë legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, legjislacionin për vetëqeverisjen vendore, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Aktivitet gastronomik”** – strukturë që ofron ushqim dhe pije në hapësira publike me tavolina, karrige dhe pajisje të tjera të përkohshme.
2. **“Aktivitete rekreative dhe restorative”** – përfshihen por pa u kufizuar aktivitete si, baret, restorantet, piceri, fast-food, hoteleri, si dhe çdo shërbim tjetër që ushtrohet në sektorin e shërbimeve sociale.
3. **“Bordura”**- është element i parë që ndan karrexhatën me trotuarin.
4. **“Barriera”**- është element që pengojnë lëvizshmërinë, kalimin apo aksesueshmërinë.
5. **“City Light”**- panele ndriçuese reklamuese;
6. **“Drejtoria përkatëse”**-njësia/drejtoria brenda administratës së bashkisë, përgjegjëse për detyrat që rrjedhin nga kjo rregullore.
7. **“Element Urban”**, është zona në të cilën bëjnë pjesë elemente si: pemë në krah të trotuarit, rruga, stacioni i autobusit, gjelbërim apo shkurre, kosha mbeturinash, reklama, ndriçues rrugorë, stola dhe pajisje të ngjashme.
8. **“Fasadë publike”** - pjesa e jashtme e ndërtesës e dukshme nga hapësira publike, e cila përdoret për vendosjen e tabelave reklamuese, informuese ose elementëve të tjerë grafikë.
9. **“Frontazhi”**- është hapësira publike përpara fasadës së objektit ku ushtrohet aktiviteti ekonomik.
10. **“Hapësirë publike”** - sipas ligjit nr.107/2014 *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*, i ndryshuar.
11. **“Kantier ndërtimi”**- sipas VKM nr. 448, datë 31.7.2025 *“Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve tëndërtimit dhe të rregullave të kantierit”*.
12. **“Kioskë”**- është një strukturë e vogël dhe e përkohshme tregtare.
13. **“Leje shfrytëzimi”** - është akti administrativ i lëshuar nga organi kompetent, që i njeh titullarit të saj të drejtën të shfrytëzojë hapësirën publike, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë rregullore.
14. **“Mobilim urban”**- procesi i projektimit, ndërtimit dhe/ose vendosjes në hapësirë publike të objekteve apo ndërtimeve të lëvizshme ose jo, me qëllim përmirësimin e cilësisë funksionale dhe estetike të saj, rritjen e sigurisë publike dhe, sipas rastit, zbutjen e trafikut.
15. **“Njësi tregtimi”**- ambient i mbyllur ose i hapur në të cilin subjekti kryhen aktivitetin e tij. Njësitë e tregtimit mund të jenë të shkëputura nga ndërtesa ose mund të përfshihet në të.
16. **“Panaire”**- aktivitet i organizuar në hapësira kompakte publike ose private, me karakter të përkohshëm, ku ekspozohen dhe tregtohen mallra ose shërbime nga subjekte të ndryshme, sipas fushës për të cilën jepet leja nga autoriteti kompetent

17. **“Pajisje të përkohshme”**- struktura ose elemente të lehta, të lëvizshme ose të çmontueshme, të vendosura në hapësirën publike për qëllime të caktuara.
18. **“Plazh publik”**- sipas VKM Nr. 649/2024 *“Për miratimin e Rregullores ‘Për Kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’*, të ndryshuar.
19. **“Procesverbal”** – dokument administrativ i hartuar nga inspektorët e autorizuar të njësisë të vetëqeverisjes vendore, policisë bashkiake ose institucioneve të tjera kompetente, në ushtrim të funksioneve të tyre sipas legjislacionit në fuqi, me të cilin konstatohet shkëlja e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe/ose të akteve ligjore e nënligjore përkatëse, dhe që shërben si bazë për vendosjen e masave administrative dhe ndëshkuese.
20. **Strukturë/tabelë reklamuese**”- çdo element vizual i vendosur në hapësirë publike fasadë, për qëllime informuese ose tregtare, të cilat nuk bien ndesh me elementët urbanë
21. **“Shesh publik”** - hapësirë publike e hapur, e destinuar për qarkullimin, aktivitete dhe qëndrimin e qytetarëve, si dhe për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, sociale, tregtare të përkohshme, sportive apo politike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimet e autoriteteve kompetente. Sheshi publik shërben gjithashtu si hapësirë për vendosjen e elementëve arkitektonikë, artistikë ose memorialë, që kontribuojnë në identitetin dhe jetën publike të komunitetit.
22. **“Shërbimet e lejuara”**- shërbimet që autoriteti vendor lejon të kryhen në hapësirë publike, sipas kategorive të lejuara të përdorimit të tokës, dhe që janë të përputhshme me ndërtimet rreth hapësirës ku ato krijohen, sipas ligjit dhe dokumenteve të planifikimit, si dhe në respektim të legjislacionit sektorial dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi
23. **“Shfrytëzim i hapësirës publike”**- çdo formëpërdorimi i hapësirës publike nga individë, biznese, ente/institucione publike ose organizata, për veprimtari ekonomike, sociale, kulturore ose rekreative, i cili lejohet vetëm pas pajisjes me leje shfrytëzimi nga organet kompetente, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore dhe në legjislacionin përkatës.
24. **“Tarifa për shfrytëzimin e hapësirave publike”**- detyrimi financiar që paguhet nga subjekti përdorues për shfrytëzimin e hapësirës publike, në përputhje me sipërfaqen e zënë, natyrën e aktivitetit, kohëzgjatjen e përdorimit dhe tarifat e miratuara në aktet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
25. **“Treg i përkohshëm”**- hapësirë publike e përcaktuar nga organet e vetëqeverisjes vendore, me ose pa bashkëpunim me institucionet e tjera kompetente, i destinuar për vendosjen e stendave ose banakëve të shitjes, për një periudhë të kufizuar kohore dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
26. **“Tregti ambulante”**- shitja e mallrave përmes stendave ose mjeteve të lëvizshme në hapësira publike, cili lejohet vetëm pas pajisjes me leje nga organi kompetent, në përputhje me rregullat për higjienën, sigurinë, përdorimin e hapësirës publike dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
27. **“Trotuar”** – Sipas Ligj Nr.8378, datë 22.7.1998 *“Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar.
28. **“Zonë lëvizëse”** – pjesë e trotuarit ose e një hapësire tjetër publike lineare, e destinuar vetëm për lëvizjen e pandërprerë të këmbësorëve, e vendosur paralel me karrexhatën dhe që duhet të mbahet e lirë nga çdo pengesë ose aktivitet tjetër. Kjo zonë siguron akses të sigurt dhe të vazhdueshëm për këmbësorët dhe nuk mund të bllokohet apo ngushtohet nga stenda, tavolina, karrige, reklama apo elemente të tjera të përkohshme, pavarësisht nga aktivitetet përreth.

Kushtet e përgjithshme të shfrytëzimit të hapësirave publike

1. Shfrytëzimi i hapësirave publike bëhet vetëm me leje të lëshuar nga organi kompetent, në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, vetëqeverisjen vendore, si dhe aktet e tjera përkatëse nënligjore.
2. Zënia e hapësirave publike për parkime të paautorizuara ose për ushtrimin e aktiviteteve të ndryshme pa lejen përkatëse, si dhe vendosja e pajisjeve, strukturave apo materialeve të tjera që pengojnë përdorimin e lirë të tyre nga publiku, konsiderohen shkelje dhe trajtohen sipas masave administrative të përcaktuara në këtë rregullore dhe në legjislacionin në fuqi. Në rastet kur veprimtaria përbën vepër penale, ajo i referohet organeve kompetente për shqyrtim.
3. Subjekti që disponon një leje për shfrytëzimin e hapësirës publike është i detyruar të sigurojë që:
 - a. shfrytëzimi i hapësirës nuk pengon qarkullimin dhe nuk cënon sigurinë publike;
 - a. të mos cënojë gjelbërimin, elementët urbanë dhe infrastrukturën ekzistuese;
 - b. respektojë normat e pastërtisë, qetësisë dhe ndotjes akustike;
 - c. përdorë hapësirën vetëm për qëllimin e përcaktuar në leje;
 - d. shlyejë tarifat dhe taksat përkatëse;
 - e. Pas lëshimit të dokumentit të lejes subjekti duhet mbjellë një pemë për çdo karrige që vendoset në hapësirën publike në funksion të aktivitetit të tij, duke kontribuar kështu në rritjen e fondit të gjelbërimit të bashkisë;
 - f. merr masa të nevojshme për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve. Në përfundim të afatit të lejes ose në rast revokimi, hapësira publike duhet të kthehet menjëherë në gjendjen fillestare. Kostot e kthimit i ngarkohen subjektit përkatës.
4. Shfrytëzimi i hapësirave publike do të realizohet kundrejt pagesës, tarifat e së cilës, do të përcaktohen nga Këshilli Bashkiak bazuar në sipërfaqen e shfrytëzuar, kohëzgjatjen, zonën dhe natyrën e aktivitetit. Këto tarifa do të përditësohen periodikisht në përputhje me nivelin e çmimeve të tregut dhe interesin publik.
5. Shkelja e kushteve të përcaktuara në këtë rregullore sjell aplikimin e masave ndëshkuese, proporcionalisht referuar me shkallën e shkeljes, që përfshijnë:
 - a. paralajmërim të shkruar nga inspektorët e autorizuar, i dokumentuar me procesverbal;
 - b. gjobë administrative sipas vlerës së përcaktuar nga organet kompetente;
 - c. pezullimin ose revokimin e lejes së shfrytëzimit;
 - d. sekuestrimin e përkohshëm të pajisjeve të vendosura në hapësirën publike.
6. Procesverbali i paralajmërimit ka fuqi të menjëhershme ekzekutive dhe shërben si bazë për vendosjen e masave të tjera ndëshkuese. Vendimi për gjobë, pezullim ose revokim merret nga organi kompetent i bashkisë. Subjekti ka të drejtë të ankimojë masën në përputhje me Ligjin për Procedurat Administrative, pa pezulluar ekzekutimin e saj.

Raporti me legjislacionin sektorial

1. Kjo rregullore është mbështetur mbi parimet themelore të legjislacionit sektorial dhe ka për qëllim të rregullojë posaçërisht aspektet që lidhen me shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Çdo aktivitet që do të zhvillohet në hapësirat publike duhet të jetë në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e mjedisit, sigurinë rrugore, shëndetin publik, turizmin, trashëgiminë kulturore, si dhe legjislacionin që lidhet me rendin dhe sigurinë publike, tregtinë dhe shërbimet, mbrojtjen civile dhe emergjencat, infrastrukturën teknike, si dhe garantimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuara, dhe çdo akt tjetër ligjor ose nënligjor në fuqi.
3. Në rast mospërputhjeje midis kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera ligjore ose nënligjore sektoriale, ka përparësi legjislacioni sektorial, përveç rasteve kur kjo rregullore parashikon masa më të favorshme për interesin publik, në të kundërt, në rast mosmarrëveshjeje, vendimarrja përcaktohet nga gjykata.
4. Në rastet kur legjislacioni sektorial mbulon fusha më të gjera se sa shfrytëzimi i hapësirës publike, kjo rregullore zbatohet vetëm për dispozitat që lidhen drejtpërdrejt me shfrytëzimin dhe administrimin e hapësirave publike.

KREU II

STRUKTURAT ZBATUESE DHE MONITORUESE

Neni 7

Përgjegjësitë e Bashkisë

1. Bashkia është organi përgjegjës për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë rregullore dhe legjislacionin sektorial në fuqi. Aplikimet për marrjen e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike kryhet vetëm nëpërmjet portalit e-Albania. Drejtoria përkatëse informon dhe mbështet Kryetarin e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak, për marrjen e vendimeve sipas kompetencave respektive.
2. Bashkia harton dhe miraton skemat e organizimit për tregje, panairë, kioska dhe aktivitete të tjera të përkohshme, nëpërmjet Drejtorisë përkatëse.
3. Bashkia administron dhe mbikëqyr hapësirat publike në territorin e juridiksionit të saj sa i përket:
 - a) ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve vendore, trotuareve, shesheve publike, ndriçimin e mjediseve publike;
 - b) ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike;
 - c) shërbimin e dekorit publik, parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike përmes Drejtorive dhe Ndërmarrjeve kompetente.
4. Bashkia administron Regjistrin Elektronik Unik për të gjitha lejet dhe pagesat për shfrytëzimin e hapësirave publike, i cili përditësohet në kohë reale dhe është i aksesueshëm për strukturat zbatuese. Ky regjistër administrohet nga Drejtoria përkatëse nëpërmjet portalit e-Albania dhe databaza e tij ndërvepron me institucionet të tjera që kryejnë funksionet respektive, si mbledhjen e pagesave, monitorimin e shfrytëzimit, etj. duke garantuar transparencë dhe reduktim të burokracive.
5. Bashkia përgatit dhe publikon raporte periodike, të paktën një herë në vit, mbi gjendjen e hapësirave publike, shfrytëzimin e tyre dhe të ardhurat nga tarifatat. Këto raporte publikohen në faqet zyrtare të çdo bashkie, në seksionin përkatës dhe aksesohen edhe nëpërmjet e-Albania.
6. Bashkia, përmes strukturave të saj të inspektimit, kryen kontrole periodike dhe të papritura për të verifikuar respektimin e kushteve të lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike.

7. Qytetarët kanë të drejtë të paraqesin ankesa dhe sugjerime mbi përdorimin dhe administrimin e hapësirave publike, të cilat regjistrohen dhe trajtohen përmes sistemit elektronik të bashkisë ose portalit e-Albania.
8. Bashkia bashkëpunon me institucionet e tjera publike (Policia e Shtetit, Agjencitë e Mjedisit, Drejtoritë e Kulturës, Autoritetet Rrugore etj.) për mbikëqyrjen dhe kontrollin e aktiviteteve që prekin fushat e tyre të përgjegjësive.
9. Bashkia në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit publikon hartën interaktive të hapësirave publike të dhëna me leje, afatet dhe tarifatat sipas zonave të përcaktuara.

Neni 8

Roli i Kryetarit të Bashkisë

1. Kryetari i Bashkisë miraton dhe firmos lejet për shfrytëzimin e hapësirave publike, në zbatim të vendimeve dhe tarifave të miratuara nga Këshilli Bashkiak, bazuar në raportet e hartuara nga Drejtoria përkatëse për shqyrtimin e aplikimeve në bashki.
2. Kryetari ka kompetencë të pezullojë ose të revokojë lejet e shfrytëzimit të hapësirave publike në rast shkeljesh të kushteve të përcaktuara në këtë rregullore. Vendimi merret mbi bazën e procesverbaleve ose raporteve të hartuar nga njësitë monitoruese dhe strukturat zbatuese të cilat i përcillen Kryetarit.
3. Masa e pezullimit ose e revokimit përcaktohet në varësi të shkallës dhe përsëritjes së shkeljes.
4. Subjekti njoftohet menjëherë për vendimin dhe ka të drejtë të ushtrojë ankim sipas procedurave ligjore, pa pezulluar ekzekutimin e masës.

Neni 9

Përgjegjësitë e Këshillit Bashkiak

1. Këshilli Bashkiak miraton tarifatat e shfrytëzimit të hapësirave publike sipas njërive administrative dhe vendos destinimin e të ardhurave për investime publike, bazuar në kërkesat dhe propozimet që i vijnë nga Drejtoritë përkatëse në Bashki.
2. Këshilli Bashkiak miraton politikatat e përgjithshme për menaxhimin e hapësirave publike në përputhje me rregulloren e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Përgjegjësitë e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit (IVMT)

1. Inspektoriatit Vendor i Mbrojtjes së Territorit, është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të rregullores në hapësirat publike dhe evidentimin e rasteve të shfrytëzimit pa leje ose në kundërshtim me lejen e dhënë sipas kushteve të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Mban procesverbale zyrtare për çdo shkelje të konstatuar. Procesverbalet hartohen sipas formateve të miratuara nga Bashkia dhe regjistrohen.
3. Raporton rastet e shkeljeve pranë Drejtorisë përkatëse në Bashki, sipas natyrës së shkeljes.
4. Në rastet kur pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve, inspektorët ndërhyjnë menjëherë për heqjen e pengesave duke caktuar afat të përcaktuar për korrigjimin e shkeljes.
5. Komunikon dhe ekzekuton urdhrat e Kryetarit të Bashkisë për pezullim apo revokim të lejes përkatëse.
6. Në rast nevojë, Inspektoriatit bashkëpunon me Policinë Bashkiake për ndërhyrje të menjëhershme në heqjen e pengesave dhe ekzekutimin e masave ndëshkuese. Në rast rezistence apo rreziku për rendin publik, kërkon ndihmën e Policisë së Shtetit.

Përgjegjësitë e Strukturave të Bashkisë

1. Drejtoria përkatëse për Urbanistikën dhe Planifikimit e Territorit kontrollon përputhshmërinë e projekteve të paraqitura me dokumentet e planifikimit dhe jep opinion teknik.
2. Drejtoria përkatëse për Shërbimet Publike menaxhon shërbimet që ofrohen në hapësirat publike dhe monitoron zbatimin e kushteve të kontratave të shfrytëzimit.
3. Ndërmarrjet përkatëse të pastrimit dhe gjelbërimit të Bashkisë janë përgjegjëse për pastrimin, gjelbërimin dhe mirëmbajtjen e prditshme të hapësirave publike, sipas përgjegjësiave.
4. Drejtoria e Financave Vendore/Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore administron tarifën dhe të ardhurat nga shfrytëzimi i hapësirës publike dhe mban Regjistrin Elektronik Unik të përmendur në Nenin 1, në bashkëadministrim me drejtorinë përkatëse, sipas vendimmarjes së secilës bashki.
5. Drejtoria Përkatëse për çështjet juridike, aseteve dhe/ose licencimit:
 - a. siguron asistencë juridike gjatë hartimit të kontratave të shfrytëzimit, dhe procedurave të licencimit;
 - b. monitoron zbatimin e lejeve dhe kontratave, verifikon përputhshmërinë e tyre me funksionin publik të hapësirës dhe mbështet procedurat ligjore për ndëshkime dhe revokime.
6. Drejtoritë përkatëse raportojnë periodikisht tek Kryetari i Bashkisë dhe informojnë/informojnë Këshilli Bashkiak mbi aktivitetin dhe problematikat në menaxhimin e hapësirave publike.

Institucionet qendrore dhe sektoriale

1. Autoritetet publike të përfshira në administrimin dhe kontrollin e hapësirave publike bashkëpunojnë ndërmjet tyre për shkëmbimin e informacionit, koordinimin e veprimeve dhe shmangien e mbivendosjeve;
2. Çdo autoritet ushtron kompetencat e veta në mënyrë të pavarur, në përputhje me legjislacionin sektorial që e rregullon, pa u kushtëzuar nga autoritetet të tjera, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht me ligj.
3. Në rast mospërputhje ndërmjet vendimeve të autoriteteve të ndryshme, ka përparësi akti i nxjerrë nga autoriteti që gëzon kompetencën e posaçme ligjore në fushën përkatëse.
4. Ministria përrgjegjëse për çështjet e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, përmes strukturave të saj, ushtron kontrole higjieno-sanitare për aktivitetet gastronomike dhe tregtare dhe verifikon dokumentacion shëndetësor në bashkëpunim me bashkitë.
5. Instituti i Shëndetit Publik ofron udhëzime teknike dhe standarde higjieno-sanitare.
6. Ministria përrgjegjëse për çështjet e mjedisit dhe turizmit, përmes strukturave të saj, monitoron plazhet publike, aktivitetet turistike dhe menaxhimin e mbetjeve. Gjithashtu, nëpërmjet strukturave të posaçme si:
 - a) Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA) shqyrton aplikimet për shfrytëzimin e hapësirave publike në plazhe, verifikon dokumentacionin e paraqitur dhe miraton aplikimet në portalin e-albania.
 - b) Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik (KMST) miraton listën e plazheve dhe hartën e stacioneve të plazheve, sipas tipologjive të tyre si dhe plazhet publike, bazuar në propozimet e njësisë të vetëqeverisjes vendore si dhe miraton afatin e lidhjes së kontratës për përdorimin e hapësirës së plazhit nga subjektet private;
7. Ministria përrgjegjëse për çështjet e Turizmit, Kulturës dhe Sportit monitoron aktivitetet në hapësirat publike që prekin monumentet e kulturës dhe trashëgiminë historike.

8. Ministria e Brendshme, përmes Policisë së Shtetit, mbështet bashkitë dhe IVMT për ruajtjen e rendit publik dhe menaxhimin e emergjencave në hapësirat publike.
9. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe Agjencinë kombëtare të Planifikimit të Territorit punojnë për përgatitjen e platformës online të hapësirave publike ku bashkitë japin informacion në mënyrë të vazhdueshme për lejet, tarifat, afatet.

Neni 13

Autoritetet e Ndërtimit

1. Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit (KKTU) është autoriteti përgjegjës vendimmarrës për lejet e ndërtimit, lejet e zhvillimit dhe akteve të tjera për kategoritë e hapësirave publike që janë në kompetencën e tij, sipas ligjit 107/2014 *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”* i ndryshuar.
2. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) kontrollon shfrytëzimin e hapësirave publike gjatë punimeve ndërtimore në kompetencë të KKTU-së dhe zbaton masat ndëshkuese në rast shkeljesh, në bashkërendim me Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit (IVMT-në).
3. Për hapësirat publike në kompetencë të njërive të vetëqeverisjes vendore, kompetencat për leje dhe kontrole ushtrohen nga Bashkia dhe IVMT, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Neni 14

Strukturat e sigurisë dhe emergjencave

1. Policia e Shtetit në përputhje me Ligjin nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar ushtron funksionet e saj për garantimin e rendit dhe sigurisë publike gjatë aktiviteteve me grumbullime të mëdha në hapësirat publike.
2. Shërbimi i Zjarrfikësve në përputhje me Ligjin Nr. 99/2024 *“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”* ndërhyjnë për garantimin e sigurisë kundër zjarrit gjatë aktiviteteve dhe panairove dhe manifestimeve në hapësira publike.
3. Shërbimi Kombëtar i Urgjencës Mjekësore, në përputhje me Ligjin Nr. 15/2016 *“Për shërbimin e urgjencës mjekësore para-spitalore”* siguron ndihmën e parë mjekësore dhe reagimin e menjëhershëm në rast emergjencash në hapësirat publike.
4. Rojet e Plazhit garantojnë në përputhje me Ligjin Nr. 93/2015 *“Për Turizmin”* i ndryshuar, sigurinë e pushuesve dhe ndërhyjnë në rastet e rrezikut për jetën në hapësirat bregdetare publike.

KREU III

SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NGA KATEGORIA E AKTIVITETEVE GASTRONOMIKE (BAR, RESTORANTE, HOTELERI DHE SHËRBIME TË NGJASHME) DHE REKREATIVE

Neni 15

Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit

Në këtë kre përcaktohen kushtet për përdorimin e hapësirave publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitete gastronomike (bare, restorante, kafene, fast-food, hoteleri dhe aktivitete të tjera të ngjashme) dhe rekreative. Përdorimi i hapësirave publike për këto aktivitete duhet të garantojë akses të lirë dhe pa barriera fizike për qytetarët, ruajtjen e karakterit urban, estetik dhe funksional të qytetit, si dhe përputhjen me legjislacionin në fuqi për mjedisin, turizmin, shëndetin publik dhe planifikimin e territorit.

Neni 16

Aktivitetet e lejuara në hapësirën publike


1. Në hapësirat publike lejohen të zhvillohen vetëm aktivitete që janë në përputhje me qëllimin e krijimit të tyre, duke respektuar funksionin, kushtet e përdorimit dhe shërbimet e lejuara, të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës për planifikimin dhe zhvillimin zhvillimin e territorit.
2. Aktivitetet e lejuara përfshijnë zgjerimin e aktiviteteve gastronomike dhe rekreative të subjekteve ekzistuese, të vendosura pranë këtyre hapësirave, me qëllim rritjen e kapaciteteve, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe përshtatjen me traditën mesdhetare të përdorimit të hapësirave të jashtme, në harmoni me karakteristikat klimatike dhe ritmin e jetës urbane.
3. Për qëllimet e këtij neni, aktivitetet e lejuara përfshijnë:
 - a) vendosjen e tavolinave, karrigeve dhe çadrave të lëvizshme për ofrimin e shërbimeve gastronomike (bare, restorante, kafene, hotele dhe aktivitete të ngjashme);
 - b) vendosjen e pajisjeve të lëvizshme të lojërave për fëmijë, të cilat duhet të jenë të përshtatshme për moshën e fëmijëve, të certifikuara për siguri sipas standardeve në fuqi, të mirëmbajtura në mënyrë të rregullt dhe të vendosura në kushte që garantojnë sigurinë, higjienën dhe mbikëqyrjen e tyre;
 - c) aktivitete të përkohshme kulturore dhe rekreative, të miratuara me leje nga autoriteti përgjegjës.
4. Në çdo rast, shfrytëzimi i hapësirave publike për këto aktivitete kryhet duke garantuar aksesin dhe lëvizjen e lirë të qytetarëve, si dhe duke respektuar kufizimet dhe kushtet e përcaktuara në këtë rregullore dhe duke ndaluar ndërtimin e strukturave të përhershme.
5. Aktivitetet e lejuara në hapësirat publike zhvillohen vetëm në përputhje me dokumentet e planifikimit të territorit, legjislacionin për turizmin dhe menaxhimin e plazheve, Kodin Rrugor, legjislacionin për trashëgiminë kulturore dhe aktet ligjore e nënligjore në fushën e shëndetit publik.
6. Përpara miratimit të lejeve të shfrytëzimit, Bashkia duhet të kryejë një analizë të hapësirave publike që jepen për këtë qëllim dhe, për zonat kryesore urbane dhe turistike, të miratojë projekte-koncept për përdorimin dhe trajtimin estetik të tyre, me synim ruajtjen e identitetit dhe harmonisë urbane. Në mungesë të analizës ose projekteve-koncept, lejet për shfrytëzim duhet të miratohen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore, duke garantuar akses publik, siguri dhe respektim të standardeve estetike dhe mjedisore.

Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat

1. Lejohet vetëm përdorimi i pajisjeve të përcaktuara në lejen për shfrytëzimin e hapësirës publike. Format, materialet dhe ngjyrat propozohen nga subjektet, në përputhje me projektin e mobilimit urban të miratuar nga bashkia për zonën përkatëse.
2. Në zona me rëndësi të veçantë social-kulturore ose ekonomiko-administrative, ku synohet ruajtja e një estetike urbane uniforme, formati, materialet dhe ngjyrat e pajisjeve mund të përcaktohen me urdhër ose vendim të autoriteteve vendore.
3. Pajisje të tjera, si tenda me strehë, tenda diellore ose struktura me bimësi kacavjerrëse, lejohen vetëm nëse janë parashikuar në një projekt publik specifik të mobilimit urban të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Në zonat me rëndësi historike ose të mbrojtura, miratimi jepet nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit / DRKK; në hapësirat bregdetare nga Ministria e Mjedisit / KMST; ndërsa për projektet madhore urbane dhe kombëtare, nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit (KKTU). Përdorimi i këtyre pajisjeve kryhet gjithmonë në përputhje me kushtet e përcaktuara në projektin e miratuar.”
4. Ndalohen në mënyrë kategorike:
 - a) vendosja e barrierave erëpritëse, vazove ose elementëve të tjerë që krijojnë barriera fizike;
 - b) vendosja e pedanave dhe tapeteve mbi hapësirat publike të gjelbëruara;
 - c) vendosja e pedanave dhe tapeteve në hapësira publike të investuara ose të rikonstruara.
 - d) Vendosja në fasadat e objekteve ku ushtrohet aktiviteti tregtar i elementeve/ pajisjeve/ tubat e aspirimit, por duhet të jenë të integruara në hapësirat e brëndshme të objektit dhe në lartësi të pranueshme mbi tarracat e objektit;
 - e) Skarat/ hejet elektrike apo me qymyr që nxirren në trotuare që nuk kanë sistemin e aspirimit si më sipër;
5. Përjashtimisht, pedanat dhe tapetet lejohen vetëm në hapësira publike të degraduara, të cilat përcaktohen me vendimarrje të bashkisë, kur mungojnë investimet publike ose private.
6. Materialet dhe ngjyrat e pajisjeve duhet të përshtaten me projektin publik nëse ka një të tillë, ose me rekomandimet estetike të Bashkisë.


Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat

1. Masa maksimale e lejuar për shfrytëzimin e hapësirës publike përcaktohet sipas llojit të hapësirës si më poshtë:
 - a) Trotuaret: Deri në 25% të gjerësisë së trotuarit, duke garantuar një hapësirë të lirë, pa pengesa, me një gjerësi minimale prej 200 cm për lëvizjen e lirë të këmbësorëve.
 - b) Sheshet: Deri në 25% të thellësisë së sheshit, por jo më shumë se 10 (dhjetë) m thellësi frontazhi, paralel me fasadën e objektit dhe duke garantuar një hapësirë me gjerësi minimale prej 200 cm për lëvizjen e lirë të këmbësorëve. *“Në çdo rast nuk lejohet bllokimi i korridoreve të qarkullimit ose i hyrjeve publike/ objekteve emergjente”.*



Ilustrimi 1-Masa e shfrytëzimit të hapësirër publike

- Në çdo rast subjektet janë të detyruara të marrin parasysh pengesat ekzistuese në terren (gropa pemësh, bordure) dhe elementë të tjerë urbanë ekzistues.



3. **Përfundim:** Në rastet kur ekziston një projekt specifik dhe i miratuar nga autoritetet, respektohen kushtet dhe distancat e përcaktuara në atë projekt.

Neni 19

Dokumentacioni dhe procedura e aplikimit për leje

1. Subjekti që kërkon të shfrytëzojë hapësirën publike në funksion të zhvillimit të aktiviteteve gastronomike dhe/ose rekreative duhet të pajiset me lejen përkatëse, e cila lëshohet nga struktura përgjegjëse në Bashki, sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.
2. Subjekti dorëzon në sekionin përkatës të portalit e-Albania:
 - a) Kërkesë për aplikim të plotësuar sipas formularit tip;
 - b) Genplan (duhet të pasqyrojë gjendjen eksituese dhe atë të propozuar, i pajisur me legjenden përkatëse, i pasuruar me elementet dhe kontekstin urban), planimetri ose skica të punuara, të firmosura e vulosura nga profesionist i licencuar në këtë fushë dhe duhet t'ju përmbahen me rigorozitet parametrave të vendosura në këtë rregullore. Skicat e punuara përfshijnë të paktën ilustrimet e projektit të propozuar si më poshtë:
 - Planimetri;
 - pamje;
 - prerje (të vulosura nga projektues i licencuar, shoqëruar me licencën dhe deklaratën e përgjegjësive profesionale);
 - c) Foto të gjendjes ekzistuese në të gjitha orientimet ku të jetë i qartë konteksti urban;
 - d) Rendra të punuara, firmosura e vulosura nga profesionist i licencuar në këtë fushë, që të pasqyrojnë veçmas dhe në mënyrë të qartë pamjetballore, pamjet anësore dhe për njësitë e mbyllura edhe një pamje të brendshme. Rrenderat duhet të pasurohen me specifikimet e materialeve të përdorura dhe në të gjitha rrenderat duhet të jenë të shënuar data e kryerjes së tyre.
 - e) Dokument që provon pronësinë apo qiranë e objektit ku ushtrohet aktiviteti ekonomik.
 - i. Për aktivitetet ekonomike me natyrë të vazhdueshme, është e detyrueshme paraqitja e NIPT-it dhe dokumentacionit fiskal përkatës.
 - f) Dokumentin e identifikimit të subjektit (NIPT) dhe vërtetimin e regjistrimit tatimor,
 - g) Struktura përgjegjëse kryen vlerësimin paraprak brenda 7 ditëve për plotësinë e dokumentacionit dhe njofton subjektin për çdo mungesë. Struktura përgjegjëse duhet të sigurojë vlerësim të paanshëm të aplikimeve, duke shmangur çdo konflikt interesi.
3. Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimmarrja përfundimtare realizohet brenda 15 ditëve kalendarike nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit të plotë. Pas miratimit të aplikimit Bashkia lëshon faturën ose dokumentin zyrtar për pagesën e tarifës, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.
4. Në rastet kur parashikohet vendosja e karrigeve, subjekti është i detyruar të mbjellë një pemë për çdo karrige të vendosur. Leja konsiderohet e vlefshme vetëm pas dokumentimit zyrtar të mbjelljes së pemëve dhe përmbushjes së plotë të detyrimeve tatimore dhe financiare përkatëse.
5. Leja për shfrytëzimin e hapësirës publike, së bashku me genplanin/planimetrinë, afishohet nga subjekti në një vend të dukshëm në ambientet e aktivitetit.

Neni 20
Afati i lejes

1. Afati i lejes për shfrytëzimin e hapësirave publike për aktivitete gastronomike dhe/ose rekreative është 2 (dy) vjeçar.
2. Me kërkesë të vetë subjektit kjo leje mund të lëshohet edhe për periudha sezonale, por në çdo rast jo më pak se 3 muaj.
3. Afati i lejes mund të rinovohet. Kërkesa për rinovimin e lejes depozitohet të paktën 45 ditë para përfundimit të lejes në fuqi. Rinovimi i lejes nuk është automatik, por varet nga verifikimi i përmbushjes së kushteve të lejes së mëparshme, shlyerjes së detyrimeve tatimore dhe moskryerjes së shkeljeve të kësaj rregulloreje.
Leja mund të pezullohet ose të revokohet edhe para afatit të saj, në rast shkeljesh të kushteve të përcaktuara në këtë rregullore ose në legjislacionin sektorial.
4. Nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë rregullore, afati i lejes mund të jepet për aq kohë sa zgjat aktiviteti.
5. Subjekti ka të drejtë të heqë dorë vullnetarisht nga leja për shfrytëzimin e hapësirave publike. Në këtë rast, dorëzimi i një njoftimi të shkruar pranë autoritetit kompetent është i detyrueshëm, duke specifikuar datën nga e cila leja konsiderohet e pavlefshme.

Neni 21
Lejet provizore

1. Për aktivitete të përkohshme me natyrë kulturore, tregtare, rekreative ose festive, të cilat zgjasin deri në 30 ditë, Bashkia lëshon leje provizore.
2. Leja provizore jepet për periudhën e zhvillimit të aktivitetit dhe nuk mund të rinovohet, por mund të ri-aplikohet për raste të tjera.
3. Procedura e aplikimit për leje provizore është e thjeshtuar dhe kërkon vetëm dokumentacionin bazë (kërkesë, skicë ose planimetria, dokument identifikimi/NIPT, dhe miratimet sektoriale sipas natyrës së aktivitetit).
4. Tarifat për lejet provizore përcaktohen nga Këshilli Bashkiak në bazë ditore ose javore.

Neni 22
Ndalimi i shfrytëzimit të hapësirës publike

1. Shfrytëzimi i hapësirës publike ndalohet në rastet kur:
 - a) bëhet pengesë për shikimin e sinjalistikës rrugore;
 - b) dëmton dhe cënon dekorin/estetikën e qytetit;
 - c) bie në kundërshtim me interesat e komunitetit;
 - d) bie në kundërshtim me distancën e sigurisë me stacionet e karburanteve e cila nuk mund të jetë më pak se 5(pesë)m distancë nga to;
 - e) në hapësirat përpara Monumenteve të Kulturës, duhet të jetë një hapësirë e konsiderueshme e cila të mos pengojë shikimin e monumentit;
 - f) në hapësirat me vlera të larta historike, me karakteristika të veçanta mund të jepet leje vetëm kur garantohet lëvizja e lirë e këmbësorëve dhe në përputhje me legjislacionin;
 - g) në kryqëzimet ku nuk ka semafor shfrytëzimi i hapësirës publike bëhet vetëm jashtë trekëndëshit të shikimit;
 - h) në një distancë 3(tre)m në afërsi të rampave apo shkallëve që përdorën për akse

Neni 23
Mirëmbajtja

1. Subjekti, i cili është pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike, duhet:
 - a. të garantojë pastrimin e përditshëm të hapësirës publike të shfrytëzuar;
 - b. të kryej mirëmbajtjen periodike sipas udhëzimeve të bashkisë, të hapësirës publike brenda një rrezeje prej 5 metrash nga kufiri i hapësirës së shfrytëzueshme, në përputhje me pamjen estetike të qytetit dhe të ruajë gjendjen higjeno-sanitare;
 - c. të mirëmbajë pajisjet në efikasitet të plotë dhe të mos vendos asnjë send tjetër, përveç atyre të miratuara në lejen për ushtrim aktiviteti (kutia ambalazhi, etj);
 - d. Çdo dëm që i shkaktohet hapësirës publike, përfshirë amortizimit si rezultat i kalimit të kohës apo përdorimit normal, apo qytetarëve nga aktiviteti që zhvillohet, do t'i faturohet subjektit i cili është i pajisur me leje. Dëmi ekonomik, përfshirë dëmtimin e trotuarit, pemëve apo hapësirës së gjelbër do të vlerësohet nga strukturat përkatëse të Bashkisë me akt administrativ, në përputhje me aktet e miratuara nga organet kompetente për këtë qëllim.

Neni 24
Kthimi i hapësirës publike

1. Në përfundim apo në rast anulimi të lejes, subjekti është i detyruar t'a lirojë hapësirën publike dhe t'a kthejë atë në gjendjen fillestare, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike. Gjendja fillestare dokumentohet me procesverbal dhe material fotografik të hartuar nga struktura përgjegjëse e Bashkisë në momentin e dhënies së lejes.
2. Në rast mospërmbushjeje të këtij detyrimi, kostot e rikthimit në gjendjen fillestare do t'i faturohen subjektit përgjegjës dhe do të ngarkohen si barrë mbi aktivitetin ekonomik që ka shfrytëzuar hapësirën, apo mbi çdo subjekt tjetër ekonomik që rezulton juridikisht i lidhur me të, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
3. Në rastet kur hapësira publike e paliruar pengon qarkullimin, aksesin publik ose cenon sigurinë, Bashkia dhe Policia Bashkiake kanë të drejtë të ndërhyjnë menjëherë për lirimin e saj, pa prituri afatin 5-ditor.
4. Subjekti është përgjegjës për çdo dëmtim të elementeve të infrastrukturës, gjelbërimit apo pajisjeve publike gjatë procesit të lirit të hapësirës.

Neni 25
Detyrimet financiare

1. Dhënia e çdo leje për shfrytëzimin e hapësirës publike kushtëzohet nga pagesa e një tarife në përputhje me sipërfaqen e hapësirës publike të zënë prej tij në metra katror (m²), duke reflektuar nivelin e çmimeve reale të faturuara nga aktivitetet e ushtruara dhe mbjellja e një peme për çdo karrige që vendoset në hapësirën publike.
2. Tarifa **përditësohet çdo 1 (një) vit** nga Këshilli Bashkiak, në përputhje me çmimet e evidentuara në kasat fiskale të subjekteve dhe bëhet publike në zonën në të cilën subjekti zhvillon aktivitetin.
3. **Për lejet afatgjata 2 (dy) – vjeçare ose më shumë, tarifa fillestare përcaktohet në kontratë** sipas vendimit të Këshillit Bashkiak në fuqi në momentin e dhënies së lejes.
4. Të ardhurat e siguruar nga ky tarifim destinohen ekskluzivisht për investime në infrastrukturën dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike në përputhje me vendimet e buxhetit të miratuara nga Këshilli Bashkiak

Masat ndëshkuese

1. Në rastet kur organet inspektuese konstatojnë shkelje të kushteve të përcaktuara në lejen për shfrytëzimin e hapësirës publike, ndaj subjektit do të merren masat ndëshkuese, si më poshtë:
 - a. Paralajmërim në vend (proces-verbal) me afat korrigjimi nga 2 (dy) deri në 5 (pesë) ditë;
 - b. Në rast moskorrigjimi, subjekti gjohet **jo më pak se 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror**, në varësi të sipërfaqes së shfrytëzuar dhe natyrës së shkeljes, dhe pajisjet e vendosura në kundërshtim me lejen sekuestrohen me akt administrativ.
 - c. Aktiviteti pezullohet deri në korrigjimin e plotë të shkeljes, por jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga data e pezullimit.
 - d. Nëse subjekti nuk ka korrigjuar shkeljen pas afatit maksimal të pezullimit, leja e shfrytëzimit të hapësirës publike revokohet automatikisht dhe subjekti nuk mund të riaplikojë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, për të gjitha hapësirat publike të administruara nga Bashkia.
 - e. Vendimi për pezullim ose anulim e lejes është i ankimeshëm në përputhje me legjislacionin për procedurat administrative.
2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, do të konsiderohen shkelje:
 - a. Ushtrimi i aktivitetit në një hapësirë më të madhe se ajo e përcaktuar në leje;
 - b. Instalimi i pajisjeve pa leje;
 - c. Mosmirëmbajtja e pajisjeve, kur kjo dëmton/cenon estetike e qytetit ose përbën rrezik për jetën e qytetarëve;
 - d. Mosmbajtja pastër e hapësirës së shfrytëzuar;
 - e. Mosshlyerja e tarifës së shfrytëzimit brenda afateve;
 - f. Prishja e qetësisë publike ose sjellja e padenjë;
 - g. Vazhdimi i aktivitetit edhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar në leje apo pas anulimit të saj;
 - h. Shfrytëzimi i hapësirës për aktivitet tjetër nga ai i lejuar;
 - i. Vendosja e barrierave që pengojnë qarkullimin dhe aksesin publik.

KREU IV**SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR EKSPOZIMIN E NJË KATEGORIE TË KUFIZUAR MALLRASH JASHTË NJËSISË SË TREGTIMIT****Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit**

1. Ky kre përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për shfrytëzimin e hapësirës publike për ekspozimin e një kategorie të kufizuar mallrash nga subjektet tregtare jashtë ambienteve të njësisë së tregtimit, me synim lehtësimin e aksesit të klientëve, gjallërimin e jetës urbane dhe përdorimin e kontrolluar të hapësirës publike.
2. Shfrytëzimi i hapësirës publike për këtë qëllim duhet të kryhet në përputhje me standardet e sigurisë dhe estetikës urbane, duke respektuar parimet e lëvizjes së lirë të qytetarëve dhe duke mos cenuar integritetin funksional të hapësirës publike.

Neni 28

Aktivitetet e lejuara në hapësirën publike

1. Lejohet ekspozimi në hapësirat publike e objekteve që nuk cenojnë lëvizjen e qytetarëve, sigurinë publike dhe estetikën urbane, për nga natyra dhe përmasat e tyre. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:
 - a. fruta dhe perime të freskëta;
 - b. lule dhe bimësi dekorative;
 - c. libra, revista dhe artikuj të ngjashëm.
 - d. produkte artizanale dhe suvenire të vogla;
 - e. artikuj të përditshëm të konsumit të përmasave të vogla, që shërbejnë si plotësim i aktivitetit tregtar të njësisë.
2. Ekspozimi i mallrave bëhet vetëm në funksion të shërbimit ndaj klientëve të njësisë përkatëse dhe nuk përbën zgjerim të aktivitetit tregtar përtej profilit të miratuar në lejen e ushtrimit të aktivitetit.

Neni 29

Pajisjet e lejuara dhe kriteret teknike

1. Pajisjet e lejuara për ekspozim përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në:
 - a. rafte, stenda ose banakë të çmontueshëm dhe të vetëqëndrueshëm, të punuar me materiale të harmonizuara me hapësirën publike;
 - b. koshe ose enë të lehta për fruta, perime apo lule;
 - c. stenda vertikale të ulëta për libra e revista;
 - d. hijezues të lëvizshëm dhe të çmontueshëm, jo të lidhur me fasadën e objektit, me impakt vizual sa më të ulët.
2. Pajisjet duhet të plotësojnë kriteret teknike si më poshtë:
 - a. Të mos fiksohen në tokë ose fasadë;
 - b. të kenë lartësi maksimale deri në 100 cm kur vendosen në mes të hapësirës dhe deri në 180 cm kur mbështeten në fasadë;
 - c. të vendosen jo më larg se 1 (një) metër nga fasada e njësisë tregtare;
 - d. të jenë të ndërtuara me material rezistente, estetike dhe të mirëmbajtura rregullisht;
 - e. të mos krijojnë pengesa ose barrierë për qarkullimin e këmbësorëve dhe për qasjen në hapësirat publike;
 - f. të respektojnë distancat minimale të përcaktuara për përdorimin e hapësirës publike, sikundër janë përcaktuar në këtë rregullore
3. Subjekti që shfrytëzon hapësirën publike është i detyruar:
 - a. Të afishojë qartë çmimet e produkteve të ekspozuara;
 - b. të ruajë pastërtinë e zonës së shfrytëzuar dhe të sigurojë mirëmbajtjen e saj gjatë gjithë kohës së ushtrimit të aktivitetit;
 - c. për artikujt ushqimorë, të pajiset me vërtetim higjieno-sanitar dhe librezë shëndetësore për punonjësit;
 - d. të grumbullojë mbetjet në vendet e caktuara dhe t'i largojë menjëherë pas përfundimit të orarit të punës;
 - e. të mos depozitojë mallra rezervë, amballazhe ose pajisje ndihmëse jashtë hapësirës së lejuar.
4. Respektimi i kriterëve të përcaktura në këtë nen, verifikohet nga struktura përgjegjëse e bashkisë për administrimin e hapësirave publike si dhe nga organet e tjera mbikëqyrëse të ngarkuara me ligj, sipas fushës së tyre të kompetencës.

Neni 30

Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat

1. Masa maksimale e lejuar për shfrytëzimin e hapësirës publike përcaktohet sipas llojit të hapësirës si më poshtë:
2. Trotuaret: Deri në 25% të gjerësisë së trotuarit, duke garantuar një hapësirë minimale me një gjerësi prej 200 cm për lëvizjen e lirë të këmbësorëve.
3. Sheshet: Deri në 25% të gjerësisë së sheshit, por jo më shumë se 10 (dhjetë) m thellësi frontazhi, paralel me fasadën e objektit dhe duke garantuar një hapësirë minimale me një gjerësi prej 200 cm për lëvizjen e lirë të këmbësorëve. *Në çdo rast nuk lejohet bllokimi i korridoreve të qarkullimit ose i hyrjeve publike/objekteve emergjente.*
4. Në çdo rast subjektet janë të detyruara të marrin parasysh pengesat ekzistuese në terren (gropa pemësh, bordure) dhe elementë të tjerë urbanë ekzistues.
5. **Përfashtim:** Në rastet kur ekziston një projekt specifik dhe i miratuar nga autoritetet, respektohen kushtet dhe distancat e përcaktuara në atë projekt.

Neni 31

Procedura e aplikimit për leje

1. Për këtë kategori leje dhe të gjitha kategoritë e lejeve në këtë rregullore, për subjektet e pajisura me NIPT duhet të depozitohet Ekstrakti i QKB ose vërtetimi i regjistrimit të personit juridik në gjykatë.
2. Subjekti paraqet në seksionin përkatës të portalit e-Albania kërkesën për aplikim, sipas formularit TIP, të shoqëruar me dokumentacionin:
 - a. Genplan (duhet të pasqyrojë gjendjen eksituese dhe atë të propozuar, i pajisur me legjenden përkatëse, i pasuruar me elementet dhe kontekstin urban), planimetri ose skica të punuara, të firmosura e vulosura nga profesionist i licencuar në këtë fushë dhe duhet t'ju përmbahen me rigorozitet parametrave të vendosura në këtë rregullore. Skicat e punuara përfshijnë të paktën ilustrimet e projektit të propozuar si më poshtë:
 - Planimetri;
 - pamje;
 - prerjeSkicat e mësipërme duhet të jenë të vulosura nga projektues i licencuar, shoqëruar me licencën dhe deklaratën e përgjegjësisë profesionale;
 - b. Foto të gjendjes ekzistuese në të gjitha orientimet ku të jetë i qartë konteksti urban;
 - c. Dokument pronësie ose kontratë qiraje së njësisë tregtare. Në rastin e kontratës së qirasë, duhet të korrespondojë afati i kërkesës për ushtrimin e aktivitetit me afatin e lëshimit të kontratës në përdorim;
 - d. NIPT dhe vërtetim tatimor dhe/ose ekstrakt nga QKB;
 - e. Individët mund të aplikojnë me letërnjoftim elektronik vetëm për aktivitete të përkohshme artizanale, kulturore ose rekreative pa natyrë tregtare;
 - f. Për aktivitetet ekonomike me natyrë të vazhdueshme, është e detyrueshme paraqitja e NIPT-it dhe dokumentacionit fiskal përkatës.
3. Struktura përgjegjëse kryen vlerësimin paraprak brenda 7 ditëve për plotësinë e dokumentacionit dhe njofton subjektin për çdo mungesë. Struktura përgjegjëse duhet të sigurojë vlerësim të paanshëm të aplikimeve, duke shmangur çdo konflikt interesi.

4. Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimmarrja përfundimtare realizohet brenda 15 ditëve kalendarike nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit të plotë. Pas miratimit të aplikimit Bashkia lëshon faturën ose dokumentin zyrtar për pagesën e tarifës, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.
5. Leja bëhet e vlefshme vetëm pas pagesës.
6. Leja për shfrytëzimin e hapësirës publike, së bashku me genplanin/planimetrinë, afishohet nga subjekti në një vend të dukshëm në ambientet e aktivitetit.

Neni 32

Afati dhe rinovimi i lejes

1. Leja jepet për një afat maksimal 2 (dy) vjet.
2. Me kërkesë të subjektit, leja mund të jetë sezonale, por jo më pak se 3 (tre) muaj.
3. Rinovimi kërkohet jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë para përfundimit të afatit.
4. Rinovimi i lejes nuk është automatik, por varet nga verifikimi i përmbushjes së kushteve të lejes së mëparshme, shlyerjes së detyrimeve tatimore dhe moskryerjes së shkeljeve të kësaj rregulloreje.
5. Leja mund të pezullohet ose të revokohet edhe para afatit të saj, në rast shkeljesh të kushteve të përcaktuara në këtë rregullore ose në legjislacionin sektorial.

Neni 33

Ndalimet

1. Shfrytëzimi i hapësirës publike ndalohet në rastet kur:
 - a. bëhet pengesë për shikimin e sinjalisitikës rrugore;
 - b. dëmton dhe cënon dekorin/estetikën e qytetit;
 - c. bie në kundërshtim me interesat e komunitetit;
 - d. bie në kundërshtim me distancën e sigurisë me stacionet e karburanteve e cila nuk mund të jetë më pak se 5m distancë nga to;
 - e. në hapësirat përpara Monumenteve të Kulturës, duhet të jetë një hapësirë e konsiderueshme e cila të mos pengojë shikimin e monumentit;
 - f. në hapësirat me vlera të larta historike, me karakteristika të veçanta mund të jepet leje vetëm kur garantohet lëvizja e lirë e këmbësorëve dhe në përputhje me legjislacionin;
 - g. në kryqëzimet ku nuk ka semafor, shfrytëzimi i hapësirës publike bëhet vetëm jashtë trekëndëshit të shikimit;
 - h. në një distancë 3m në afërsi të rampave apo shkallëve që përdorën për akses, nuk lejohet përdorimi i hapësirës publike
 - i. bllokojnë korridoret e qarkullimit ose hyrjet publike dhe/ose emergjente dhe tejkalojnë masën maksimale të lejuar për shfrytëzim.

Neni 34

Mirëmbajtja

1. Subjekti detyrohet të mbajë pastër në mënyrë periodike sipas udhëzimeve të bashkisë, hapësirën e shfrytëzuar dhe rrezen prej 5 (pesë) metrash përreth saj.
2. Pajisjet duhet të mirëmbahen në gjendje estetike dhe funksionale, duke u zëvendësuar menjëherë në rast dëmtimi.
3. Çdo dëm që i shkaktohet hapësirës publike apo qytetarëve nga aktiviteti që zhvillohet, do t'i faturohet subjektit i cili është i pajisur me leje. Dëmi ekonomik, përfshirë dëmtimin e trotuarit, pemëve apo hapësirës së gjelbër do të vlerësohet nga strukturat përkatëse të

Bashkisë me akt administrativ, në përputhje me aktet e miratuara nga organet kompetente për këtë qëllim.

Neni 35

Kthimi i hapësirës publike

1. Pas përfundimit të lejes ose në rast të anulimit të saj, subjekti është i detyruar t'a lirojë hapësirën publike brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike. Gjendja fillestare dokumentohet me procesverbal dhe material fotografik të hartuar nga struktura përgjegjëse e Bashkisë në momentin e dhënies së lejes.
2. Në rast të mosrespektimit të pikës mësipër, kostot e rikthimit në gjendjen fillestare i faturohen subjektit dhe ngarkohen si barrë mbi aktivitetin ekonomik që ka shfrytëzuar hapësirën, apo mbi çdo subjekt tjetër ekonomik që rezulton juridikisht i lidhura me të, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
3. Në rastet kur hapësira publike e paliruar pengon qarkullimin, aksesin publik ose cenon sigurinë, Bashkia dhe Policia Bashkiake kanë të drejtë të ndërhyjnë menjëherë për lirimim e saj, pa prituri afatin 5-ditor.
4. Subjekti është përgjegjës për çdo dëmtim të elementeve të infrastrukturës, gjelbërimit apo pajisjeve publike gjatë procesit të lirimimit të hapësirës.

Neni 36

Detyrimet financiare

1. Tarifa e shfrytëzimit përcaktohet sipas sipërfaqes së zënë për metër katror (m²) dhe zonës së qytetit ku ndodhet njësia. Kjo tarifë përditësohet çdo 1 (një) vit nga Këshilli Bashkiak, në bazë të nivelit mesatar të çmimeve të faturuara sipas zonave.
2. Për lejet afatgjata (2-vjeçare), tarifa fillestare përcaktohet në kontratë sipas vendimit të Këshillit Bashkiak në fuqi në momentin e dhënies së lejes.
3. Të ardhurat nga këto tarifa përdoren ekskluzivisht për investime në infrastrukturën dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike në përputhje me vendimet e buxhetit të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

Neni 37

Masat ndëshkuese

1. Në rastet kur organet inspektuese konstatojnë shkelje të kushteve të përcaktuara në lejen për shfrytëzimin e hapësirës publike, ndaj subjektit do të merren masat ndëshkuese, si më poshtë:
 - a. Paralajmërim në vend (proces-verbal) me afat korrigjimi nga 2 (dy) deri në 5 (pesë) ditë;
 - b. Në rast moskorrigjimi, subjekti **gjobitet jo më pak se 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror**, në varësi të sipërfaqes së shfrytëzuar dhe natyrës së shkeljes, dhe pajisjet e vendosura në kundërshtim me lejen sekuestrohen me akt administrativ.
 - c. Aktiviteti pezullohet deri në korrigjimin e plotë të shkeljes, por jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) ditë.
 - d. Nëse subjekti nuk ka korrigjuar shkeljen pas afatit maksimal të pezullimit, leja e shfrytëzimit të hapësirës publike revokohet automatikisht dhe subjekti nuk mund të riaplikojë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, për të gjitha hapësirat publike të administruara nga Bashkia.
 - e. Vendimi për pezullim ose anulim është i ankimueshëm në përputhje me legjislacionin për procedurat administrative.
2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, do të konsiderohen shkelje:
 - a. Ushtrimi i aktivitetit në një hapësirë më të madhe se ajo e përcaktuar në leje

- b. Instalimi i pajisjeve pa leje;
- c. Mosmirëmbajtja e pajisjeve, kur kjo dëmton/cenon estetikën e qytetit ose përbën rrezik për jetën e qytetarëve;
- d. Mosmbajtja pastër e hapësirës së shfrytëzuar;
- e. Mosshlyerja e tarifës së shfrytëzimit brenda afateve;
- f. Prishja e qetësisë publike ose sjellja e padenjë;
- g. Vazhdimi i aktivitetit edhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar në leje apo pas anulimit të saj;
- h. Shfrytëzimi i hapësirës për aktivitet tjetër nga ai i lejuar;
- i. Vendosja e barrierave që pengojnë qarkullimin dhe aksesin publik.

KREU V

SHFRYTËZIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE – TREGJE DHE AKTIVITETE AMBULATORE

Neni 38

Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit

Ky kre përcakton rregullat, kriteret dhe kushtet për shfrytëzimin e hapësirave publike për zhvillimin e tregjeve dhe aktiviteteve ambulante, me qëllim ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për qytetarët, në përputhje me standardet e higjienës, sigurisë, estetikës urbane, si dhe garantimin e lëvizjes së lirë dhe të pandërprerë të këmbësorëve.

Neni 39

Aktivitetet e lejuara në hapësirën publike

1. Në hapësirat publike lejohen aktivitetet e mëposhtme:
 - a. Organizimi i tregjeve të përkohshme ose sezonale për produkte ushqimore, artizanale, bujqësore dhe mallra të ngjashme;
 - b. Shitja ambulante e produkteve të lejuara, përmes karrocave, stendave të lëvizshme, apo biçikletave tregtare, duke përfshirë fruta, perime, lule, akullore, suvenire, produkte artizanale të vogla dhe të tjera të ngjashme;
2. Bashkia përcakton paraprakisht hapësirat ku mund të organizohen tregjet, së bashku me perimetrin e zhvillimit dhe skemën e organizimit, të cilat përfshihen si pjesë e dokumentacionit të miratuar të lejes
3. Shitja ambulante lejohet vetëm në zonat e përcaktuara me vendim të Bashkisë dhe ndalohet ushtrimi i saj në mënyrë të pakontrolluar ose jashtë hapësirave të autorizuara.

Neni 40

Vendosja dhe kriteret teknike të pajisjeve jashtë njësisë së tregtimit

1. Për vendosjen e pajisjeve jashtë njësisë së tregtimit lejohet përdorimi i stendave të çmontueshme dhe të vetëqëndrueshme, karrocave portative, biçikletave tregtare, stendave të lëvizshme, si dhe çadrave dielli dhe hijezuesve të lëvizshëm, pa fiksime në tokë ose fasadë dhe me impakt vizual minimal.
2. Pajisjet duhet të jenë funksionale, të mirëprezentuara estetikisht, të çmontueshme dhe të vetëqëndrueshme dhe të mirembajtura rregullisht.

3. Lartësia maksimale e stendave nuk duhet të jetë më e madhe se 90 cm me përjashtim të hijzuesve dhe çadrave të diellit, për të cilët lartësia maksimale lejohet deri në 220 cm.
4. Dimensionet maksimale të karrocave dhe stendave do të kenë gjerësi 1,5 metra dhe gjatësi 2 metra.
5. Materialet e pajisjeve duhet të jenë rezistente, higjienike dhe të mirëmbajtura, në mënyrë që të garantojnë sigurinë e përdoruesve dhe të ruajnë estetikën e hapësirës publike.
6. Pajisjet nuk duhet të jenë të fiksuara në tokë ose në fasadën e ndërtesës, duke lejuar lëvizshmërinë dhe vendosjen e përkohshme sipas nevojës së tregtarit dhe rregullave të Bashkisë.
7. Pajisjet nuk duhet të vendosen në hyrjet e banesave ose institucioneve publike dhe duhet të respektojnë distancat minimale si më poshtë:
 - a. jo më afër se 2 metra nga brinja e jashtme e hyrjes së banesave dhe institucioneve publike;
 - b. jo më afër se 5 metra nga hyrjet e emergjencave të spitaleve dhe shërbimeve zjarrfikëse;
 - c. jo më afër se 3 metra nga brinja e jashtme e perimetrit të kryqezimit rrugor apo aksit, semaforët dhe stacionet e transportit publik;
 - d. jo më afër se 1 (një) meter nga elementët e infrastrukturës urbane (stola, pemë, kosha mbeturinash, ndriçim publik);
 - e. jo më afër se 10 metra nga monumente kulture dhe objekte të mbrojtura. Në çdo rast prevalojnë përcaktimet e legjislacionit sektorial

Neni 41

Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat

1. Për çdo subjekt që ushtron aktivitet tregtar në hapësirat publike i lejohet një sipërfaqe maksimale prej:
 - a. 6 m² për pjesëmarrësit në tregjet e përkohshme ose sezonale;
 - b. 4 m² për aktivitetet ambulante jashtë tregjeve të organizuara.
2. Organizimi dhe vendosja e stendave, karrocave, biçikletave tregtare dhe pajisjeve të tjera të lejuara bëhet sipas skemës së tregut të miratuar ose të konfirmuar nga Bashkia, duke respektuar orientimin dhe pozicionimin e parashikuar në dokumentacionin e lejes.
3. Gjithmonë duhet të garantohet një hapësirë minimale prej 200 cm për lëvizjen e lirë të këmbësorëve, në mënyrë që të sigurohet qarkullim i sigurt dhe i pa penguar në zonat e trafikut të këmbësorëve.
4. Mes stendave duhet të krijohen korridore paralele dhe të rregullta, me gjerësi të mjaftueshme për të lejuar qarkullimin e lirë, aksesin e emergjencës dhe evakuimin e sigurt të personave në rast nevojë.
5. Distanca minimale e hapësirës publike në shfrytëzim nga hyrjet e ndërtesave duhet të jetë 3 m, për të garantuar akses të pa penguar për përdoruesit dhe shërbimet e emergjencës.
6. Distanca minimale e hapësirës publike në shfrytëzim nga stacionet e transportit publik, si ndalesa autobusi ose taksish, duhet të jetë 5 m, për të mos penguar hyrje-daljet dhe për të ruajtur sigurinë e përdoruesve.
7. Bashkia ka të drejtë të vendosë masa shtesë ose kufizime për hapësirat e veçanta, në përputhje me rregullat e urbanistikës, sigurinë e publikut dhe rregullimin e qarkullimit, si dhe për të siguruar rendin dhe higjienën në hapësirat publike.

Dokumentacioni dhe procedura e aplikimit për leje

1. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë në seksionin përkatës të portalit e-Albania kërkesën për të ushtruar tregtinë ambulante në tregjet e përkohshme ose sezonale e cila duhet të shoqërohet me dokumentacionin vijues:
2. Subjekti dorëzon në seksionin përkatës të portalit e-Albania:
 - a. Genplan (duhet të pasqyrojë gjendjen eksituese dhe atë të propozuar, i pajisur me legjenden përkatëse, i pasuruar me elementet dhe kontekstin urban), planimetri ose skica të punuara, të firmosura e vulosura nga profesionist i licencuar në këtë fushë dhe duhet t'ju përmbahen me rigorozitet parametrave të vendosura në këtë rregullore. Skicat e punuara përfshijnë të paktën ilustrimet e projektit të propozuar si më poshtë:
 - i. Planimetri;
 - ii. pamje;
 - iii. prerje (të vulosura nga projektues i licencuar, shoqëruar me licencën dhe deklaratën e përgjegjesisë profesionale);
 - b. Foto të gjendjes ekzistuese në të gjitha orientimet ku të jetë i qartë konteksti urban;
 - c. Dokumentin e identifikimit të subjektit (NIPT nga Drejtoria Rajonale Tatimore) dhe vërtetimin e regjistrimit tatimor;
 - d. Vërtetim tatimor dhe vërtetim shëndetësor, përkatësisht për produktet ushqimore;
 - e. Për aktivitetet ekonomike me natyrë të vazhdueshme, është e detyrueshme paraqitja e NIPT-it dhe dokumentacionit fiskal përkatës;
 - f. Për tregtarët e produkteve ushqimore, vërtetim higjieno-sanitar dhe librezë shëndetësore për punonjësit;
 - g. Fotografitë e pajisjes së propozuar për ushtrimin e aktivitetit.
3. Struktura përgjegjëse kryen vlerësimin paraprak brenda 7 (shtatë) ditëve për plotësinë e dokumentacionit dhe njofton subjektin për çdo mungesë. Struktura përgjegjëse duhet të sigurojë vlerësim të paanshëm të aplikimeve, duke shmangur çdo konflikt interesi.
4. Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimarrja përfundimtare realizohet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit të plotë.
5. Pas miratimit të aplikimit Bashkia lëshon faturën ose dokumentin zyrtar për pagesën e tarifës, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.
6. Leja për shfrytëzimin e hapësirës publike, së bashku me genplanin/planimetrinë, afishohet nga subjekti në një vend të dukshëm në ambientet e aktivitetit

Afati i lejes

1. Leja ka afat maksimal një (1) vjeçar për këtë kategori aktivitetesh dhe mund të rinovohet në përfundim të këtij afati, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

Kufizimet dhe ndalesat në ushtrimin e aktivitetit në tregje dhe aktivitete ambulante

1. Ndalohet shfrytëzimi i hapësirave publike për tregtinë ambulante kur cenon rendin, sigurinë, higjienën ose interesin publik, duke përfshirë ndër të tjera dhe rastet e mëposhtme:
 - a. Shitja e produkteve të pakontrolluara, të paregjistruara ose të pasigurta për konsum publik ose që nuk plotësojnë standardet ligjore të sigurisë ushqimore dhe të cilësisë;

- b. Ushtrimi i aktivitetit jashtë zonave të përcaktuara dhe të miratuara nga Bashkia ose pa lejen perkatese;
- c. Lënia e pajisjeve, stendave ose karrocave jashtë orarit të lejuar të ushtrimit të aktivitetit apo depozitimi i tyre në hapësirën publike pa leje;
- d. Shitja ambulante pranë shkollave, spitaleve, institucioneve publike, monumenteve të kulturës ose objekteve të sigurisë së lartë ose të tjera ndërtesa të rëndësishme, pa marrë aprovimin/konfirmim nga institucioni pranë të cilin kërkojnë të ushtojnë aktivitetin;
- e. Çdo veprim që pengon lëvizjen e këmbësorëve, qarkullimin e mjeteve të transportit publik, hyrjen dhe daljen e lirë në ndërtesa ose që krijon rrezik për sigurinë e publikut.
- f. përdorimi i pajisjeve ndriçuese, zanore ose reklamave të tjera me impakt të lartë vizual e akustik, të cilat krijojnë ndotje vizuale, ndotje akustike ose shqetësim për komunitetin.

Neni 45

Mirëmbajtja dhe përgjegjësitë e subjekteve

1. Mirëmbajtja e zakonshme e infrastrukturës fizike të tregjeve publike, fiks dhe/ose të lëvizshëm, si edhe pastrimi i përgjithshëm i tregut apo i vendit ku është vendosur pajisja ambulante, kryhet nga Bashkia në përfundim të orarit të tregtimit, pas heqjes së pajisjeve dhe largimit të tregtarëve.
2. Subjektet që ushtojnë aktivitetin e tregtisë ambulante janë të detyruara të:
 - a) Mbajnë pastër çdo ditë hapësirën e shfrytëzuar;
 - b) Mbledhin dhe largojnë mbetjet pas çdo dite aktiviteti;
 - c) Për aktivitetet ambulante, të kujdesen për hapësirën publike përreth në një rreze prej dy (2) metrash nga fundi i hapësirës së shfrytëzuar;
 - d) Për tregjet, të kujdesen për hapësirën publike përreth në një rreze prej pesë (5) metrash nga perimetri i stendës;
 - e) Sigurojnë mirëmbajtjen estetike dhe funksionale të pajisjeve;
 - f) Te mos dëmtojnë infrastrukturën fizike të tregjeve publike dhe duhet të respektojnë sipërfaqen që u është dhënë në përdorim bazuar në lejen e marrë;
 - g) Nuk duhet të hedhin mbeturina apo mbetje të çdo lloji në tokë, por duhet t'i grumbullojnë dhe të i depozitojnë në vendet e caktuara për këtë qëllim.
3. Bashkia ka të drejtë të ndërmarrë kontrole periodike për verifikimin e respektimit të këtyre detyrimeve dhe të marrë masa sipas ligjit në fuqi.

Neni 46

Kthimi i hapësirës publike

1. Në përfundim të afatit të lejes ose në rast të anulimit të saj, subjekti, në varësi të natyrës së aktivitetit (tregtim në tregjet publike fiks dhe/ose të lëvizshëm, apo tregtim ambulator), është i detyruar t'a lirojë plotësisht hapësirën publike të përdorur dhe ta rikthejë atë në gjendjen e saj fillestare, brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh kalendarike nga data e përfundimit ose e njoftimit për anulimin e lejes. Gjendja fillestare dokumentohet me procesverbal dhe material fotografik të hartuar nga struktura përgjegjëse e Bashkisë, në momentin e dhënies së lejes.
2. Në rast të mospërmbushjes së detyrimit, Bashkia do të kryejë vetë rikthimin e hapësirës publike në gjendjen fillestare, duke faturuar kostot e shërbimit ndaj subjektit përkatës. Këto kosto konsiderohen detyrim financiar i detyrueshëm dhe ngarkohen mbi aktivitetin

ekonomik të licencuar, si dhe, kur është e aplikueshme, mbi subjektet juridikisht të lidhura me të, deri në shlyerjen e plotë të tyre.

3. Në rastet kur hapësira publike e paliruar pengon qarkullimin, aksesin publik ose cënon sigurinë, Bashkia dhe Policia Bashkiake kanë të drejtë të ndërhyjnë menjëherë për lirimin e saj, pa pritur afatin 5 (pesë) ditor.
4. Subjekti është përgjegjës për çdo dëmtim të elementëve të infrastrukturës, gjelbërimit apo pajisjeve publike që shkaktohet gjatë procesit të lirimit të hapësirës.

Neni 47

Detyrimet financiare

1. Tarifa për shfrytëzimin e hapësirës publike përcaktohet në bazë të sipërfaqes së zënë, e shprehur në metra katrorë (m²) dhe diferencohet sipas zonës dhe llojit të aktivitetit, duke bërë dallim ndërmjet:
 - a. tregjeve të organizuara;
 - b. aktiviteteve ambulante individuale.
2. Të ardhurat e mbledhura nga kjo tarifë përdoren në mënyrë të dedikuar dhe ekskluzive për mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe përmirësimin e tregjeve publike, si dhe të hapësirave përkatëse të destinuara për zhvillimin e këtyre aktiviteteve.

Neni 48

Masat ndëshkuese

1. Në rastet kur, organet inspektuese konstatojnë shkelje të kushteve të përcaktuara në lejen për shfrytëzimin e hapësirës publike, ndaj subjektit do të merren masat ndëshkuese si më poshtë:
 - a. Paralajmërim në vënd (process-verbal) me afat korigjimi nga 2 (dy) deri në 5 (pesë) ditë.
 - b. Në rast moskorigjimi, subjekti gjohet **jo më pak se 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror**, në varësi të sipërfaqes së shfrytëzuar dhe natyrës së shkeljes, dhe pajisjet e vendosura në kundërshtim me lejen sekuestrohen me akt administrativ.
 - c. Aktiviteti pezullohet deri në korigjimin e plotë të shkeljes, por jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) ditë nga data e pezullimit.
 - d. Nëse subjekti nuk ka korigjuar shkeljen pas afatit maksimal të pezullimit, leja e shfrytëzimit të hapësirës publike revokohet automatikisht dhe subjekti nuk mund të riaplikojë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, për të gjitha hapësirat publike të administruara nga Bashkia.
 - e. Vendimi për pezullimin ose anulimin është i ankimueshëm në përputhje me legjislacionin për procedurat administrative.
2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, do të konsiderohen shkelje:
 - a. Ushtrimi i aktivitetit në një hapësirë më të madhe se ajo e përcaktuar në leje
 - b. Instalimi i pajisjeve pa leje;
 - c. Mosmirëmbajtja e pajisjeve, kur kjo dëmton/cenon estetikën e qytetit ose përbën rrezik për jetën e qytetarëve;
 - d. Mosmbajtja pastër e hapësirës së shfrytëzuar;
 - e. Mosshlyerja e tarifës së shfrytëzimit brenda afateve;
 - f. Prishja e qetësisë publike ose sjellja e padenjë;
 - g. Vazhdimi i aktivitetit edhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar në leje apo pas anulimit të saj;

- h. Shfrytëzimi i hapësirës për aktivitet tjetër nga ai i lejuar;
- i. Vendosja e barrierave që pengojnë qarkullimin dhe aksesin publik.

KREU VI

SHFRYTËZIMI I DISA HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR VENDOSJEN E KIOSKAVE

Neni 49

Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit

1. Ky kre përcakton kushtet dhe rregullat për vendosjen e kioska portative në hapësira publike të përcaktuara nga Bashkia, me qëllim ofrimin e shërbimeve ose mallrave për qytetarët, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa cenuar lëvizjen e lire të këmbësorëve, higjenën, sigurinë dhe estetikën e hapësirës publike.
2. Vendosja e kioskave portative, ndalohe të:
 - a. Kryqëzime rrugësh, ku pengohet fushëpamja ose siguria e qarkullimit;
 - b. Pjesën e jashtme të trotuarit, buzë rrugës, me shpinë nga rruga;
 - c. Hapësira ku, brenda një rrezeje prej 200 (dyqind) metrash, funksionojnë shërbime të ngjashme në struktura të përhershme.
 - d. Zona të shpallura me interes kulturor, historik ose turistik, ku instalimi i tyre bie ndesh me mbrojtjen e peizazhit dhe estetikën urbane, përveç rasteve të miratuara me vendim të posaçëm nga Bashkia.

Neni 50

Aktivitetet e lejuara në hapësirën publike

1. Në kioskat e vendosura në hapësira publike lejohet:
 - a. Shitja e gazetave, librave, revistave dhe materialeve të ngjashme;
 - b. Shitja e produkteve të vogla ushqimore të paketuara, ;
 - c. Shitja e suvenireve, kartolinave, artikujve artizanale dhe produkteve të ngjashme.
 - d. Ofrimi i shërbimeve të vogla asistuese, përfshirë informacion turistik dhe shitje të biletave të transportit urban.

Neni 51

Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat

1. Kioska duhet të jenë të lëvizshme, të çmontueshme dhe të vetëqëndrueshme.
2. Dimensionet maksimale:
 - i. Gjatësi: 2,5 m;
 - ii. Gjerësi: 1,5 m;
3. Lartësi: 2, m;Kioskat duhet të kenë dizajn uniform, sipas modelit ose modeleve të miratuara nga Bashkia.kioskutkioskës
4. Materialet duhet të jenë të qëndrueshme, rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe me impakt vizual minimal.
5. Ngjyrat dhe grafika duhet të jenë neutrale dhe të harmonizuara me mjedisin.
6. Tregtimi i produkteve duhet të kryhet brenda kioskes ose në fasadën e saj të jashtme, pa elementë shtesë në hapësirën publike, si frigoriferë, tavolina, stola, depozitime malli,

gjeneratorë apo pajisje ndihmëse të tjera. Të gjitha pajisjet funksionale, përfshirë frigoriferët dhe elementët e reklamës, duhet të jenë të inkuorporuara brenda kioskës dhe nuk lejohet tejkalimi i dimensioneve maksimale të përcaktuara në këtë nen.

Neni 52

Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat

1. Kioskët vendosen vetëm në hapësirat e përcaktuara paraprakisht nga Bashkia dhe sipas planvendosjes së miratuar.
2. Hapësira e zënë nga një kioskë nuk mund të kalojë 6 (gjashtë) m² dhe duhet të jetë në përputhje me tipologjinë e miratuar, me përmasa 1.8 m x 2,8 m. Streha e kioskës nuk lejohet të dalë më shumë se 50 cm nga trupi i saj, ndërsa sipërfaqja e reklamës nuk mund të kalojë sipërfaqen më shumë se 1m² dhe duhet të jetë e integruar në strukturën e kioskës.
3. Shfrytëzimi i hapësirës publike nuk mund të jetë më shumë se 25 (njëzet e pesë) % e gjerësisë së trotuarit ose hapësirës publike ku vendoset.
4. Duhet të garantohet gjithmonë një hapësirë minimale prej 2 (dy)m për lëvizjen e lirë të këmbësorëve
5. Distanca minimale:
 - a. nga hyrjet e ndërtesave: 3 (tre) m.;
 - b. nga stacionet e transportit publik dhe korsitë e biçikletave: 5 (pesë) m
 - c. Midis kioskave duhet të ketë një hapësirë 100 (njëqind) - 200 (dyqind) m, në varësi të zones, e përcaktuar sipas rastit, për të shmangur grumbullimin dhe mbipopullimin e hapësirave publike.

Neni 53

Procedura e aplikimit për leje

1. Subjekti paraqet në seksionin përkatës të portalit e-Albania dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) kërkesë sipas formularit tip;
 - b) Genplan (duhet të pasqyrojë gjendjen eksituese dhe atë të propozuar, i pajisur me legjenden përkatëse, i pasuruar me elementet dhe kontekstin urban), planimetri ose skica të punuara, të firmosura e vulosura nga profesionist i licencuar në këtë fushë dhe duhet t'ju përmbahen me rigorozitet parametrave të vendosura në këtë rregullore. Skicat e punuara përfshijnë të paktën ilustrimet e projektit të propozuar si më poshtë:
 - Planimetri;
 - pamje;
 - prerje (të vulosura nga projektues i licencuar, shoqëruar me licencën dhe deklaratën e përgjegjësisë profesionale, sipas formatit të miratuar nga Bashkia);
 - c) **Rendera**, në të cilat përcaktohet tipologjia e kioskës, materialet e përdorura, ngjyrat dhe logoja.
 - d) **Projekt elektrik**, që shërben për instalimet elektrike të njësisë, i cili duhet të shoqërohet me kontratën për furnizimin me energji elektrike të lidhur me OSSHE.
 - e) fotografi dhe përshkrimin teknik të kioskës së propozuar, ku të pasqyrohet qartë **konteksti urban**, përfshirë objektet ekzistuese përreth, hapësirat publike të kalimit, gjelbërimin, korsinë e biçikletave dhe detaje urbane si kosha mbeturinash e tabela sinjalistike. Po ashtu, të paraqitet **tipologjia e kioskës**, duke përfshirë dizajnin, materialet, ngjyrat dhe logot, në përputhje me këtë rregullore dhe/ose studimin e miratuar më parë nga Bashkia.
 - f) Dokumentin e identifikimit të subjektit (NIPT) dhe vërtetimin e regjistrimit tatimor,

- i. Për aktivitetet ekonomike me natyrë të vazhdueshme, është e detyrueshme paraqitja e NIPT-it dhe dokumentacionit fiskal përkatës si dhe një vërtetim nga Drejtoria e Taksave vendore që subjekti që aplikon ka kryer detyrimet ndaj Bashkisë;
 - g) Vërtetim nga institucionet përkatëse që personi që do të ushtrojë aktivitetin nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin që do të zhvillojë.
 - h) për aktivitete me produkte ushqimore të paketuara (jo përgatitje ushqimesh) është e detyrueshme paraqitja e vërtetimit higjieno-sanitare, si dhe e librezës për çdo punonjës qënd do të punojë në kioskë;
2. Struktura përgjegjëse verifikon dokumentacionin brenda 7 (shtatë) ditëve punë për plotësinë e dokumentacionit dhe njofton subjektin për çdo mungesë. Struktura përgjegjëse duhet të sigurojë vlerësim të paanshëm të aplikimeve duke shmangur çdo konflikt interesi
 3. Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimmarrja përfundimtare mbi miratimin ose refuzimin e kërkesës bëhet nga organi kompetent i Bashkisë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë.
 4. Pas lëshimit të dokumentit të lejes dhe në rastet se parashikohet vendosja e karrigeve, subjekti është i detyruar të mbjellë një pemë për çdo karrige, duke kontribuar kështu në rritjen e fondit të gjelbërimit të bashkisë. Leja konsiderohet e vlefshme vetëm pas dokumentimit zyrtar të mbjelljes së pemëve dhe përmbushjes së plotë të detyrimeve tatimore dhe financiare përkatëse.
 5. Leja për shfrytëzimin e hapësirës publike, së bashku me genplanin/planimetrinë, afishohet nga subjekti në një vend të dukshëm në ambientet e aktivitetit, projekti elektrik, afishohet nga subjekti në një vend të dukshëm në ambientet e aktivitetit.

Neni 54

Afati i lejes

1. Afati maksimal i lejes është 2 (dy) vjet, me mundësi rinovimi.
2. Për aktivitete sezonale, afati i lejes nuk mund të jetë më pak se 3 (tre) muaj.
3. Rinovimi kërkohet të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë para skadimit të lejes.
4. Rinovimi i lejes nuk është automatik, por varet nga verifikimi i përmbushjes së kushteve të lejes së mëparshme, shlyerjes së detyrimeve tatimore dhe moskryerjes së shkeljeve të kësaj rregulloreje.
5. Leja mund të pezullohet ose të revokohet edhe para afatit të saj, në rast shkeljesh të kushteve të përcaktuara në këtë rregullore ose në legjislacionin sektorial.

Neni 55

Ndalimet

1. Ndalohet në rastet kur:
 - a. bëhet pengesë për shikimin e sinjalisitikës rrugore;
 - b. dëmton dhe cënon dekorin/estetikën e qytetit;
 - c. bie në kundërshtim me interesat e komunitetit;
 - d. bie në kundërshtim me distancën e sigurisë me stacionet e karburanteve e cila nuk mund të jetë më pak se 5m distancë nga to;
 - e. në hapësirat përpara Monumenteve të Kulturës, duhet të jetë një hapësirë e konsiderueshme e cila të mos pengojë shikimin e monumentit;
 - f. përpara institucioneve publike;

- g. në hapësirat me vlera të larta historike, me karakteristika të veçanta mund të jepet leje vetëm kur garantohet lëvizja e lirë e këmbësorëve dhe në përputhje me legjislacionin;
- h. në kryqëzimet ku nuk ka semafor shfrytëzimi i hapësirës publike bëhet vetëm jashtë trekëndëshit të shikimit;
- i. në një distancë tre (3)m në afërsi të rampave apo shkallëve që përdoren për akses nuk lejohet përdorimi i hapësirës publike;
- j. Vendosja e tyre në zona të gjelbëruara të qytetit

Neni 56

Mirëmbajtja

1. Subjekti, i cili është pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike, duhet:
 - a) të garantojë pastrimin e përditshëm të hapësirës publike të shfrytëzuar;
 - b) të kryej mirëmbajtjen periodike sipas udhëzimeve të bashkisë, të hapësirës publike brenda një rrezeje prej 10 metrash nga kufiri i hapësirës së shfrytëzueshme, në përputhje me pamjen estetike të qytetit dhe të ruajë gjendjen higjeno-sanitare;
 - c) të mirëmbajë pajisjet në eficiencë të plotë dhe të mos vendos asnjë send tjetër, përveç atyre të miratuara në lejen për ushtrim aktiviteti (kutia ambalazhi, etj);
2. Çdo dëm që i shkaktohet hapësirës publike apo qytetarëve nga aktiviteti që zhvillohet, do t'i faturohet subjektit i cili është i pajisur me leje. Dëmi ekonomik, përfshirë dëmtimin e trotuarit, pemëve apo hapësirës së gjelbër do të vlerësohet nga strukturat përkatëse të Bashkisë me akt administrativ, në përputhje me aktet e miratuara nga organet kompetente për këtë qëllim.

Neni 57

Kthimi i hapësirës publike

1. Në përfundim ose në rast të anulimit të lejes, subjekti është i detyruar t'a lirojë hapësirën publike dhe t'a kthejë atë në gjendjen fillestare brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike. Gjithashtu, hapësira publike duhet të lirohet në çdo rast kur strukturat përkatëse të Bashkisë duhet të kryejnë punime në interes të qytetit ose për mirëmbajtje.
2. Në rast të mospërbushjes së detyrimit, Bashkia do të kryejë vetë rikthimin e hapësirës publike në gjendjen fillestare, duke faturuar kostot e shërbimit ndaj subjektit përkatës. Këto kosto konsiderohen detyrim financiar i detyrueshëm dhe ngarkohen mbi aktivitetin ekonomik të licencuar, si dhe, kur është e aplikueshme, mbi subjektet juridikisht të lidhura me të, deri në shlyerjen e plotë të tyre.
3. Në rastet kur hapësira publike e paliruar pengon qarkullimin, aksesin publik ose cenon pasigurinë, Bashkia dhe Policia Bashkiake kanë të drejtë të ndërhyjnë menjëherë për lirim të saj, pa prituri afatin 5 (pesë) ditor.
4. Subjekti është përgjegjës për çdo dëmtim të elementëve të infrastrukturës, gjelbërimit apo pajisjeve publike gjatë procesit të lirit të hapësirës.

Neni 58

Detyrimet financiare

1. Tarifa e shfrytëzimit përcaktohet sipas sipërfaqes së zënë (m²), zonës së qytetit ku ndodhet njësia, përditësimi nga Këshilli Bashkiak, në bazë të nivelit mesatar të çmimeve të faturuara në kasën fiskale të subjektit.

2. Për lejet afatgjata (2-vjeçare), tarifa fillestare përcaktohet në kontratë sipas vendimit të Këshillit Bashkiak në fuqi në momentin e dhënies së lejes.
3. Të ardhurat nga këto tarifa destinohen ekskluzivisht për investime në infrastrukturën dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike në përputhje me vendimet e buxhetit të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

Neni 59

Masat ndëshkuese

- a) Në rastet kur organet inspektuese konstatojnë shkelje të kushteve të përcaktuara në lejen për shfrytëzimin e hapësirës publike, ndaj subjektit do të merren masat ndëshkuese, si më poshtë:
 - a. Paralajmërim në vend (proces-verbal) me afat korrigjimi nga 2 (dy) deri në 5 (pesë) ditë;
 - b. Në rast moskorrigjimi, subjekti gjobitet **jo më pak se 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror**, në varësi të sipërfaqes së shfrytëzuar dhe natyrës së shkeljes, dhe pajisjet e vendosura në kundërshtim me lejen sekuestrohen me akt administrativ.
 - c. Aktiviteti pezullohet deri në korrigjimin e plotë të shkeljes, por jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) ditë.
 - d. Nëse subjekti nuk ka korrigjuar shkeljen pas afatit maksimal të pezullimit, leja e shfrytëzimit të hapësirës publike revokohet automatikisht dhe subjekti nuk mund të riaplikojë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, për të gjitha hapësirat publike të administruara nga Bashkia.
 - e. Vendimi për pezullim ose anulim është i ankimueshëm në përputhje me legjislacionin për procedurat administrative.
2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, do të konsiderohen shkelje:
 - a. Ushtrimi i aktivitetit në një hapësirë më të madhe se ajo e përcaktuar në leje
 - b. Instalimi i pajisjeve pa leje;
 - c. Mosmirëmbajtja e pajisjeve, kur kjo dëmton/cenon estetikën e qytetit ose përbën rrezik për jetën e qytetarëve;
 - d. Mosmbajtja pastër e hapësirës së shfrytëzuar;
 - e. Mosshlyerja e tarifës së shfrytëzimit brenda afateve;
 - f. Prishja e qetësisë publike ose sjellja e padenjë;
 - g. Vazhdimi i aktivitetit edhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar në leje apo pas anulimit të saj;
 - h. Shfrytëzimi i hapësirës për aktivitet tjetër nga ai i lejuar;
 - i. Vendosja e barrierave që pengojnë qarkullimin dhe aksesin publik.

KREU VII

SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR VENDOSJEN E STRUKTURAVE REKLAMUESE (STRUKTURA TË TIPIT CITY LIGHT DHE TABELAT REKLAMUESE LED)

Neni 60

Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit

1. Ky kre përcakton rregullat dhe kushtet për mënyrën e shfrytëzimit të hapësirave publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitete reklamuese ose që synojnë të reklamojnë biznesin e

tyre përmes vendosjes së strukturave reklamuese të tipit *City Light* dhe tabelave reklamuese LED në hapësira publike, me qëllim informimin dhe promovimin e shërbimeve apo produkteve, duke ruajtur estetikën, sigurinë dhe funksionalitetin e hapësirës publike.

2. Vendosja e tabelave reklamuese LED lejohet vetëm në vendet e paracaktuara nga Bashkia, mbi bazën e një planvendosjeje të miratuar, e cila hartohet në përputhje me parimet e Kodit Rrugor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, për të garantuar sigurinë e qarkullimit të automjeteve dhe këmbësorëve, duke shmangur çdo rrezik shpërqendrimi vizual ose pengesë që mund të dëmtojë sigurinë rrugore.
3. Vendosja e strukturave reklamuese *City Light* nuk lejohet në hapësirat që kufizohen me monumente kulture, parqe publike ose zona të mbrojtura, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga legjislacioni në fuqi. Të gjitha strukturat duhet të respektojnë normat e ndriçimit të përcaktuara nga Bashkia, me qëllim shmangien e ndotjes vizuale dhe dritore.

Neni 61

Aktivitetet e lejuara në hapësirën publike

1. Për garantimin e një veprimtarie reklamuese të rregullt, në përputhje me standardet ligjore, estetike dhe të sigurisë publike, në vendosjen dhe përdorimin e strukturave reklamuese në hapësirat publike lejohet:
 - a. Vendosja e strukturave reklamuese të tipit *City Light*;
 - b. Vendosja e tabelave reklamuese LED me përmbajtje dinamike, në përputhje me standardet teknike dhe estetike të miratuara nga Bashkia;
2. Në këto struktura lejohet reklamimi i produkteve, shërbimeve, si dhe aktiviteteve kulturore, sportive, sociale dhe tregtare, në respektim të legjislacionit në fuqi dhe të akteve nënligjore përkatëse.

Neni 62

Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat

1. Lejohet përdorimi i pajisjeve reklamuese sipas specifikimeve teknike të mëposhtme:
 - a. Struktura *City Light* me dimensione standarde deri në 1,2 m gjerësi dhe 2,2 m lartësi.
 - b. Tabelat reklamuese LED me sipërfaqe maksimale 6 m².
 - c. Materiale rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe vandalizmit, të cilat garantojnë qëndrueshmëri dhe siguri gjatë gjithë kohëzgjatjes së përdorimit.
 - d. Ndriçimi i strukturave reklamuese duhet të jetë i kontrolluar dhe i drejtuar vetëm mbi sipërfaqen e reklamës, në mënyrë që të shmangë verbimin, shpërqendrimin ose çdo rrezik për qarkullimin e automjeteve dhe këmbësorëve. Në rastin e ekraneve LED ose pajisjeve digjitale, intensiteti i dritës duhet të rregullohet sipas standardeve teknike të miratuara dhe ndërrimi i imazheve nuk duhet të jetë më i shpeshtë se një herë çdo 8–10 sekonda. Ngjyrat, grafikët dhe përmbajtja vizuale e pajisjeve duhet të jenë në harmoni me hapësirën urbane, duke respektuar standardet estetike dhe mjedisore të miratuara nga Bashkia.
2. Çdo ndryshim, modifikim ose përdorim i pajisjeve jashtë specifikimeve të mësipërme duhet të miratohet paraprakisht nga Bashkia, në përputhje me aktet nënligjore dhe rregulloret teknike në fuqi.

Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat

1. Vendosja e strukturave reklamuese lejohet vetëm në hapësirat e përcaktuara dhe të miratuara nga Bashkia, në përputhje me planvendosjen e miratuar dhe standardet teknike e estetike në fuqi. Për të garantuar qarkullimin e sigurt të këmbësorëve dhe automjeteve, si dhe për të respektuar rendin urban, vendosen distancat minimale si më poshtë:
 - a) Distanca minimale nga trotuari ose hapësira publike e kalueshme është 200 cm.
 - b) Distanca minimale nga kryqëzimet rrugore është 20 m. Distanca minimale nga hyrjet e ndërtesave publike dhe stacionet e transportit publik është 5 m.
 - c) Distanca minimale midis dy strukturave reklamuese të njëjta ose të ngjashme: 500m. Strukturat duhet të kenë lartësi minimale 60 cm mbi nivelin e trotuarit dhe maksimale 3,5 m nga toka.
 - d) Ndryçimi maksimal i lejuar i LED-ve nuk duhet të tejkalojë 300 cd/m² gjatë natës dhe 5000 cd/m² gjatë ditës.
2. Në çdo rast, shfrytëzimi i hapësirës publike nga strukturat reklamuese nuk mund të tejkalojë 25% të gjerësisë së trotuarit ose hapësirës publike të kalueshme, për të ruajtur qarkullimin normal dhe sigurinë e përdoruesve. Në çdo rast duhet të mbetet të paktën 1,5–2 m hapësirë e lirë kalimi.
3. Në rast kur ndonjë nga parashikimet e mësipërme bie ndesh me dispozitat e Kodit Rrugor dhe aktet nënligjore në zbatim parashikimet e Kodit Rrugor dhe akteve përkatëse kane përparësi legjislativë sectoriale.

Dokumentacioni dhe procedura e aplikimit për leje

1. Subjekti i interesuar duhet të paraqesë kërkesë në seksionin përkatës të portalit e-Albania. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kërkesa për plotësimin e formularit tip;
 - b. Skicat/genplanin/planimetrinë duhet të jenë të punuara dhe të firmosura nga persona të licencuar në këtë fushë, si dhe të përmbushin rigorozisht parametrat teknikë të përcaktuar. **Skicat** duhet të tregojnë qartë dimensionet e reklamës, materialet e përdorura dhe pamjet përkatëse, **ndërsa genplani duhet të pasqyrojë** distancat në lidhje me kontekstin urban dhe të identifikojë lokacionin e saktë të vendosjes së reklamës.
 - c. Renderat duhet të jenë të qarta të pasuruara me specifikimet e materialeve të përdorura, duke pasqyruar veçmas pamjen ballore dhe pamjet anësore, dhe çdo render duhet të përmbajë datën e kryerjes së tij.
 - d. Specifikime teknike të pajisjes, duke përfshirë dimensionet, materialet dhe sistemin e ndriçimit.
 - e. Subjekti aplikant duhet të paraqesë dokumentin e kontratës për lidhjen me energjinë elektrike, i lidhur me institucionin përkatës (OSSHE), që vërteton mundësinë e furnizimit të sigurt dhe ligjor të njësisë përkatëse.
 - f. Kopje e dokumentit të identitetit dhe/NIPT, si dhe vërtetim tatimor i vlefshëm;
2. Struktura përgjegjëse kryen vlerësimin paraprak brenda 7 ditëve pune për plotësimin e dokumentacionit dhe njofton subjektin për çdo mungesë.
3. Struktura përgjegjëse duhet të sigurojë vlerësim të paanshëm të aplikimeve, duke shmangur çdo konflikt interesi.

4. Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimmarrja përfundimtare realizohet brenda 15 ditëve kalendarike nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit të plotë
5. Leja lëshohet pas kryerjes së pagesës së tarifës përkatëse sipas aktit normativ në fuqi.
6. Subjektet kulturore dhe sociale mund të aplikojnë përmes një kërkesë të thjeshtuar, duke përdorur formularin standard për aktivitete kulturore, sportive, humanitare, sociale ose publike pa qëllim fitimi. Bashkë me kërkesën duhet të dorëzohet një përshkrim i shkurtër i aktivitetit dhe kohëzgjatja e tij. Vendimi për këto aplikime jepet brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nëpërmjet një procedure të përshpejtuar.
7. Subjektet që pajisen me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike për vendosjen e tabelave reklamuese LED dhe që bashkëpunojnë me Bashkinë, duke ofruar reklama dhe mesazhe sensibilizuese, promovuese të eventeve në qytet ose informuese për shërbimet në komunitet, mund të përjashtohen nga pagesa e tarifës ose t'u aplikohen lehtësira të tjera sipas vendimit të Këshillit Bashkiak.

Neni 65

Afatet e lejes për shfrytëzimin e hapësirës publike

1. Afati i lejes për shfrytëzimin e hapësirës publike është 7 (shtatë) vjeçar.
2. Me kërkesë të subjektit aplikues, leja mund të lëshohet edhe për periudha sezonale, me afat jo më pak se 3 (tre) muaj.
3. Rinovimi i lejes duhet të kërkohet të paktën 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të afatit të lejes aktuale. Leja është e rinovueshme vetëm pas verifikimit të kushteve dhe respektimit të detyrimeve. Në rast të mosparaqitjes së kërkesës për rinovim brenda këtij afati, leja konsiderohet e përfunduar dhe subjekti detyrohet të heq strukturat reklamuese brenda 15 ditësh nga data e skadimit.
4. Për aktivitetet kulturore dhe sociale afati i lejes caktohet sipas kohëzgjatjes së aktivitetit, por nuk mund të jetë më shumë se 6 (gjashtë) muaj. Këto leje janë pa të drejtë rinovimi automatik dhe për çdo aktivitet të ri duhet të bëhet aplikim i veçantë.

Neni 66

Veprimtari të ndaluara

1. Ndalohet vendosja dhe përdorimi i strukturave reklamuese në mënyrë që bie ndesh me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e Bashkisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm tek rastet e mëposhtme:
 - a. Kur bëhet pengesë për shikimin e sinjalistikës rrugore;
 - b. Dëmton dhe cënon dekorin/estetikën e qytetit;
 - c. Bie në kundërshtim me interesat e komunitetit;
 - d. Bie në kundërshtim me distancën e sigurisë me stacionet e karburanteve e cila nuk mund të jetë më pak se 5m distancë nga to;
 - e. Në hapësirat përpara Monumenteve të Kulturës, duhet të jetë një hapësirë e konsiderueshme e cila mos të pengojë shikimin e monumentit;
 - f. Ndalohet vendosja e tyre përpara institucionit public, vetëm në rastet kur tabela është në shërbim të institucionit;
 - g. Në hapësirat me vlera të larta historike, me karakteristika të veçanta mund të jepet leje vetëm kur garantohet lëvizja e lirë e këmbësorëve dhe në përputhje me legjislacionin;
 - h. Në kryqëzimet ku nuk ka semafor shfrytëzimi i hapësirës publike bëhet vetëm jashtë trekëndëshit të shikimit;

- i. Në një distancë 3m në afërsi të rampave apo shkallëve që përdoren për akses nuk lejohet përdorimi i hapësirës publike;
 - j. Kur promovojnë produkte të duhanit, alkoolit ose përmbajtje të paligjshme;
 - k. Vendosja e strukturave reklamuese pa miratimin dhe lejen përkatëse nga Bashkia.
 - l. Vendosja e strukturave reklamuese në hapësira publike që nuk janë të përcaktuara, ose në kundërshtim me planvendosjen e miratuar nga Bashkia.
 - m. Përdorimi i ndriçimit të strukturave në mënyrë verbuese ose që mund të krijojë rrezik për sigurinë e qarkullimit të automjeteve dhe këmbësorëve.
 - n. Reklamimi i përmbajtjeve me karakter diskriminues, ofendues, pornografik, apo që nxisin urrejtje, dhunë ose intolerancë mbi baza racore, etnike, fetare, gjinore apo politike.
 - o. Reklamimi i produkteve, shërbimeve ose aktiviteteve të paligjshme, diskriminuese si dhe çdo përmbajtje që bie ndesh me rendin publik, moralin shoqëror dhe sigurinë publike.
 - p. Vendosja dhe përdorimi i pajisjeve ndihmëse, materialeve apo elementeve shtesë të paautorizuara jashtë strukturës reklamuese të miratuar.
 - q. Vendosja e strukturave reklamuese që prodhojnë tinguj, mesazhe zanore, efekte të lëvizshme ose teknologji të tjera shpërqendruese, të paautorizuara nga Bashkia.
 - r. vendosja e reklamave me përmbajtje politike jashtë periudhave të përcaktuara ligjërisht për fushata zgjedhore.
 - s. Ndalohet vendosja e strukturave reklamuese në afërsi të monumenteve të kulturës, zonave historike, objekteve të kultit dhe hapësirave të mbrojtura mjedisore, përveç rasteve kur lejohet shprehimisht nga legjislacioni në fuqi
2. Çdo shkelje e ndalimeve të përcaktuara në këtë nen mund të sjellë masat ndëshkuese sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të Bashkisë, përfshirë heqjen e strukturës, gjobitjen e subjektit aplikues dhe të tjera masa administrative.
 3. Në rastet kur nga shkeljet e këtij neni shkaktohet dëm ndaj jetës, shëndetit ose pasurisë së qytetarëve, përgjegjësia ligjore e subjektit shtrihet edhe në fushën civile dhe penale.

Neni 67

Mirëmbajtja e strukturave reklamuese

1. Subjektet që zotërojnë ose shfrytëzojnë struktura reklamuese janë të detyruara të:
 - a. Sigurojnë pastrimin dhe mirëmbajtjen periodike të strukturave reklamuese, në mënyrë që të mbahen në gjendje të përshtatshme estetike, funksionale dhe të sigurta për publikun.
 - b. Kontrollojnë në mënyrë të rregullt funksionimin e ndriçimit dhe të zëvendësojnë menjëherë pajisjet e dëmtuara ose të amortizuara, për të garantuar sigurinë vizuale dhe energjitike.
 - c. Kujdesen për hapësirën përreth strukturës reklamuese, në një rreze prej të paktën 2 metrash, duke përfshirë pastrimin, heqjen e mbeturinave dhe ruajtjen e qarkullimit të lirë të këmbësorëve.
 - d. Ndërrojnë menjëherë strukturat që janë të dëmtuara, të paqëndrueshme ose që paraqesin rrezik për qytetarët, në mënyrë që të shmangët çdo incident ose aksident.
 - e) Paraqesin pranë Bashkisë raport teknik të certifikuar mbi sigurinë dhe qëndrueshmërinë e strukturës, të paktën një herë në 12 muaj.
2. Moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë nen mund të sjellë masat ndëshkuese, përfshirë gjobitjen dhe heqjen e strukturës, sipas legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi.
3. Në rast mospërmbushjeje të këtij detyrimi, të gjitha kostot e heqjes, pastrimit dhe rikthimit të hapësirës publike i faturohen subjektit aplikues si detyrim financiar i menjëhershëm, duke u ngarkuar mbi aktivitetin ekonomik përkatës ose mbi subjektet juridikisht të lidhura me të.

4. Bashkia ka të drejtë të ndërmarrë menjëherë veprimet e nevojshme administrative për rikthimin e hapësirës publike, përfshirë heqjen e strukturave nga vetë Bashkia ose nga subjekte të kontraktuara prej saj, me koston që i faturohet drejtpërdrejt subjektit.
5. Shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë nen shoqërohet me masat ndëshkuese sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të Bashkisë, përfshirë gjobitjen, pezullimin ose anulimin e të gjitha lejeve të tjera aktive të subjektit, si dhe ndalimin e dhënies së lejeve të reja për një periudhë deri në dy (2) vjet.

Neni 68

Kthimi i hapësirës publike

1. Në përfundim ose anulim të lejes për shfrytëzimin e hapësirës publike, subjekti është i detyruar të heqë menjëherë strukturën reklamuese dhe të kthejë hapësirën publike në gjendjen e saj fillestare, brenda një afati prej 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit ose anulimit të lejes.
2. Në rast mospërbushjeje të këtij detyrimi, të gjitha kostot e heqjes, pastrimit dhe rikthimit të hapësirës publike i faturohen subjektit aplikues dhe ngarkohen si barrë financiare e menjëhershme mbi aktivitetin ekonomik përkatës.
3. Bashkia ka të drejtë të ndërmarrë menjëherë veprimet e nevojshme administrative për rikthimin e hapësirës publike, përfshirë heqjen e strukturave nga vetë Bashkia ose nga subjekte të kontraktuara prej saj, me koston që i faturohet drejtpërdrejt subjektit. Shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë nen mund të shoqërohet me masat ndëshkuese sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të Bashkisë, përfshirë gjobitjen dhe pezullimin ose anulimin e të gjitha lejeve të tjera aktive të subjektit si dhe ndalimin e dhënies së lejeve të reja për një periudhë deri në 3 (tre) vjet.

Neni 69

Tarifa e shfrytëzimit të hapësirës publike për struktura reklamuese

1. Tarifa për shfrytëzimin e hapësirës publike për strukturat reklamuese përcaktohet në bazë të parametrave të mëposhtëm:
 - a. Tipi i strukturës reklamuese (p.sh., *City Light* ose tabela LED).
 - b. Sipërfaqja e zënë nga struktura reklamuese, e matur në metra katrorë (m²).
 - c. Zona e qytetit ku vendoset struktura, duke marrë parasysh intensitetin e qarkullimit dhe rëndësinë urbanistike të vendndodhjes.
2. Diferencimi i tarifave sipas kategorisë së reklamimit përcaktohet në bazë të natyrës së aktivitetit si mëposhtë:
 - a. Për reklamimin komercial aplikohet tarifa e plotë e cila rishikohet dhe përditësohet nga Këshilli Bashkiak çdo 1 vit në bazë të tregut të reklamimit dhe inflacionit.
 - b. Për reklamimin kulturor dhe social aplikohet një tarifë simbolike ose e reduktuar deri në 80% të tarifës bazë, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak dhe në përputhje me karakterin jo fitimprurës të aktivitetit.
3. Reklamimi i aktivitete të Bashkisë dhe institucioneve publike të cilat përfshijnë njoftimet publike, fushatat informuese, paralajmërimet emergjente dhe informacione të tjera me interes qytetar përjashtohen nga tarifimi.
4. Të ardhurat e gjeneruara nga tarifimi i strukturave reklamuese përdoren ekskluzivisht për investime në përmirësimin e infrastrukturës publike dhe mirëmbajtjen e hapësirave ku vendosen strukturat reklamuese, sipas programit të miratuar nga Bashkia dhe pasqyrohen në buxhetin vjetor të Bashkisë.

5. Bashkia ka të drejtën të rishikojë tarifat në çdo kohë, duke marrë parasysh ndryshimet në tregun e reklamimit, kostot operative dhe nevojat e mirëmbajtjes së hapësirave publike, në përputhje me vendimet e Këshillit Bashkiak.

Neni 70

Masat ndëshkuese

1. Në rast konstatimi të shkeljes së dispozitave të kësaj rregulloreje, organi përgjegjës lëshon procesverbal paralajmërimi në vend, duke përcaktuar afatin e korrigjimit të shkeljes. Paralajmërimi i komunikohet menjëherë subjektit përfitues të lejes.
2. Masat ndëshkuese kategorizohen si më poshtë:
 - a. **Shkelje të lehta:** tejkalimi i lehtë, deri në 10 % i dimensioneve ose distancave të miratuara, mosrespektimi i manualit estetik (ngjyra, grafikë), ndriçim mbi normën e lejuar por pa krijuar rrezik të drejtpërdrejtë. Masa që merret për këtë shkelje është:
 - i. Paralajmërim me afat korrigjimi deri në 10 ditë;
 - ii. Në mungesë të korrigjimit, gjobë nga 30,000 deri në 50,000 lekë .0
 - b. **Shkelje të mesme:** tejkalimi mbi 10 % i dimensioneve ose distancave të miratuara, tejkalim i sipërfaqes së lejuar mbi 25% të gjerësisë së trotuarit; ndriçim verbues që pengon qarkullimin e sigurt të këmbësorëve ose automjeteve. Masa që merret për këtë shkelje është:
 - i. Gjobë nga 100,000 deri në 200,000 lekë;
 - ii. Afat korrigjimi deri në 5 ditë;
 - iii. Në mungesë të korrigjimit, heqje e detyruar e strukturës nga Bashkia me shpenzimet e subjektit.
 - c. **Shkelje të rënda:** vendosja e strukturave reklamuese në zona të ndaluara (kryqëzime rrugore, monumente kulture, zona të mbrojtura); pengim i qarkullimit të lirë të këmbësorëve (lënia më pak se 1,5 m hapësirë të lirë kalimi); vendosja pa asnjë autorizim dhe në kundërshtim të plotë me planvendosjen e miratuar. Masa që merret për këtë shkelje është:
 - i. Gjobë nga 300,000 deri në 500,000 lekë;
 - ii. Heqje e menjëhershme e strukturës pa afat korrigjimi;
 - iii. Refuzim ose revokim i lejes për vendosjen e strukturave reklamuese për një periudhë deri në 2 vjet.
3. Në çdo rast, Bashkia ka të drejtë të sekuestrojë strukturat reklamuese të vendosura në kundërshtim me ligjin dhe t'i depozitojë në magazinat bashkiake deri në shlyerjen e detyrimeve financiare nga subjekti.
4. Aktiviteti i subjektit pezullohet deri në korrigjimin e shkeljes, por jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike nga data e vendosjes së pezullimit.
5. Në rast se, pas përfundimit të afatit maksimal të pezullimit të parashikuar në pikën 4 (katër) të këtij neni, shkelja nuk është korrigjuar, organi përgjegjës merr vendim për anulimin e lejes së shfrytëzimit dhe strukturat reklamuese të subjektit sekuestrohen dhe hiqen nga hapësira publike. Pas anulimit të lejes, subjekti ndalohet të paraqesë kërkesë për një leje të re për një periudhë 2 (dy) vjeçare, duke llogaritur nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të anulimit.
6. Zbatimi i këtyre masave nuk përjashton përgjegjësinë penale ose civile të subjektit, nëse nga shkeljet është shkaktuar dëm ndaj personave, automjeteve apo pasurisë publike/private.

7. Masat ndëshkuese të përcaktuara në këtë nen zbatohen pa dëmtuar të drejtat e palëve të treta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë mundësinë e ankimit sipas procedurave administrative të parashikuara nga ligji.

KREU VIII

SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE – FASADA PËR VENDOSJEN E TABELAVE REKLAMUESE

Neni 71

Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit

1. Ky kre përcakton rregullat dhe kushtet për vendosjen e tabelave reklamuese në fasadat e ndërtesave që kufizojnë hapësirat publike, në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi. Qëllimi i këtij është promovimi i produkteve, shërbimeve ose aktiviteteve, duke garantuar:
 - a) Sigurinë e përdoruesëve të hapësirave publike;
 - b) Ruajtjen e estetikës urbane dhe të integritetit vizual të qytetit;
 - c) Integritetin e fasadave dhe elementëve arkitektonikë ekzistues.
2. Fasadat e ndërtesave që kufizojnë trotuaret, sheshet, rrugët dhe çdo hapësirë tjetër publike konsiderohen pjesë e hapësirës publike për shkak të ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë në imazhin urban, perceptimin qytetar dhe sigurinë e lëvizjes. Për këtë arsye, shfrytëzimi i tyre për qëllime reklamuese rregullohet nga kjo rregullore, njësoj si çdo element tjetër i hapësirës publike.
3. Vendosja e tabelave reklamuese në fasada bëhet vetëm me leje të posaçme të lëshuar nga Bashkia dhe sipas kriterëve të miratuara në aktet nënligjore sektoriale.
4. Ndalohet mbulimi ose dëmtimi i elementeve arkitektonike të fasadës (dritare, ballkone, relieve, dekorime), si dhe vendosja e reklamave në fasadat e ndërtesave të mbrojtura si monument kulture, përveç rasteve të miratuara shprehimisht nga autoritetet kompetente.

Neni 72

Aktivitetet e lejuara

1. Lejohet vendosja e tabelave reklamuese në fasada për:
 - a. promovimin e produkteve dhe shërbimeve tregtare;
 - b. promovimin e aktiviteteve kulturore, sociale, sportive dhe publike;
 - c. njoftime të institucioneve publike dhe bashkive për interesa qytetare.
2. Ndalohet vendosja e tabelave që:
 - a. promovojnë produkte të duhanit, alkoolit ose përmbajtje të paligjshme;
 - b. shfaqin përmbajtje diskriminuese, të dhunshme, pornografike apo që cenojnë rendin dhe moralin publik;
 - c. mbulojnë elemente arkitektonike të fasadave me vlerë historike ose kulturore, pa miratimin e institucionit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
 - d. Vendosen në fasadat e ndërtesave të banuara pa miratimin e administratorit të ndërtesës dhe në përputhje me ligjin për administrimin e bashkëpronësisë;
 - e. Përmbajnë mesazhe politike jashtë periudhave të përcaktuara ligjërisht për fushatat zgjedhore;

- f. Përdorin ndriçim verbues ose efekte dinamike që krijojnë rrezik për sigurinë rrugore ose shqetësim për banorët, në referim të standardeve të përcaktuara për tabelat reklamuese LED dhe Citylight.

Neni 73

Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat

1. Tabela duhet të jenë:
 - a. të ngjitura ose të varura në fasadë, sipas dimensioneve të miratuara nga Bashka pa tejkaluar 30% të sipërfaqes së fasadës përkatëse dhe jo më shumë se 10 m² për tabelë;
 - b. të vendosura në një lartësi minimale prej 2,5 metrash mbi nivelin e trotuarit ose hapësirës së kalueshme me ndriçim të brendshëm ose të jashtëm me intensitet të kufizuar, jo verbues dhe të fikura automatikisht gjatë orarit të ndaluar të përcaktuar nga Bashkia;
 - c. të ndërtuara me material rezistente ndaj kushteve atmosferike, të papërshkueshme nga zjarri, të lehta dhe të mirëmbajtshme, që nuk dëmtojnë fasadën.
 - d. Me instalime elektrike të fshehura dhe të certifikuara sipas standardeve të sigurisë elektrike. Ngjyrat dhe dizajni i elementeve fizik të tabelave duhet të harmonizohen me pamjen e përgjithshme të ndërtesës dhe mjedisit përreth dhe nuk lejohet përdorimi i ngjyrave fluorescente, verbuese ose që krijojnë shpërqendrim vizual.
2. Nuk lejohet vendosja e strukturave ndihmëse jashtë vëllimit të tabelës, si korniza metalike të rënda, gjeneratorë, kablllo të dukshme apo elementë të tjerë që prishin integritetin estetik dhe arkitektonik të fasadës.

Neni 74

Masa dhe distancat

1. Tabela reklamuese vendosen në fasadat e ndërtesave ose në vendet e përcaktuara nga bashkia në përputhje me planvendosjen dhe kriteret e miratuara prej saj.
2. Sipërfaqja maksimale e tabelës nuk duhet të kalojë 30 (tridhjetë) % të sipërfaqes së fasadës ku vendoset.
3. Tabela nuk duhet të mbulojë dritare, ballkone, elementë arkitektonikë dekorativë apo hapësira ajrimi.
4. Kur njësitë tregtare ndodhen pranë njëra-tjetres dhe tabelat vendosen ngjitur ose me afërsi të madhe, madhësia dhe forma e përgjithshme e tabelave duhet të jenë të ngjashme, me elemente dalluese vetëm brenda përmbajtjes së secilës tabelë. Për raste të tilla, Bashkia harton dhe publikon udhëzime konkrete për unifikimin e tyre.
5. Tabela nuk mund të dalë më shumë se 30 (tridhjetë) cm nga fasada dhe duhet të vendoset në një lartësi minimale prej 2,5 metrash nga niveli i trotuarit ose hapësirës së kalueshme.
6. Distanca minimale ndërmjet dy tabelave në të njëjtën fasadë duhet të jetë jo më pak se 1 metër, përveç rasteve kur kërkohet unifikim nga Bashkia.
7. Për tabelat e dukshme nga rruga, parashikimet e Kodit Rrugor dhe akteve sektoriale, për sigurinë e qarkullimit kanë përparësi.

Neni 75

Dokumentacioni dhe procedura e aplikimit për leje

1. Subjekti paraqet në seksionin përkatës të portalit e-Albania dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. kërkesë sipas formularit TIP;

- b. Skica të thjeshta të cilat duhet të tregojnë qartë dimensionet e reklamës, materialet e përdorura dhe pamjet përkatëse, ndërsa genplani duhet të pasqyrojë distancat në lidhje me kontekstin urban dhe të identifikojë lokacionin e saktë të vendosjes së reklamës.
 - c. projekt teknik dhe rendera të qarta të pasuruara me specifikimet e materialeve të përdorura të tabelës së propozuar, të punuara, firmosura dhe vulosura nga profesionist i licencuar në këtë fushë dhe duhet t'ju përmbahen me rigorozitet parametrave të vendosura në këtë rregullore;
 - d. leje shfrytëzimi nga pronari i ndërtesës (nëse subjekti nuk është pronari) ose administrator sipas ligjit nr. 55/2025, "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa";
 - e. dokument e identifikimit të subjektit/NIPT dhe vërtetim e regjistrimit tatimor ose letërnjoftim elektronik për individët;
 - i. Individët mund të aplikojnë me letërnjoftim elektronik vetëm për aktivitete të përkohshme, artizanale, kulturore ose rekreative pa natyrë tregtare;
 - ii. Për aktivitetet ekonomike me natyrë të vazhdueshme, është e detyrueshme paraqitja e NIPT-it dhe dokumentacionit fiskal përkatës
 - f. Subjekti aplikant duhet të paraqesë dokumentin e kontratës për lidhjen me energjinë elektrike, i lidhur me institucionin përkatës (OSSHE), që vërteton mundësinë e furnizimit të sigurt dhe ligjor të njësisë përkatëse.
2. Struktura përgjegjëse kryen vlerësimin paraprak brenda 7 (shtatë) ditëve për plotësinë e dokumentacionit dhe njofton subjektin për çdo mungesë. Struktura përgjegjëse duhet të sigurojë vlerësim të paanshëm të aplikimeve, duke shmangur çdo konflikt interesi.
 3. Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimmarrja përfundimtare realizohet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit të plotë.
 4. Leja lëshohet vetëm pas pagesës së tarifës përkatëse.

Neni 76

Afati i lejes

1. Afati maksimal i lejes është 2 (dy) vjet.
2. Lejet sezonale nuk mund të jenë më pak se 3 (tre) muaj.
3. Për aktivitete kulturore dhe sociale, leja jepet për kohëzgjatjen e aktivitetit, jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj.
4. Rinovimi i lejes kërkohet të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë para skadimit të saj.
5. Rinovimi i lejes jepet vetëm pas verifikimit nga Bashkia të gjendjes së fasadës dhe respektimit të kushteve të lejes ekzistuese. Në rast mospërmbushjeje të kushteve, kërkesa për rinovim refuzohet dhe subjekti nuk ka të drejtë të aplikojë për një leje të re për një periudhë 3 (tre) vjeçare nga data e refuzimit.

Neni 77

1. NdalimetNdalohet në rastet kur:

- a. Kur bëhet pengesë për shikimin e sinjalistikës rrugore;
- b. Dëmton dhe cënon dekorin/estetikën e qytetit;
- c. Bie në kundërshtim me interesat e komunitetit;
- d. Bie në kundërshtim me distancën e sigurisë me stacionet e karburanteve e cila nuk mund të jetë më pak se 5m distancë nga to;
- e. Në hapësirat përpara Monumenteve të Kulturës, duhet të jetë një hapësirë e konsiderueshme e cila mos të pengojë shikimin e monumentit;

- f. Ndalohet vendosja e tyre përpara institucionit publik vetëm në rastet kur tabela është në shërbim të institucionit;
- g. Në hapësirat me vlera të larta historike, me karakteristika të veçanta mund të jepet leje vetëm kur garantohet lëvizja e lirë e këmbësorëve dhe në përputhje me legjislacionin;
- h. Në kryqëzimet ku nuk ka semafor shfrytëzimi i hapësirës publike bëhet vetëm jashtë trekëndëshit të shikimit;
- i. Në një distancë 3m në afërsi të rampave apo shkallëve që përdoren për akses nuk lejohet përdorimi i hapësirës publike;
- j. Kur promovojnë produkte të duhanit, alkoolit ose përmbajtje të paligjshme;
- k. Nuk përmushin kushtet e përcaktuara nga ky kre.

Neni 78

Mirëmbajtja

1. Subjektet janë të detyruara të:
 - a. Mirëmbajnë tabelat dhe fasadën ku janë vendosur;
 - b. Sigurojnë funksionimin normal të ndriçimit, pa cënuar sigurinë e qarkullimit;
 - c. Riparojnë ose heqin menjëherë tabelat e dëmtuara ose të amortizuara.
 - d. Subjektet duhet të kryejnë kontrole periodike të sigurisë teknike të tabelave jo më rrallë se një herë në vit, duke mbajtur dokumentacion të posaçëm.
 - e. Në rast mosmirëmbajtjeje, Bashkia ka të drejtë të ndërhyjë për riparimin ose heqjen e tabelës, me koston e ngarkuar subjektit.

Neni 79

Kthimi i hapësirës publike

- i. Në përfundim ose anulim të lejes, subjekti është i detyruar të heqë tabelën dhe të kthejë fasadën dhe hapësirën publike përreth në gjendjen fillestare brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike.
- ii. Në rast mospërmbushjeje, koston e rikthimit i faturohen subjektit dhe ngarkohen si barrë mbi aktivitetin ekonomik përkatës ose bashkia mund të përdorë garancinë bankare ose sigurimin e kontratës së depozituar nga subjekti për mbulimin e këtyre kostove.

Neni 80

Detyrimet financiare

1. Tarifa për shfrytëzimin e hapësirës publike për tabelat reklamuese përcaktohet sipas:
 - a. Sipërfaqes totale të tabelës;
 - b. Zonës së qytetit ku ndodhet ndërtesa/fasada;
 - c. Natyrës së aktivitetit reklamues (komercial, kulturor, social ose institucional).
2. Diferencimi i tarifave kryhet si më poshtë:
 - a. Reklamimi komercial: aplikohet tarifa e plotë, e përditësuar nga Këshilli Bashkiak çdo 1 (një) vit muaj në raport me tregun;
 - b. Reklamimi kulturor dhe social: aplikohet tarifë simbolike ose e reduktuar deri në 80 (tetëdhjetë) %, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak.
 - c. Reklamimi për aktivitete të Bashkisë dhe institucioneve publike: përjashtohet nga tarifimi dhe realizohet për njoftime publike, fushata informuese ose paralajmërime emergjente.

iii. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e shfrytëzimit të hapësirës publike përdoren ekskluzivisht për:

- a) përmirësimin e infrastrukturës urbane;
- b) mirëmbajtjen e hapësirave publike.

Neni 81

Masat ndëshkuese

- 1) Për çdo shkelje të pëcraktuar në këtë kre, bashkia kryen paralajmërim në vend (proces-verbal), duke përcaktuar afat të qartë për korrigjim.
- 2) Masat ndëshkuese kategorizohen si më poshtë:

a) Shkelje të lehta: tejkalimi i lehtë, deri në masën 10%, i dimensioneve ose distancave të miratuara, mosrespektimi i manualit estetik (ngjyra, grafikë), ndriçim mbi normën e lejuar por pa krijuar rrezik të drejtpërdrejtë. Masa që merret për këtë shkelje është:

- i. Paralajmërim me afat korrigjimi deri në 10 ditë;
- ii. Në mungesë të korrigjimit, gjobë nga 30,000 deri në 50,000 lekë.

b) Shkelje të mesme: tejkalimi mbi 10% i dimensioneve ose distancave të miratuara, tejkalim i sipërfaqes së lejuar mbi 25% të gjerësisë së trotuarit; ndriçim verbues që pengon qarkullimin e sigurt të këmbësorëve ose automjeteve. Masa që merret për këtë shkelje është:

- i. Gjobë nga 100,000 deri në 200,000 lekë;
- ii. Afat korrigjimi deri në 5 ditë;
- iii. Në mungesë të korrigjimit, heqje e detyruar e strukturës nga Bashkia me shpenzimet e subjektit.

c) Shkelje të rënda: vendosja e strukturave reklamuese në zona të ndaluara (kryqëzime rrugore, monumente kulture, zona të mbrojtura); pengim i qarkullimit të lirë të këmbësorëve (lënia më pak se 1,5 m hapësirë të lirë kalimi); vendosja pa asnjë autorizim dhe në kundërshtim të plotë me planvendosjen e miratuar. Masa që merret për këtë shkelje është:

- i. Gjobë nga 300,000 deri në 500,000 lekë;
- ii. Heqje e menjëhershme e strukturës pa afat korrigjimi;
- iii. Refuzim ose revokim i lejes për vendosjen e strukturave reklamuese për një periudhë deri në 2 vjet.

2.1 Në çdo rast, Bashkia ka të drejtë të sekuestrojë strukturat reklamuese të vendosura në kundërshtim me ligjin dhe t'i depozitojë në magazinat bashkiake deri në shlyerjen e detyrimeve financiare nga subjekti.

2.2 Zbatimi i këtyre masave nuk përjashton përgjegjësinë penale ose civile të subjektit, nëse nga shkeljet është shkaktuar dëm ndaj personave, automjeteve apo pasurisë publike/private.

3. Në rast mosreagimi brenda afatit të dhënë aktiviteti pezullohet deri në korrigjimin e shkeljes, por jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) ditë.
4. Nëse shkelja nuk korrigjohet brenda afatit të pezullimit, leja për shfrytëzimin e hapësirës publike anulohet, tabela sekuestrohet dhe hiqet me shpenzimet e subjektit, dhe subjekti ndalohet të riaplikojë për një periudhë 2 (dy) vjeçare nga data e anulimit.

KREU IX

SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR ZHVILLIMIN E PANAIREVE

Neni 82

Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit

1. Ky kre përcakton kushtet dhe rregullat për shfrytëzimin e hapësirave publike për organizimin e panairove të përkohshme, të cilat mund të kenë karakter tregtar, kulturor, artizanal, gastronomik, turistik, promovues, apo të ofrimit të shërbimeve të ndryshme. Panairot kanë gjithmonë karakter të përkohshëm dhe nuk mund të zgjasin më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike.
2. Panairot zhvillohen kryesisht në hapësirat e paracaktuara dhe të miratuara nga Bashkia, në përputhje me një plan organizimi të detajuar, i cili siguron respektimin e standardeve të sigurisë dhe evakuimit, garanton lëvizjen e lirë dhe të papenguar të qytetarëve, si dhe ruajtjen e integritetit dhe funksionalitetit të hapësirës publike.
3. Me kërkesë të organizatorëve, zhvillimi i panairove mund të lejohet edhe në hapësira të tjera jo të paracaktuara, vetëm pas marrjes së një konfirmimi paraprak dhe të posaçëm nga Bashkia. Ky konfirmim jepet mbi bazën e shqyrtimit dhe miratimit të një projekti që vlerëson dhe garanton kushtet e sigurisë, funksionalitetit, qarkullimit të qytetarëve, estetikës dhe mbrojtjes së interesit publik në hapësirat e përfshira.

Neni 83

Aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara

1. Lejohet organizimi i panairove të përkohshme për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme tregtare, artizanale, gastronomike, si dhe panairot të librit, artit, turizmit dhe kulturës. Përveç këtyre, mund të organizohen panairot me qëllim promovimin e aktiviteteve shoqërore, sociale ose kulturore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kriteret e sigurisë dhe funksionalitetit të hapësirës publike.
2. Nuk lejohet organizimi i panairove që përfshijnë tregtimin ose ekspozimin e produkteve të paligjshme ose të paregjistruara, si dhe të produkteve që mund të cenojnë shëndetin publik pa miratime të vlefshme higjieno-sanitare. Gjithashtu, ndalohet zhvillimi i panairove ose veprimtarive që cenojnë rendin publik, sigurinë, funksionalitetin ose estetikën e hapësirës publike, duke respektuar normat ligjore dhe rregulloret vendore në fuqi.
3. Panairot në zona historike, monumente kulture ose në hapësira të mbrojtura mjedisore lejohet vetëm për qëllime kulturore/artizanale/ turistik dhe është miratuar paraprakisht nga institucionet kompetente.

Neni 84

Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat

1. Pajisjet dhe elementët që përdoren në organizimin e panairove të përkohshme duhet të jenë të përkohshëm, të çmontueshëm dhe të harmonizuar me hapësirën publike. Lejohen, ndër të tjera, stenda dhe struktura të çmontueshme, çadra dielli ose tenda të lëvizshme (struktura të përkohshme që mund të vendosen dhe hiqen lehtësisht, të sigurta dhe të stabilizuara, me dimensione të përshtatshme për aktivitetin dhe që nuk pengojnë qarkullimin e publikut), si dhe platforma të përkohshme për prezantime me lartësi

- maksimale prej 50 cm. Materialet e përdorura duhet të jenë rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe zjarrit, estetike dhe të përshtatura me arkitekturën dhe peizazhin urban.
2. Arkitektura e pajisjeve dhe vendosja e përgjithshme duhet të jenë të dizajnuara me kujdes, në harmoni me ambientin përreth, objektet ekzistuese dhe peizazhin urban. Stendat dhe elementët e panairit nuk duhet të krijojnë ndotje vizuale apo të cenojnë imazhin e hapësirës publike, por duhet të kontribuojnë në krijimin e një atmosfere funksionale, tërheqëse dhe të rregullt.
 3. Reklamimi dhe promovimi i panairit lejohet vetëm brenda hapësirës së panairit, përmes posterave, tabelave ose elementëve dekorativë të përkohshëm, të çmontueshëm, me dimensione të kufizuara dhe të miratuara paraprakisht nga Bashkia. Vendosja e materialeve promovuese jashtë hapësirës së panairit përfshirë përdorimin e ekraneve LED, projektorëve apo pajisjeve zanore, mund të kryhet vetëm pas marrjes së një lejeje të veçantë nga Bashkia. Parkimi i automjeteve dhe logjistika e furnizimit duhet të parashikohen në projektin e panairit dhe të miratohen paraprakisht nga Bashkia. Shkarkimi i mallrave lejohet vetëm në zonat e përcaktuara, pa penguar lëvizjen e këmbësorëve dhe pa komprometuar funksionalitetin e hapësirës publike. Automjetet e furnizimit duhet të largohen menjëherë pas kryerjes së shkarkimit. Çdo panair duhet të ketë një plan sigurie dhe evakuimi të miratuar nga Bashkia, i cili përfshin rrugët e evakuimit, pikat e grumbullimit, hyrje-daljet për mjetet e emergjencës dhe masat e parashikuara për menaxhimin e situatave të jashtëzakonshme.

Neni 85

Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat

1. Sipërfaqja e hapësirës publike e cila shfrytëzohet për organizimin e panairit përcaktohet në planin e detajuar të panairit, i cili duhet të miratohet paraprakisht nga Bashkia. Gjatë organizimit të panairit, duhet të sigurohet një korridor minimal prej 300 cm për qarkullimin e këmbësorëve. Mes rreshtave të stendave duhet të krijohen korridore paralele, të cilat mundësojnë lëvizjen e lirë dhe daljen emergjente të qytetarëve.
2. Organizatori është i detyruar të hartojë dhe zbatojë një plan sigurie dhe emergjencash, i cili përfshin, ndër të tjera:
 - a) Krijimin e korridoreve të qarta dhe të dukshme për dalje emergjente të pajisura me sinjalistikë të miratuar;
 - b) Vendosjen e pikave të ndihmës së shpejtë dhe pajisjeve të fikjes së zjarrit në vendet e përcaktuara;
 - c) Bashkëpunimin me Policinë Bashkiake dhe Shërbimin Zjarrfikës për sigurimin e zbatimit të masave të emergjencës;
 - d) Sigurimin e personelit të trajnuar për menaxhimin e situatave emergjente dhe evakuimin e qytetarëve në mënyrë të sigurt dhe të organizuar;
 - e) Pajisjen me një sigurim civil të detyrueshëm për mbulimin e dëmeve të mundshme ndaj qytetarëve dhe hapësirës publike.

Neni 86

Procedura e aplikimit për leje

1. Aplikimi për lejen e organizimit të panairit duhet të bëhet të paktën 45 ditë para datës së planifikuar të zhvillimit të tij. Kërkesa duhet të dorëzohet në seksionin përkatës të portalit e-Albania, nëpërmjet formularit standard të përcaktuar nga Bashkia dhe duhet të përfshijë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. Planvendosjen e detajuar të panairit, me shënimin e stendave, korridoreve dhe hapësirave shërbyese; Çdo stendë duhet të paraqitet në plan, prerje dhe pamje, duke treguar llojin e saj dhe dimensionet e të gjitha elementëve përkatëse.
 - b. Genplani i cili duhet të pasqyrojë gjendjen ekzistuese dhe atë të propozuar, të pajisur me legjendën përkatëse, dhe të jetë i pasuruar me elementet dhe kontekstin urban. Çdo element i pasqyruar në genplan duhet të jetë i dimensionuar saktë.
 - c. Pamje 3-dimensionale dhe fotomontazhe të projektit të panairit, të pasururara me specifikimet e materialeve të përdorura, i cili duhet të jetë i punuar dhe të firmosur nga profesionist i licencuar në këtë fushë dhe duhet t'ju përmbahen me rigozitet parametrave të vendosura në këtë rregullore;
 - d. Përshkrim të aktivitetit, listën e ekspozuesve, oraret e funksionimit, skica e evakuimit dhe kohëzgjatjen e zhvillimit;
 - e. Dokument identiteti dhe NIPT, si dhe vërtetim tatimor në fuqi;
 - f. Vërtetim higjieno-sanitare për aktivitetet ushqimore, ku produktet ushqimore duhet të ekspozohen në një lartësi minimale prej 50 cm nga toka;
 - g. Libreza shëndetësore për punonjësit që përfshihen në përpunimin ose shitjen e ushqimeve;
 - h. Plan të sigurisë, evakuimit dhe menaxhimit të mbetjeve.
2. Në rast se për të njëjtin vend dhe periudhë aplikojnë më shumë organizatorë, përzgjedhja e organizatorit bëhet nga një komision i posaçëm i ngritur nga Bashkia, mbi bazën e kritereve të miratuara paraprakisht, duke marrë në konsideratë sigurinë publike, estetikën, ndikimin kulturor e social dhe menaxhimin e qëndrueshëm të panairit. Vlerësimi kryhet mbi bazën e një sistemi pikësh dhe formalizohet me procesverbal. Subjekti i shpallur fitues njoftohet zyrtarisht, ndërsa rezultatet bëhen publike për transparencë.

Neni 87

Afati i lejes

1. Afati maksimal i lejes për organizimin e një panairi të përkohshëm është 30 ditë kalendarike. Për aktivitete sezonale të përsëritura, leja mund të jepet deri në dy herë brenda vitit. Leja nuk mund të tejkalojë kohëzgjatjen e aktivitetit të përcaktuar në kërkesën e dorëzuar nga organizatori.
2. Leja përcakton gjithashtu orarin e përditshëm të zhvillimit të panairit, i cili nuk mund të tejkalojë orën 23:00. Në zonat e banuara ose me karakter historik, Bashkia mund të vendosë kufizime më të rrepta, deri në orën 22:00, në mënyrë që të shmanget ndotja akustike dhe shqetësimi i banorëve përreth.
3. Rinovimi i lejes duhet të kërkohet të paktën 30 ditë para skadimit të saj dhe jepet vetëm pas verifikimit nga Bashkia se organizatori ka respektuar të gjitha kushtet e përcaktuara në lejen ekzistuese. Në rast shkeljesh të përsëritura, subjekti nuk ka të drejtë të aplikojë për një leje të re për një periudhë deri në 2 (dy) vjet.

Neni 88

1. **Ndalimet dhe kufizimet në shfrytëzimin e hapësirës publike** Ndalohet zhvillimi i panireve pa marrë më parë lejen e për zhvillim e këtij aktiviteti.
2. Nuk lejohet mbipopullimi i hapësirës publike përtej sipërfaqes së përcaktuar në planin e miratuar të panairit. Organizatori është i detyruar të largojë të gjitha pajisjet dhe strukturat e përdorura menjëherë pas përfundimit të aktivitetit, në mënyrë që të mos pengohet qarkullimi i qytetarëve dhe të ruhet integriteti i hapësirës publike.

3. Përdorimi i ndriçimit të shndritshëm, verbues ose që krijon ndotje vizuale, si dhe përdorimi i aparaturave fonike me volum që tejkalon normat e lejuara dhe shkakton shqetësim publik, është i ndaluar.
4. Ndalohet përpunimi i ushqimeve të përgatitura në vend pa përmbushur kushtet higjieniko-sanitare të miratuara, në mënyrë që të shmanget ndotja dhe rreziku për shëndetin publik.
5. Ndalohet zhvillimi i panaireve në zonat e mbrojtura historike ose kulturore pa lejen e posaçme të institucioneve përkatëse. Në këto zona lejohen vetëm aktivitete me karakter artizanal, kulturor ose turistik.
6. Ndalohet vendosja e materialeve ose mesazheve që nxisin dhunë, diskriminim ose urrejtje ose përmbajnë propagandë në kundërshtim me ligjin.

Neni 89

Mirëmbajtja e hapësirës publike dhe menaxhimi i mbetjeve gjatë panaireve

1. Organizatori i panairit është i detyruar të sigurojë mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirës publike gjatë gjithë kohëzgjatjes së panairit dhe menjëherë pas përfundimit të tij. Ai duhet të kujdeset për hapësirën publike përreth panairit, në një rreze prej të paktën 10 metrash nga perimetri i zonës së shfrytëzuar ose më shumë sipas përcaktimit të Bashkisë në varësi të madhësisë së panairit, llojit të aktivitetit dhe fluksit të vizitorëve.
2. Grumbullimi dhe largimi i mbetjeve duhet të kryhet çdo ditë, si dhe sa herë që arrihet kapaciteti maksimal i venddepozitimit të përkohshëm të mbetjeve, sipas projektit të miratuar nga Bashkia. Organizatori është i detyruar të sigurojë që mbetjet dhe venddepozitimet e tyre të ruajnë një imazh pastërtie dhe higjienik gjatë gjithë ditës dhe për gjithë kohëzgjatjen e aktivitetit, në përputhje me standardet e sigurisë, higjienës dhe estetikës urbane.
3. Organizatori është i detyruar të vendosë kosha të diferencuar për mbeturina organike, plastike, letër dhe metal, duke respektuar standardet e riciklimit dhe higjienës. Mbetjet dhe venddepozitimet e tyre duhet të ruajnë një imazh pastërtie dhe higjienik gjatë gjithë ditës, në përputhje me standardet e sigurisë dhe estetikës urbane.
4. Organizatori duhet të ketë marrëveshje me një subjekt të licencuar për menaxhimin dhe transportin e mbetjeve. Në rast mospërmbushjeje të detyrimeve të këtij neni, Bashkia ndërhyr për pastrimin dhe kostot i faturohen organizatorit, duke u zbritur nga garancia financiare e depozituar prej tij.

Neni 90

Kthimi i hapësirës publike

1. Organizatori është i detyruar të kryejë pastrimin bazik të hapësirës (largimin e mbetjeve të dukshme dhe të mbetjeve ushqimore) brenda 1 (një) ore nga mbyllja e aktivitetit. Pastrimi përfundimtar, përfshirë larjen dhe dezinfektimin kur është e nevojshme, duhet të kryhet brenda 4 (katër) orëve nga mbyllja e aktivitetit dhe në çdo rast jo më vonë se ora 6:00 e ditës pasuese.
2. Në rast mospërmbushjeje të këtij detyrimi, të gjitha kostot e rikthimit të hapësirës në gjendjen fillestare i faturohen organizatorit dhe ngarkohen si barrë financiare mbi aktivitetin ekonomik përkatës. Bashkia ka të drejtë të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e këtij detyrimi, përfshirë edhe procedurat e ekzekutimit të kostove të rikthimit sipas ligjit në fuqi.

Neni 91

Detyrimet financiare dhe tarifat për shfrytëzimin e hapësirës publike

1. Tarifa për shfrytëzimin e hapësirës publike gjatë organizimit të panairove përcaktohet nga Bashkia dhe llogaritet në bazë të faktorëve të mëposhtëm:
 - a. Sipërfaqja e zënë nga panairi (në m²);
 - b. Kohëzgjatja e zhvillimit të panairit;
 - c. Zona e qytetit ku zhvillohet panairi, duke marrë parasysh karakteristikat funksionale dhe ndikimin mbi komunitetin dhe infrastrukturën urbane.
2. Diferencimi i tarifave:
 - a. Për panairët komerciale aplikohet tarifa e plotë, e përditësuar nga Këshilli Bashkiak një herë në vit;
 - b. Për panairët kulturore, artizanale dhe sociale aplikohet tarifë e reduktuar deri në 70%, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak në përputhje me interesin publik dhe karakterin jo fitimprurës të aktivitetit;
 - c. Për panairët të organizuara nga Bashkia dhe institucionet publike përjashtohen nga tarifimi.
3. Të ardhurat e gjeneruara nga tarifat e shfrytëzimit të hapësirës publike destinohen ekskluzivisht për përmirësimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e hapësirave publike në qytet. Bashkia publikon çdo vit një raport mbi përdorimin e këtyre të ardhurave për transparencë ndaj komunitetit.
4. Pagesa e tarifës për shfrytëzimin e hapësirës publike dhe depozitimi i garancisë financiare janë kushte të domosdoshme për lëshimin e lejes së panairit.

Neni 92

Masat ndëshkuese

1. Për çdo shkelje të rregullave dhe dispozitave të këtij rregullore, organizatori i panairit mund të përballë me masat ndëshkuese të mëposhtme:
 - a) Paralajmërim në vend: Shkelja dokumentohet me proces-verbal dhe organizatori detyrohet të kryejë korrigjimin brenda të njëjtës ditë;
 - b) Gjoha dhe pezullimi i aktivitetit: Në rast përsëritjeje ose shkeljeje më serioze, mund të vendoset gjobë prej 500,000 (përqind mijë) lekë dhe aktiviteti pezullohet deri në korrigjimin e shkeljes, por jo më shumë se 5 (pesë) ditë;
 - c) Anullimi i lejes dhe sekuestrimi i pajisjeve: Nëse shkelja nuk korrigjohet brenda afatit maksimal të pezullimit, leja për organizimin e panairit anulohet, pajisjet e përdorura sekuestrohen me proces-verbal, dhe organizatori ndalohet të riaplikojë për një periudhë 2 (dy) vjeçare.
2. Masat ndëshkuese zbatohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe vendimet e Bashkisë, me qëllim sigurimin e respektimit të rregullave, sigurisë publike dhe ruajtjes së hapësirës publike.

KREU X

SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR AKTIVITETE PROMOVUESE, ARTISTIKE, KULTURORE, AKTIVITETE POLITIKE E TË TJERA

Neni 93

Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit

1. Ky kre rregullon kushtet, kriteret dhe procedurat për shfrytëzimin e hapësirave publike për zhvillimin e aktiviteteve promovuese, artistike, kulturore, edukative, sociale, fetare, politike dhe të tjera me ndikim publik.
2. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është gjallërimi i jetës qytetare, nxitja e pjesëmarrjes publike dhe përdorimi i hapësirave publike në mënyrë funksionale, të sigurt dhe estetike, në përputhje me integritetin urban dhe interesin e përgjithshëm.
3. Aktivitetet zhvillohen vetëm pas miratimit paraprak të Bashkisë dhe në zbatim të kushteve të përcaktuara në këtë rregullore dhe në aktet ligjore e nënligjore përkatëse si dhe me legjislacionin specifik për aktivitete publike, fushatat politike dhe aktivitetet fetare.
4. Në hapësirat publike me vlera historike, kulturore ose mjedisore të mbrojtura, lejohen vetëm aktivitete të cilat nuk dëmtojnë integritetin dhe karakterin e tyre, duke marrë miratimin paraprak të institucioneve kompetente.

Neni 94

Aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara

1. Në hapësirat publike lejohen:
 - a. aktivitete promovuese për produkte ose shërbime vetëm nëse janë të parashikuara në lejen e dhënë nga Bashkia;
 - b. aktivitete kulturore dhe artistike (koncerte, ekspozita, shfaqje teatrale, etj.);
 - c. aktivitete sociale dhe fetare;
 - d. aktivitete politike (mbledhje, takime, aktivitete publike) në përputhje me legjislacionin për tubimet publike dhe aktivitetet politike;
 - e. aktivitete të tjera të ngjashme që kontribuojnë në jetën qytetare dhe për të cilat jepet miratim i posaçëm nga Bashkia.
2. Nuk lejohen aktivitete që:
 - a. çenojnë rendin public, sigurinë ose qarkullimin e lirë të qytetarëve;
 - b. nxisin dhunë, diskriminim ose urrejtje ose përmbajnë propagandë në kundërshtim me ligjin;
 - c. shkelin legjislacionin në fuqi për propagandën politike dhe fetare;
 - d. vendosin barriera ose struktura të përhershme në hapësirën publike pa miratim;
 - e. ushtrojnë shitje apo ekspozim mallrash jashtë tipologjisë së miratuar në leje.
 - f. përdorin pajisje fonike ose ndriçuese që tejkalojnë normat e lejuara dhe shkaktojnë shqetësim publik;
 - g. zhvillohen në zona me vlera historike, arkeologjike ose të gjelbra, në mënyrë që dëmton integritetin e tyre, pa miratimin e institucioneve kompetente;
 - h. përdorin materiale të rrezikshme (fishekzjarre, piroteknikë, substanca ndezëse) pa autorizim të posaçëm nga Bashkia dhe organet e sigurisë.

Pajisjet dhe elementët e lejuar

1. Për zhvillimin e aktiviteteve lejohen:
 - a) skena, podium dhe struktura të përkohshme, të çmontueshme të certifikuara për stabilitet dhe rezistencë ndaj kushteve atmosferike;
 - b) sisteme zëri dhe ndriçimi me volum dhe intensitet në përputhje me normat ligjore për zhurmat dhe ndotjen akustike, duke shmangur ndriçimin verbues drejt qytetarëve ose trafikut rrugor;
 - c) çadra, stenda dhe elementë promovues të çmontueshëm të ndërtuar me materiale rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe të certifikuara kundër zjarrit;
 - d) materialet e reklamimit vetëm brenda hapësirës së miratuar me leje, në formë të përkohshme.
 - e) gjeneratorë ose pajisje ndihmëse energjie vetëm nëse janë të izoluar akustikisht dhe përmbushin standardet mjedisore. Dokumentacioni përkatës dhe lidhjet me energjinë elektrike duhet të verifikohen nga strukturat dhe organet kompetente të kontrollit, sipas kërkesave teknike në fuqi, dhe procedura e miratimit të pajisjeve energjitike duhet të jetë e qartë dhe e përcaktuar.
2. Arkitektura dhe vendosja e pajisjeve duhet të jetë estetike, funksionale, e sigurtë dhe në harmoni me hapësirën publike dhe objektet përreth. Në hapësirat me vlera historike, kulturore ose mjedisore lejohen vetëm struktura minimale dhe në përputhje me miratimin paraprak të institucioneve kompetente.
3. Automjetet e furnizimit dhe materialet shtesë lejohet të qëndrojnë vetëm gjatë orarit të përcaktuar në leje dhe duhet të largohen menjëherë pas shkarkimit pa penguar qarkullimin e lirë të qytetarëve.

Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat

1. Shfrytëzimi i hapësirës bëhet vetëm sipas planvendosjes të miratuar nga Bashkia.
2. Duhet të sigurohet një korridor kalimi me një gjerësi minimale prej 300 (treqind) cm për lëvizjen e lirë të këmbësorëve.
3. Për aktivitete me pjesëmarrje të lartë, organizatori është i detyruar të hartojë plan sigurie dhe emergjencash, që përfshin;
 - a) Korridore të qarta dhe të shënuara për evakuim, të pajisura me sinjalistikë të dukshme dhe ndriçim të mjaftueshëm;
 - b) Pika të ndihmës së shpejtë dhe staf të trajnuar për ndërhyrje;
 - c) Mjete zjarrfikëse të vendosura sipas planit të miratuar;
 - d) Kufizime ose menaxhime të flukseve të pjesëmarrësve
 - e) Pika të posaçme aksesit me masa të nevojshme sigurie
 - f) Bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe institucionet përgjegjëse të rendit dhe emergjencave.
4. Kur aktiviteti ndikon në qarkullimin rrugor, Bashkia përcakton në leje masat e nevojshme për bllokim ose devijim trafiku, duke njoftuar paraprakisht Policinë Bashkiake dhe autoritetet përgjegjëse dhe qytetarët mbi masat e qarkullimit.
5. Bashkia, në bazë të vlerësimit të kapacitetit të hapësirës, mund të vendosë kufizime në numrin maksimal të pjesëmarrësve për të garantuar sigurinë dhe funksionalitetin e hapësirës publike.

Dokumentacioni dhe procedura e aplikimit për leje

1. Organizatori paraqet në seksionin përkatës të portalit e-Albania kërkesën për leje, të shoqëruar me dokumentacionin e detyrueshëm, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
2. Dokumentacioni përfshin:
 - a. kërkesë sipas formularit TIP;
 - b. përshkrim të detajuar të aktivitetit dhe qëllimit të tij;
 - c. Genplani i cili duhet të pasqyrojë gjendjen ekzistuese dhe atë të propozuar, të pajisur me legjendën përkatëse, dhe të jetë i pasuruar me elementet dhe kontekstin urban. Çdo element i pasqyruar në genplan duhet të jetë i dimensionuar saktë.
 - d. planvendosje dhe, kur kërkohet, pamje ilustrative (3D ose fotomontazhe), i cili duhet të jetë përgatitur dhe firmosur nga profesionist i licencuar në këtë fushë, si dhe duhet t'ju përmbahen me rigorozitet parametrave të vendosura në këtë rregullore; Plani duhet të përfshijë edhe organizimin e brendshëm të lëvizjes së publikut, hyrjet dhe daljet, rrugët e emergjencës, kontrollet e sigurisë dhe çdo element tjetër të nevojshëm për menaxhimin e turmave.
 - e. për aktivitete me pjesëmarrje massive duhet të depozitohet plan sigurie dhe planvendosje të miratuar nga profesionist i licencuar;
 - f. Në rastet ku vendoset skenë, duhet të depozitohet projekti teknik i detajuar i skenës, i firmosur dhe i vulosur nga projektuesi i licensuar, i shoqëruar me deklaratën e përgjegjësisë profesionale dhe licencën përkatëse, si dhe projekti elektrik i miratuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
 - g. dokument identifikimi ose NIPT dhe vërtetim tatimor;
 - h. miratim nga institucionet përkatëse për aktivitete me karakter politik ose fetar;
 - i. plan për menaxhimin e mbetjeve dhe për pastërtitë;
 - j. plan sigurie dhe emergjencash për aktivitetet me pjesëmarrje massive;
 - k. për aktivitete ushqimore: certifikata higjieno-sanitare dhe libreza shëndetësore të punonjësve si dhe produktet ushqimore duhet të ekspozohen jo më afër se 50 (pesëdhjetë) cm nga toka,
 - l. Në rast se kërkohet shfrytëzimi i një hapësirë publike të konsiderueshme mund të kërkohet edhe garanci pasurore për mbulimin e shpenzimeve të rehabilitimit të hapësirës në rast dëmtimi dhe mosplotësimit të kushteve të lejes.
3. Afatet standarde të aplikimit:
 - a. aplikimi bëhet të paktën 30 (tridhjetë) ditë para zhvillimit të aktivitetit;
 - b. shqyrtimi paraprak i dokumentacionit kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve;
 - c. vendimi përfundimtar jepet brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga plotësimi i dokumentacionit.
4. Për aktivitete politike dhe fetare:
 - a. aplikimi bëhet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë para aktivitetit;
 - b. shqyrtimi i dokumentacionit kryhet brenda 3 (tre) ditëve;
 - c. vendimi jepet brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga plotësimi i dokumentacionit.
5. Për aktivitete që nuk kanë karakter politik ose fetar dhe që nuk kërkojnë miratime ndërinstitucionale, ndiqet procedurë e përshpejtuar, si më poshtë:
 - a. afatet përgjysmohen;
 - b. aplikohet një tarifë shtesë e përcaktuar nga Këshilli Bashkiak, përveç tarifës standarde të shfrytëzimit të hapësirës publike.
6. Kur ka disa aplikime për të njëjtën hapësirë dhe datë, përparësi i jepet aktivitetit që ofron ndikim më pozitiv në komunitet dhe plan të harmonizuar me hapësirën publike.

7. Për aktivitetet sociale të organizuara nga shoqata ose organizata jo fitimprurëse, aplikimi kryhet sipas së njëjtës procedurë, me tarifa të reduktuara ose simbolike sipas vendimit të Këshillit Bashkiak. Për aktivitetet e organizuara nga vetë Bashkia, procedura e aplikimit zëvendësohet nga miratimi i planit të aktivitetit nga Kryetari i Bashkisë ose Këshilli Bashkiak.

Neni 98

Afati i lejes

1. Bashkia në kuadër të rolit të saj si menaxhues i hapësirave publike, me qëllim përdorimin sa më efektiv të hapësirës publike, në përputhje me llojin e aktiviteteve që do të zhvillohen, sipas rastit, kur vlerëson se zhvillimi i aktivitetit do të kishte të njëjtin funksion edhe për një kohëzgjatje më të shkurtër se ajo e kërkuar nga subjekti, mund të lëshojë lejen për një afat kohor më të shkurtër se ai i kërkuar, por gjithnjë jo më pak se 80 % të kohëzgjatjes së kërkuar.
2. Vendimi dhe arsyeja për lëshimin e lejes për një afat kohor më të shkurtër se ai i kërkuar, i njoftohet subjektit në fazën e shqyrtimit paraprak të dokumentacionit. Nëse subjekti nuk njofton për dakordësinë apo tërheqjen nga procedura brenda x ditëve, vijohet me lëshimin e lejes përkatëse.”
3. Leja për aktivitet jepet për një periudhë maksimale prej 1 (një) muaj.
4. Për aktivitete të përsëritura ose specifike, afati nuk mund të kalojë 6 (gjashtë) muaj brenda një viti kalendarik.
5. Orari i zhvillimit të aktivitetit përcaktohet në leje dhe, në mungesë të përcaktimit, është nga ora 06:00 deri në 23:00. Në zonat e banuara dhe me karakter historik, Bashkia mund të vendosë kufizime më të rrepta të orarit, deri në orën 22:00.
6. Duhet të respektohen kufizimet ligjore për muzikën dhe nivelin e zhurmës në hapësirat publike. Në rast të shkeljes së orarit ose të normave të zhurmës, Bashkia ka të drejtë të revokojë menjëherë lejen dhe subjekti nuk ka të drejtë të aplikojë për një leje të re për të njëjtën hapësirë për një periudhë deri në 1 (një) vit.

Neni 99

Ndalimet

1. Ndalohen:
 - a) zhvillimi i aktivitetit pa leje të Bashkisë;
 - b) shfrytëzimi i hapësirës për qëllime të tjera nga ato të miratuara;
 - c) vendosja e strukturave të përhershme;
 - d) përdorimi i pajisjeve fonike mbi normat ligjore dhe ndriçimi verbues;
 - e) përdorimi i hapësirës për magazinimin mallrash, ambalazhesh ose mbeturinash jashtë hapësirave të përcaktuara;
 - f) aktivitete që cenojnë qarkullimin ose sigurinë publike duke përfshirë bllokimin e korridoreve të emergjencës;
 - g) shitja ose ekspozimi i mallrave jashtë tipologjisë së miratuar në leje.
 - h) organizimi i aktiviteteve me përmbajtje diskriminuese, të dhunshme, pornografike ose që nxisin urrejtje mbi baza racore, fetare, etnike, politike etj;
 - i) përdorimi i fishekzjarreve, piroteknikëve ose materialeve të rrezikshme pa autorizim të posaçëm;
 - j) zhvillimi i aktiviteteve në hapësira me vlera historike, arkeologjike ose mjedisore pa miratimin paraprak të institucioneve kompetente.

Neni 100

Mirëmbajtja e hapësirës publike

1. Organizatori është i detyruar të sigurojë pastërtinë, mirëmbajtjen e hapësirës publike gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit.
2. Organizatori është përgjegjës edhe për hapësirën përreth, në një rreze nga perimetri prej 10 (dhjetë) metrash për aktivitete të zakonshme dhe 20 (njëzet) metrash për aktivitete masive. Mbetjet grumbullohen në venddepozitime të përkohshme dhe largohen rregullisht, duke ruajtur imazhin e pastërtisë.
3. Pas përfundimit të aktivitetit, organizatori kryen pastrimin e plotë të hapësirës.
4. Organizatori është i detyruar të ketë marrëveshje me një subjekt të licencuar për transportin dhe menaxhimin e mbetjeve.

Neni 101

Kthimi i hapësirës publike

1. Pas përfundimit të aktivitetit, organizatori është i detyruar të kryejë pastrimin bazik të hapësirës (largimin e mbetjeve të dukshme dhe ushqimore) brenda 2 (dy) orëve nga mbyllja e aktivitetit.
2. Pastrimi përfundimtar dhe rikthimi i hapësirës publike në gjendjen fillestare duhet të kryhet jo më vonë se ora 06:00 e ditës pasuese.
3. Në rast mospërmbyshjeje të këtyre detyrimeve, Bashkia ndërhyr për pastrimin dhe rikthimin e hapësirës, duke zbritur kostot përkatëse nga garancia financiare e depozituar nga organizatori ose, kur kjo nuk mjafton, duke ia faturuar drejtpërdrejt organizatorit sipas procedurave ligjore në fuqi.

Neni 102

Detyrimet financiare

1. Organizatori është i detyruar të paguajë tarifën për shfrytëzimin e hapësirës publike, e cila përcaktohet mbi bazën të:
 - a. sipërfaqes së zënë (m²);
 - b. kohëzgjatjes së aktivitetit;
 - c. zonës së qytetit ku zhvillohet aktiviteti duke marrë parasysh dendësinë urbane dhe ndikimin mbi komunitetin.
2. Diferencimi i tarifave bëhet si vijon:
 - a. aktivitetet promovuese dhe komerciale: tarifa e plotë, e përditësuar çdo vit;
 - b. aktivitetet kulturore, artistike, sociale, humanitare apo fetare: tarifë e reduktuar deri në 70 (shtatëdhjetë) %, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak dhe në përputhje me interesin publik të aktivitetit;
 - c. aktivitetet e organizuara nga Bashkia dhe/ose institucionet publike: përjashtohen nga tarifa;
 - d. për procedurën e përshpejtuar, aplikohet tarifë shtesë e miratuar nga Këshilli Bashkiak.
3. Përveç tarifës, organizatori është i detyruar të depozitojë një **garanci financiare** të kthyeshme, e cila përdoret për të mbuluar kostot e pastrimit, rikthimit të hapësirës dhe çdo dëmtim të shkaktuar.

4. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e shfrytëzimit të hapësirave publike destinohen ekskluzivisht për:
 - a. mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike;
 - b. përmirësimin e infrastrukturës urbane;
 - c. financimin e aktiviteteve kulturore dhe sociale me interes publik.

Neni 103

Masat ndëshkuese

1. Shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje, sanksionohen sipas këtyre masave:
 - a. Paralajmërim në vend (proces-verbal) me afat korrigjimi nga 2 (dy) deri në 5 (pesë) ditë;
 - b. Në rast moskorrigjimi, subjekti gjobitet **jo më pak se 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror**, në varësi të sipërfaqes së shfrytëzuar dhe natyrës së shkeljes, dhe pajisjet e vendosura në kundërshtim me lejen sekuestrohen me akt administrativ.
 - c. Aktiviteti pezullohet deri në korrigjimin e plotë të shkeljes, por jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) ditë.
 - d. Nëse subjekti nuk ka korrigjuar shkeljen pas afatit maksimal të pezullimit, leja e shfrytëzimit të hapësirës publike revokohet automatikisht.
 - e. Vendimi për pezullim ose anulim e lejes është i ankimueshëm në përputhje me legjislacionin për procedurat administrative.
 - f. Në rast se subjektit i revokohet leja e shfrytëzimit të hapësirës publike më shumë se dy herë të njëpasnjëshme, ai nuk mund të riaplikojë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, për të gjitha hapësirat publike të administruara nga Bashkia.
2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, do të konsiderohen shkelje:
 - a. Ushtrimi i aktivitetit në një hapësirë më të madhe se ajo e përcaktuar në leje;
 - b. Instalimi i pajisjeve pa leje;
 - c. Mosmirëmbajtja e pajisjeve, kur kjo dëmton/cenon estetike e qytetit ose përbën rrezik për jetën e qytetarëve;
 - d. Mosmbajtja pastër e hapësirës së shfrytëzuar;
 - e. Mosshlyerja e tarifës së shfrytëzimit brenda afateve;
 - f. Prishja e qetësisë publike ose sjellja e padenjë;
 - g. Vazhdimi i aktivitetit edhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar në leje apo pas anulimit të saj;
 - h. Shfrytëzimi i hapësirës për aktivitet tjetër nga ai i lejuar;
 - i. Vendosja e barrierave që pengojnë qarkullimin dhe aksesin publik.

KREU XI

SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE – PLAZHE

Neni 104

Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit

1. Ky kre përcakton kushtet dhe rregullat për shfrytëzimin e hapësirave publike bregdetare dhe liqenore për zhvillimin e aktiviteteve turistike, rekreative dhe shërbyese, duke ruajtur aksesin e lirë dhe të barabartë të qytetarëve në plazhe si hapësira publike me funksion social, ekonomik dhe mjedisor.
2. Shfrytëzimi i hapësirave të plazheve duhet të respektojë këto parime:
 - a. Ruajtjen e integritetit të peizazhit natyror dhe vijës bregdetare;

- b. Mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisi dhe burimeve ujore;
 - c. Zbatimin e legjislacionit sektorial në fuqi për bregdetin, ujërat dhe zonat e mbrojtura;
 - d. Sigurimin e përdorimit publik pa diskriminim dhe pa pengesa të pajustificuar dhe me akses të garantuar për persona me aftësi të kufizuara;
 - e. detyrimin për të garantuar standardet minimale të sigurisë në plazh, duke përfshirë rojet e plazhit, sinjalistikën dhe shërbimet bazike të ndihmës së parë.
3. Në rast mospërputhjeje midis kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, kanë përparësi dispozitat e VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 “*Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”*”, e ndryshuar.

Neni 105

Tipologjitë e plazheve dhe kushtet e shfrytëzimit

1. Plazhet klasifikohen sipas tipologjive të përcaktuara në VKM nr. 649, datë 16.10.2024, “*Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”*”, e ndryshuar, si më poshtë:
 - a. Tipi A (plazhe të urbanizuara) – hapësira bregdetare të pajisura me shërbime të plota turistike dhe rekreative, ku përcaktohen sipërfaqe të konsiderueshme për shfrytëzim nëpërmjet kontratave të miratuara nga organet kompetente;
 - b. Tipi B (plazhe pjesërisht të urbanizuara) – hapësira bregdetare me shërbime bazë, ku garantohet akses i lirë dhe i gjerë i publikut;
 - c. Tipi AB (plazhe të kombinuara) – hapësira bregdetare të cilat përmbajnë elemente të tipit A dhe B, sipas planit të miratuar nga autoritetet përgjegjëse;
 - d. Tipi C (plazhe të virgjëra) – hapësira bregdetare të paurbanizuara, të mbrojtura, ku lejohet vetëm përdorimi individual dhe jo shfrytëzimi ekonomik.
2. Kushtet e shfrytëzimit, llojet e shërbimeve të lejuara dhe distancat ndërmjet hapësirave të shfrytëzimit përcaktohen në planin e miratuar të plazhit, në përputhje me VKM nr. 649/2024, të ndryshuar, dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.
3. Çdo shfrytëzim i plazheve duhet të kryhet në përputhje me tipologjinë përkatëse dhe në respekt të detyrueshëm të parimeve të mbrojtjes së mjedisit, të garantimit të aksesit publik dhe të ruajtjes së peizazhit natyror.
4. Në të gjitha rastet, një përqindje minimale e vijës bregdetare duhet të mbetet e lirë dhe falas për qytetarët, pa pengesa dhe pa tarifa hyrjeje, sipas përcaktimeve të VKM nr.649/2024 dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi. Për qëllime zbatimi lokal, kjo përqindje nuk mund të jetë më pak se 20% e gjatësisë së vijës bregdetare të çdo plazhi.

Neni 106

Veprimtaritë e lejuara dhe të ndaluara në hapësirat e plazheve

1. Në hapësirat publike të plazheve lejohen këto veprimtari:
 - a. Vendosja e shezlloneve, çadrave dhe pajisjeve të lëvizshme për përdorim nga pushuesit jo më shumë se 80% e sipërfaqes së shfrytëzuar;
 - b. Ofrimi i shërbimeve të përkohshme gastronomike dhe freskuese pa nderhyrje në rërë, me karakter të çmontueshëm të pezullueshme pas përfundimit të afatit të përcaktuar në lejen përkatëse në përputhje me certifikatat higjieno-sanitare në fuqi;
 - c. Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreative që nuk sjellin ndikim të përhershëm mbi hapësirën publike vetëm në zona të dedikuara, që nuk cenojnë sigurinë dhe aksesin publik;

- d. Zhvillimi i aktiviteteve kulturore, promovuese dhe argëtuese, të miratuara nga autoritetet përgjegjëse duke respektuar oraret dhe kufizimet për zhurmën;
 - e. Veprimtari të tjera të ngjashme, të cilat nuk cenojnë aksesin publik dhe që miratohen rast pas rasti nga strukturat përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Në hapësirat publike të plazheve ndalohen rreptësisht:
- a. Ndërtimet e përhershme ose gjysmë të përhershme pa lejen e posaçme të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (KKTU);
 - b. Çdo formë bllokimi ose kufizimi i aksesit publik drejt bregut të detit dhe liqeneve;
 - c. Veprimtari që shkaktojnë ndotje të ujit, rërës, ajrit ose të mjedisit përreth;
 - d. parkimi ose qarkullimi i automjeteve mbi rërë, përveç mjeteve të shërbimit dhe emergjencës;
 - e. përdorimi i pajisjeve fonike dhe muzikës me volum mbi normat e lejuara ligjore ose jashtë orareve të miratuara;
 - f. Çdo veprimtari tjetër që bie ndesh me parimet e ruajtjes së hapësirave publike, mbrojtjes së mjedisit dhe garantimit të të drejtës së qytetarëve për akses të lirë.

Neni 107

Pajisjet dhe shërbimet e detyrueshme në plazhe

1. Organizatori i shfrytëzimit të hapësirës së plazhit është i detyruar të garantojë vendosjen dhe funksionimin e pajisjeve dhe shërbimeve të mëposhtme:
 - a. Çadra, shezllone dhe tavolina të lehta, të lëvizshme dhe të çmontueshme, në përputhje me sipërfaqen e miratuar në leje;
 - b. Kioska të përkohshme për shërbime ndihmëse, të vendosura vetëm me lejen e autoriteteve përkatëse dhe në sipërfaqe të kufizuara dhe të pajisura me certifikatat higjieno-sanitare të vlefshme;
 - c. Pajisje për t'u larë, me ujë të pastër pa përdorimin e detergjentëve;
 - d. Kabina zhveshjeje të lehta dhe të çmontueshme, në numër jo më pak se 1% e sipërfaqes së plazhit të miratuar për shfrytëzim dhe të mirëmbajtura sipas standardeve higjieno-sanitare;
 - e. Dushe me ujë të ëmbël, të shpërndara në mënyrë të përshtatshme për përdoruesit;
 - f. Tualete publike funksionale, përfshirë tualete të përshtatura për persona me aftësi të kufizuara të certifikuar dhe të pastruara rregullisht;
 - g. Struktura të përkohshme për rojet e plazhit, të ndërtuara me materiale të lehta dhe të harmonizuara me mjedisin përreth;
 - h. Zona të pajisura për dhënie të ndihmës së shpejtë, me mjetet dhe pajisjet e nevojshme për ndërhyrje në raste emergjencash shëndetësore;
 - i. Sinjalistikë të dukshme dhe të lexueshme për numrat e emergjencës (ambulancë, polici, zjarrfikëse);
 - j. Vendosje të bovave çdo 30–50 metra, për ndarjen e zonës së notimit, sipas këtyre kriterëve:
 - i. deri në 200 metra për plazhet e Tipit A;
 - ii. deri në 100 metra për plazhet e Tipit B;
 - k. Flamuj sinjalizues me ngjyrë jeshile, të verdhë dhe të kuqe, për të informuar pushuesit mbi kushtet e detit dhe rrezikshmërinë e notimit;
 - l. Zona të veçanta për mjetet lundruese me ose pa motor, të shënuara qartë me tabelë Zonë e panotueshme, në gjuhën shqipe dhe anglisht;
 - m. Pajisjet dhe shërbimet e përcaktuara në këtë nen janë të detyrueshme për çdo subjekt që ushtron veprimtari në plazhe, pavarësisht tipologjisë së plazhit, përveç rasteve kur legjislacioni sektorial dhe aktet nënligjore përkatëse parashikojnë ndryshe.

- n. Mosrespektimi i detyrimeve të këtij neni, përfshirë mosplotësimin e kushteve higjieno-sanitare përbën shkelje të rregullores dhe sjell masa ndëshkuese sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 108

Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat

1. Sipërfaqja e hapësirës publike që mund të shfrytëzohet për veprimtari ekonomike dhe shërbime në plazh përcaktohet në planin e miratuar të plazhit, në përputhje me legjislacionin sektorial dhe aktet nënligjore në fuqi. Shfrytëzimi nuk mund të tejkalojë 80% të sipërfaqes së miratuar, duke lënë jo më pak se 20% të lirë për përdorim publik falas.
2. Respektimi i brezave të lirë nga vija e ujit, të destinuar për lëvizjen e lirë të pushuesve, është detyrim i detajuar si vijon:
 - a. Për plazhet e Tipit A duhet të lihet i lirë një brez jo më pak se 10 metra nga vija e ujit;
 - b. Për plazhet e Tipit B duhet të lihet i lirë një brez jo më pak se 2.5–3 metra nga vija e ujit;
 - c. Për plazhet e Tipit C (plazhe të virgjëra) nuk lejohet asnjë formë shfrytëzimi ekonomik, duke ruajtur karakterin natyror dhe publik të tyre.
3. Distanca minimale ndërmjet rreshtave të shezlloneve duhet të jetë jo më pak se 200 cm, për të garantuar qarkullim dhe hapësirë të lirë për pushuesit. Në çdo sektor duhet të parashikohet të paktën një korridor i lirë për aksesin e personave me aftësi të kufizuara deri në vijën e ujit.
4. Shkarkimi i mallrave, furnizimi dhe shërbimet logjistike të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në plazh kryhen vetëm në oraret e përcaktuara nga autoritetet përgjegjëse dhe në mënyrë të tillë që të mos pengohet qarkullimi dhe pushimi i qytetarëve.

Neni 109

Procedura e aplikimit për leje

1. Aplikimi për shfrytëzimin e hapësirave publike bregdetare dhe liqenore (plazheve) kryhet përmes portalit shtetëror “*e-Albania*”. Aplikanti është i detyruar të ngarkojë të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregulloreje dhe sipas VKM nr. 649, datë 16.10.2024, “*Për miratimin e rregullores Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit*”, të ndryshuar.
2. Përfitimi i lejes për shfrytëzimin e hapësirës publike kushtëzohet nga paraqitja e dokumenteve të mëposhtme:
 - a. Kërkesa sipas formularit tip elektronik të miratuar;
 - b. Planvendosje e hapësirës së kërkuar, ku të përcaktohet sipërfaqja dhe pajisjet përkatëse;
 - c. Dokument identifikimi i aplikantit ose NIPT për subjektet tregtare;
 - d. Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve fiskale qendrore dhe vendore;
 - e. Plan i menaxhimit të mbetjeve dhe i ruajtjes së pastërtisë së plazhit;
 - f. Vërtetim higjieno–sanitar për aktivitetet ushqimore, si dhe librezat shëndetësore për të gjithë punonjësit;
 - g. Plan sigurie dhe emergjencash, në përputhje me standardet ligjore në fuqi;
 - h. Marrëveshje e noterizuar me vrojtuesin e plazhit, e shoqëruar me certifikatën e kualifikimit profesional.
3. Afatet e aplikimit dhe fazat e shqyrtimit

- a. Faza I – shqyrtimi paraprak: dokumentacioni verifikohet brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga dorëzimi; aplikanti ka deri në 30 (tridhjetë) ditë për të plotësuar çdo dokumentacion të munguar.
 - b. Faza II – dorëzimi përfundimtar: jo më vonë se data 31 mars e çdo viti kalendarik, aplikanti ngarkon planvendosjen përfundimtare dhe vërtetimin e pagesës së tarifës përkatëse.
 - c. Vendimmarrja përfundimtare jepet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dorëzimi i plotë i dokumentacionit, në bazë të rekomandimit të strukturave përgjegjëse.
4. Strukturat përgjegjëse
- a. Grupi Teknik i Shqyrtimit të Aplikimeve (GTSHA) ushtron kompetencën e shqyrtimit të plotë të dokumentacionit dhe jep rekomandimin përkatës.
 - b. Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik (KMST) është organi vendimmarrës që miraton ose refuzon dhënien e lejes.
5. Në rast se për të njëjtën hapësirë dhe periudhë aplikojnë më shumë se një subjekt, Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik (KMST) organizon procedurë konkurruese mbi bazën e kritereve të mëposhtme: cilësia e planit të menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit, garancia për akses publik falas, cilësia dhe numri i shërbimeve të ofruara, masat për sigurinë dhe emergjencat, si dhe përvoja e mëparshme në fushën e menaxhimit të plazheve. Në rast barazie mes aplikantëve, përparësi i jepet subjektit që ofron kushte më të favorshme financiare për bashkinë dhe komunitetin lokal.”

Neni 110

Afati dhe orari i lejes për shfrytëzimin e plazheve

1. Leja për shfrytëzimin e hapësirës publike bregdetare jepet për një sezon turistik dhe ka afat nga 1 maji deri më 15 nëntor të çdo viti kalendarik.
2. Kontratat e shfrytëzimit kanë afat 1-vjeçar, me mundësi rinovimi sipas legjislacionit sektorial dhe autorizimeve të dhëna nga autoritetet përgjegjëse. Rinovimi nuk lejohet në rast se subjekti ka shkelur kushtet e përcaktuara në leje ose detyrimet e kësaj rregulloreje.
3. Në raste të veçanta dhe sipas nevojës së zhvillimit të aktivitetit, kontratat mund të zgjasin deri në 5 (pesë) vjet, me miratimin e strukturave kompetentede vetëm pas procedurave konkurruese të hapura dhe transparente.
4. Orari i shfrytëzimit të hapësirës publike përcaktohet në lejen përkatëse. Në mungesë të një përcaktimi të veçantë në leje, orari i vlefshmërisë është nga ora 06:00 deri në 20:00. Për aktivitetet gastronomike, promovuese ose kulturore, orari i shfrytëzimit mund të zgjatet deri në ora 23:00, vetëm me miratim të posaçëm nga autoritetet përkatëse dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e ambientit, ndotjen akustike dhe qetësinë publike.

Neni 111

Zhurmat dhe përdorimi i pajisjeve fonike

1. Gjatë gjithë periudhës së shfrytëzimit të hapësirës publike, subjektet që ushtrojnë veprimtari në plazh janë të detyruara të respektojnë kufijtë e lejuar të zhurmës, në përputhje me legjislacionin sektorial mbi mbrojtjen nga ndotja akustike dhe përdorimin e muzikës.
2. Përdorimi i pajisjeve fonike, muzikore ose të tjera që gjenerojnë zhurmë, nuk duhet në asnjë rast të shqetësojë pushuesit, banorët përreth apo të cenojë qetësinë publike. Kufijtë

e lejuar nuk mund të tejkalojnë nivelet e përcaktuara me aktet nënligjore përkatëse (p.sh. 55 dB ditën dhe 45 dB natën).

3. Orari i përdorimit të muzikës dhe pajisjeve fonike në plazh përcaktohet në leje. Në mungesë të një përcaktimi të veçantë, ndalohet përdorimi i tyre pas orës 23:00 dhe gjatë orareve të pushimit (14:00–16:00), me përjashtim të aktiviteteve të miratuara paraprakisht nga autoritetet përkatëse.
5. Autoritetet përgjegjëse kanë të drejtën të kontrollojnë zhurmën e prodhuar nga subjektet dhe të kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme për sigurimin e respektimit të normave ligjore. Në rast përsëritjeje, mund të pezullohet përdorimi i pajisjeve fonike dhe të aplikohen masat ndëshkuese sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 112

Mirëmbajtja e hapësirës publike

1. Organizatori i shfrytëzimit të hapësirës publike bregdetare është i detyruar të sigurojë mirëmbajtjen e vazhdueshme të plazhit dhe të hapësirës përreth, në përputhje me standardet e higjienës dhe legjislacionin në fuqi.
2. Detyrimet e organizatorit përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:
 - a) Mbajtjen e plazhit të pastër gjatë gjithë kohëzgjatjes së shfrytëzimit;
 - b) Kujdesin për hapësirën publike përreth, në një rreze prej 20 (njëzet) metrash nga perimetri i hapësirës së marrë me leje;
 - c) Vendosjen dhe mirëmbajtjen e koshave dhe vendgrumbullimeve për mbeturinat, në mënyrë të mjaftueshme për numrin e pushuesve dhe sipas kapacitetit të hapësirës;
 - d) Largimin e mbetjeve çdo ditë dhe sa herë që arrihet kapaciteti maksimal i vendgrumbullimeve;
 - e) Kryerjen e pastrimit të plotë të hapësirës dhe kthimin e saj në gjendjen fillestare pas përfundimit të sezonit turistik.

Neni 113

Kthimi i hapësirës publike

1. Pas përfundimit të sezonit turistik ose pas përfundimit të lejes së shfrytëzimit, subjekti që ka përdorur hapësirën publike është i detyruar ta lirojë atë dhe ta rikthejë në gjendjen fillestare brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të sezonit ose përfundimit të lejes, megjithatë subjekti merr përsipër kryerjen e pastrimit bazik të hapësirës (largimi i mbetjeve të dukshme dhe ushqimore) brenda 2 (dy) orëve nga mbyllja e aktivitetit; dhe kryerjen e pastrimit të plotë, përfshirë larjen dhe dezinfektimin e pajisjeve sanitare dhe hapësirave ndihmëse, në intervale të rregullta dhe pas përfundimit të sezonit turistik;
2. Kthimi në gjendjen fillestare përfshin: pastrimin e plotë të hapësirës, largimin e të gjitha pajisjeve dhe strukturave të vendosura përkohësisht, si dhe rivendosjen e elementeve të ambientit natyror ose urban siç kanë qenë para përdorimit.
3. Subjekti është përgjegjës për çdo dëmtim të hapësirës publike që mund të ketë ndodhur gjatë periudhës së shfrytëzimit dhe për obligimin e riparimit ose rikthimit të saj në gjendjen origjinale.
4. Në rast mospërbushjeje të detyrimeve të këtij neni, Bashkia ndërhyr për rikthimin e hapësirës dhe kostot përkatëse i faturohen subjektit, duke u zbritur nga garancia financiare e depozituar ose duke u ekzekutuar sipas procedurave ligjore në fuqi.
5. Subjekti që nuk respekton detyrimet e këtij neni ndalohet të paraqesë kërkesë për një leje të re për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

Detyrimet financiare

1. Subjektet që ushtrojnë veprimtari në hapësirat publike bregdetare dhe liqenore janë të detyruara të paguajnë tarifa për shfrytëzimin e hapësirës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse dhe vendimet e Këshillit Bashkiak.
2. Llogaritja e tarifës bëhet duke marrë parasysh elementët e mëposhtëm:
 - a. Sipërfaqen e zënë (m²) – sipërfaqja reale e hapësirës së shfrytëzuar, e përcaktuar në lejen e dhënë;
 - b. Tipin e aktivitetit – p.sh. shezllone, shërbime gastronomike, aktivitete sportive, kulturore ose promovuese;
 - c. Kohëzgjatjen e sezonit turistik – periudha e shfrytëzimit e përcaktuar në leje;
 - d. Kategorinë e plazhit – A, B, AB ose C, sipas tipologjisë së përcaktuar në VKM nr. 649, datë 16.10.2024, të ndryshuar.
3. Tarifa përfshin gjithashtu kostot për menaxhimin e mbetjeve, mirëmbajtjen e hapësirës publike dhe shërbimet e tjera të detyrueshme sipas rregullores.
4. Tarifat përcaktohen në mënyrë të diferencuar sipas natyrës së aktivitetit:
 - a. Aktivitetet komerciale: Subjektet që ushtrojnë veprimtari me karakter fitimprurës paguajnë tarifën e plotë për shfrytëzimin e hapësirës publike, e cila përditësohet periodikisht nga Këshilli Bashkiak çdo vit.
 - b. Aktivitetet kulturore, sportive ose jofitimprurëse: Për subjektet që organizojnë aktivitete pa qëllim fitimi, tarifa mund të ulet deri në 80% të tarifës së plotë, në përputhje me kriteret e miratuara nga autoriteti kompetent.
 - c. Aktivitetet e organizuara nga Bashkia ose institucionet publike: Për subjektet publike dhe aktivitetet e tyre nuk aplikohet tarifa e shfrytëzimit; ato përjashtohen nga çdo pagesë financiare lidhur me përdorimin e hapësirës publike.
 - d. Procedurat e përshpejtuara: Për aplikimet dhe proceset që kërkojnë shqyrtim dhe miratim të përshpejtuar, aplikohet një tarifë shtesë, e cila përcaktohet dhe miratohet nga Këshilli Bashkiak.
 - e. Procedurat e përshpejtuara – aplikohen vetëm në rastet e aktiviteteve me interes publik të menjëhershëm, ngjarjeve kulturore, sportive ose promovuese të jashtëzakonshme, ose në situata të emergjencave funksionale, kur ndjekja e afateve standarde nuk është e mundur. Për këto raste, aplikohet një tarifë shtesë, e miratuar nga Këshilli Bashkiak. Procedurat e përshpejtuara nuk zbatohen për aktivitete politike, fetare apo aktivitete të tjera që kërkojnë miratime ndërinstitucionale.

Masat ndëshkuese dhe inspektimet

1. Inspektimet e shfrytëzimit të hapësirës publike bregdetare kryhen nga strukturat përgjegjëse të turizmit dhe nga Policia Bashkiake, në përputhje me kompetencat ligjore.
2. Në rast konstatimi të shkeljeve, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, struktura përgjegjëse inspektuese merr masa administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin dhe parashikimet e nenit 71, të ligjit nr.93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar.
3. Në rast se nuk përcaktohet ndryshe në legjislacionin sektorial, struktura përgjegjëse inspektuese në rast konstatimi të shkeljeve merr masa si më poshtë:

- a. Njoftohet subjekti me proces-verbal në vend, duke i caktuar afat për korrigjimin e shkeljes brenda 24 orëve.
 - b. Në rast të moskorrigjimit të shkeljes brenda afatit të caktuar, subjekti gjobitet me 500,000 (pesëqind mijë) lekë. Aktiviteti i tij do të pezullohet deri në korrigjimin e shkeljes, por jo më shumë se 5 (pesë) ditë.
 - c. Në rast të përsëritjes së shkeljeve ose moskorrigjimit të tyre, kontrata ose leja e shfrytëzimit anulohet menjëherë, ndërsa të gjitha pajisjet e vendosura përkohësisht sekuestrohen dhe trajtohen sipas legjislacionit në fuqi. Subjekti në këtë rast ndalohet të paraqesë kërkesë për një leje të re për një periudhë **2 (dy) vjeçare** nga data e anulimit.
4. Subjekti është përgjegjës për çdo dëmtim të hapësirës publike ose të pajisjeve të vendosura dhe detyrohet të paguajë shpenzimet për riparimin ose rivendosjen e gjendjes së mëparshme. Në rast mospërbushjeje, kostot zbriten nga **garancia financiare** e depozituar ose ekzekutohen sipas procedurave ligjore në fuqi.
 5. Zbatimi i masave ndëshkuese bëhet pa cenuar të drejtat e palës për ankim sipas procedurave administrative të përcaktuara në ligj.

KREU XII

SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE (TROTUARE) GJATË NDËRTIMIT

Neni 116

Përshkrimi i përgjithshëm i aktivitetit

1. Ky kre përcakton kushtet, kriteret dhe rregullat për shfrytëzimin e hapësirave publike, veçanërisht trotuareve dhe zonave të tjera të aksesit publik, gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit, rikonstruksionit ose mirëmbajtjes së objekteve.
2. Shfrytëzimi i këtyre hapësirave lejohet vetëm në rastet kur është i domosdoshëm për kryerjen e punimeve dhe nuk ekzistojnë zgjidhje alternative teknike që e shmangin atë.
3. Shfrytëzimi i trotuareve duhet të jetë gjithmonë i përkohshëm dhe për aq kohë sa zgjat aktiviteti i ndërtimit, duke garantuar në çdo rast sigurinë e këmbësorëve dhe aksesin e tyre të pandërprerë përmes rrugëve ose kalimeve alternative të sigurta, si dhe në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar dhe VKM Nr. 448, datë 31.7.2025 *“Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit”*.

Neni 117

Aktivitetet e lejuara

1. Vendosja e skelave për punime ndërtimore ose restauruese në përputhje me standardet teknike dhe të sigurisë.
2. Vendosja e barrierave mbrojtëse dhe rrethimeve të përkohshme për sigurimin e zonës së punimeve.
3. Shtrirja e përkohshme e materialeve ndërtimore, vetëm në hapësirat e përcaktuara në leje duke garantuar gjithmonë një korridor minimal prej 200 cm për kalimin e këmbësorëve.
4. Vendosja e sinjalistikës paralajmëruese dhe ndriçimit mbrojtës veçanërisht gjatë natës.
5. Organizimi i korridoreve të sigurta dhe të mbrojtura për kalimin e përkohshëm të këmbësorëve të aksesueshme edhe për persona me aftësi të kufizuara dhe karroca fëmijësh.

6. Mirëmbajtja e përditshme e hapësirës së shfrytëzuar, duke sistemuar dhe pastruar materialet për të shmangur rreziqe për qytetarët.

Neni 118

Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat

1. Skela të certifikuar sipas standardeve teknike në fuqi.
2. Rrethime të përkohshme të ndërtuara me panele metalike ose materiale të tjera të sigurta të forta dhe rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe akteve të vandalizmit.
3. Pamja ballore e rrethimit duhet të përmbajë imazhe të projektit të miratuar, ndërsa anësoret të jenë të uniformizuara sipas standardeve të miratuar nga Bashkia ose legjislacioni sektorial.
4. Rrethimi duhet të jetë i pajisur me të paktën 4 kamera sigurie, me akses online dhe në kohë reale për strukturat përgjegjëse.
5. Pajisje sinjalistike dhe ndriçim i mjaftueshëm gjatë natës anë të detyrueshme, duke përfshirë tabela të dukshme si “Rrezik ndërtimi”, “Ndalohet hyrja”, etj.
6. Pajisje mbrojtëse kundër rënies së materialeve (rrjeta, mbulesa, platforma mbrojtëse). të cilat duhet të mirëmbahen dhe të zëvendësohen sa herë që dëmtohen.
7. Tabela identifikuese e vendosur në vend të dukshëm, që përfshin të dhënat e lejes së ndërtimit, sipërfaqen e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe përgjegjësit teknik.
8. Ndalohet përdorimi i materialeve të përhershme ose që pengojnë qarkullimin përtej afatit të lejes si dhe çdo element i paautorizuar estetik ose reklamues.

Neni 119

Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat

1. Shfrytëzimi i hapësirës publike duhet të jetë sa më i kufizuar dhe i justifikuar teknikisht.
2. Në çdo rast duhet të lihet një korridor minimal prej 200 (njëqind e pesëdhjetë) cm për kalimin e këmbësorëve.
3. Korridoret duhet të jenë të pajisura me rampa për të garantuar aksesueshmëri të plotë për persona me aftësi të kufizuara dhe për karroca fëmijësh.
4. Korridoret e këmbësorëve duhet të mbulohen me konstruksione të qëndrueshme, në lartësi jo më pak se 2 (dy) m, duke formuar një tunel të sigurt për kalimtarët, të hapur nga ana e rrugës dhe të pajisur me ndriçim dhe sinjalistikë paralajmëruese.
5. Rrugët e aksesit dhe emergjencës parashikohen në planin e shfrytëzimit të kantierit dhe të shënohen në tabelat përkatëse.
6. Vendosja e materialeve nuk duhet të pengojë hyrjen në objekte publike, banesa ose biznese dhe në asnjë rast nuk duhet të bllokojë hyrjet e emergjencës apo rrugët e zjarrfikësve.

Neni 120

Procedura e aplikimit për leje

1. Kërkesa për shfrytëzimin e hapësirës publike gjatë ndërtimit përfshihet në aplikimin për leje ndërtimi.
2. Aplikuesi duhet të specifikojë qartë hapësirën që kërkon të shfrytëzojë, të shoqëruar me planvendosjen përkatëse dhe përshkrimin e masave të sigurisë.
3. Në lejen e ndërtimit, pjesa që lidhet me hapësirën publike evidentohet në mënyrë të veçantë.

4. Njoftimi për fillimin e punimeve duhet të bëhet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara në sistemin e-leje, duke ngarkuar dokumentacionin përkatës. Bashkia ka të drejtë të kërkojë **garanci financiare dhe policë sigurimi** për dëme të mundshme në hapësirën publike dhe ndaj palëve të treta.
5. Monitorimi i shfrytëzimit të hapësirës publike kryhet nga strukturat përgjegjëse të bashkisë, të cilat janë të detyruara të kryejnë kontrole periodike në vend dhe të mbajnë proces-verbal inspektimi.

Neni 121

Afati i lejes

1. Leja jepet vetëm për periudhën e punimeve të miratuara.
2. Në rast zgjatjeje të punimeve, duhet paraqitur kërkesë për rinovim të lejes të shoqëruar me dokumentacion justifikues.
3. Pas përfundimit të punimeve, hapësira publike lirohet menjëherë, pastrohet dhe rikthehet në gjendjen fillestare. Në rast mospërbushjeje, kostot e pastrimit dhe rikthimit faturohen subjektit dhe zbriten nga garancia financiare e depozituar.

Neni 122

Ndalimet

1. Ndalohet:
 - a. Shfrytëzimi i hapësirës publike pa leje.
 - b. Shfrytëzimi i hapësirës përtej sipërfaqes së miratuar në leje.
 - c. Lënia e materialeve të ndërtimit jashtë zonës së përcaktuar dhe pa mbulim mbrojtës.
 - d. Pengimi i lëvizjes së këmbësorëve ose përdorimi i barrierave pa korridor të lirë dhe të sigurt.
 - e. Lënia e mbetjeve ndërtimore në hapësirën publike.
 - f. Bllokimi i hyrjeve në banesa, biznese, institucione publike ose rrugë emergjence;
 - g. Përdorimi i materialeve të rrezikshme (kimikate, të djegshme) pa miratim të posaçëm dhe masa sigurie.

Neni 123

Mirëmbajtja

1. Subjekti është i detyruar të:
 - a. Mbajë të pastër dhe të sigurt hapësirën e shfrytëzuar gjatë gjithë periudhës së punimeve.
 - b. Sigurojë pastrimin e përditshëm dhe largimin e mbetjeve ndërtimore.
 - c. Kujdeset për hapësirën publike përreth, në një rreze prej 20 (njëzet) metrash nga perimetri i shfrytëzimit.
 - d. Sigurojë rregullisht mirëmbajtjen e sinjalistikës, ndriçimit dhe pajisjeve mbrojtëse duke i zëvendësuar menjëherë kur dëmtohen.

Neni 124

Kthimi i hapësirës publike

1. Pas përfundimit të punimeve, hapësira publike duhet të kthehet në gjendjen fillestare brenda 5 (pesë) ditëve.
2. Kostot e pastrimit dhe rikthimit i faturohen subjektit në rast mospërbushjeje.
3. Kthimi në gjendjen fillestare përfshin: pastrimin e plotë të hapësirës, largimin e skelave, barrierave dhe materialeve ndërtimore, si dhe riparimin e çdo dëmtimi të trotuareve, asfaltit, gjelbërimit apo elementeve të tjerë urbanë.

4. Në rast mospërmbushjeje, Bashkia ka të drejtë të kryejë vetë pastrimin dhe rikthimin e hapësirës publike, duke i faturuar të gjitha kostot subjektit.
5. Shuma përkatëse zbritet nga garancia financiare e depozituar nga subjekti ose ekzekutohet sipas procedurave ligjore në fuqi.
6. Në rast shkeljesh të përsëritura, subjekti ndalohet të përfitojë leje të reja për shfrytëzim të hapësirës publike për një periudhë deri në 2 (dy) vjet.

Neni 125

Detyrimet financiare

1. Tarifa për shfrytëzimin e hapësirës publike përcaktohet në bazë të:
 - a. Sipërfaqes së zënë (m²);
 - b. Kohëzgjatjes së shfrytëzimit;
 - c. Zonës urbane ku kryhen punimet.
2. Të ardhurat e gjeneruara destinohen për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës publike hapësirave të gjelbra dhe elementëve urbanë.
3. Tarifat rishikohen çdo vit nga Këshilli Bashkiak mbi bazën e indeksit të çmimeve të konsumit (inflacionit).

Neni 126

Masat ndëshkuese

1. Shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje, nëse nuk përcaktohet ndryshe në legjislacionin sektorial, sanksionohen sipas këtyre masave:
 - a. Në rast se konstatohet shkelje për herë të parë, subjekti paralajmërohet me procesverbal dhe i jepet afat korigjimi brenda ditës;
 - b. Në rast moskorigjimi, subjekti gjobitet **jo më pak se 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror**, në varësi të sipërfaqes së shfrytëzuar dhe natyrës së shkeljes dhe aktiviteti pezullohet deri në korigjimin e shkeljes.
 - c. Nëse shkelja nuk korigjohet brenda 5 (pesë) ditëve, leja anulohet dhe pajisjet e vendosura sekuestrohen. Njoftohet edhe autoriteti publik që ka lëshuar lejen e ndërtimit.
 - d. Vendimi për pezullimin ose anulimin e lejes është i ankimeshëm në përputhje me legjislacionin për procedurat administrative.

KREU XIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 127

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave dhe zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipëris në përputhje me parashikimet e Kushtetutës, Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Me hyrjen në fuqi të saj, çdo akt tjetër i mëparshëm që bie ndesh me këtë rregullore shfuqizohet.

Neni 128

Zbatimi

1. Zbatimi i kësaj rregulloreje është i detyrueshëm nga të gjitha institucionet dhe organet përgjegjëse, sipas fushës së tyre të veprimtarisë dhe kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe në këtë rregullore.
2. Bashkitë kanë detyrimin që, në zbatim të kësaj rregulloreje, të nxjerrin aktet nënligjore dhe dokumentet ndihmëse të nevojshme, duke garantuar zbatimin e saj, si dhe transparencë dhe akses publik.
3. Aktet e parashikuara në pikën 2 duhet të miratohen brenda një afati jo më të gjatë **se 1 (një) muaj** nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

Neni 129

Interpretimi

1. Çdo paqartësi gjatë zbatimit të kësaj rregulloreje adresohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse.
2. Bashkitë dhe institucionet përgjegjëse mund të japin udhëzime teknike për zbatimin praktik të dispozitave të saj, në kuadër të kompetencave ligjore.

Neni 130

Ndryshimet dhe plotësimet

Çdo ndryshim ose plotësim i kësaj rregulloreje bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ndryshimet dhe plotësimet duhet të respektojnë parimin e mbrojtjes së interesit publik, garantimin e aksesit të barabartë në hapësirat publike dhe parimet e transparencës e të konsultimit publik, sipas legjislacionit përkatës.

Kjo rregullore, si akt nënligjor i Këshillit të Ministrave, hyn në fuqi pas miratimit dhe zbatimi i saj është i detyrueshëm për të gjitha organet dhe institucionet përgjegjëse.